

# XHEVAT KALLAJXHI

BIBLIOTEKA

929

K27

*Lincoln*

1

K.A.O.

## **"DIELLI" boton:**

*Vepra të plota nga Xhevat Kallajxhi:*

- Lincoln-i
- John F. Kennedy, Kampion i paqes dhe lirisë
- Bektashizmi dhe teqeja shqiptare n'Amerikë
- Skënderbeu
- Lot' e shpresa
- Tingëllimat e zemrës
- Për të qeshur
- Publicistika vëll. I Në faqet e "Demokrisisë" (1925-1930).
- Publicistika vëll.II. Në faqet e "Diellit" (1978-1988).

*Autorë dhe vepra të tjera:*


- *Anastas Kullurioti, Polemika shqiptare*
- *Koto Hoxhi, Vjersha*
- *Alqi Jani, Çajupi i ynë (Përmbledhje me shkrime e studime nga autorë të ndryshëm)*
- *Klara Kodra, Rrënjët e Lisit (artikuj kritikë)*
- *Alqi Jani, Erëza malore*
- *Alqi Jani, Qyteti Gri*
- *Alqi Jani, Zonja Merimangë*
- *Klara Kodra De Rada, Sofonizba (tragjedi),*
- *Klara Kodra Poezia e De Radës*

929  
K27

# XHEVAT KALLAJXHI

# LINCOLN

Përgatitur nga  
ALQI JANI, studiues



1

Shëpia Botuese  
Stypshkronja 

Xhevat Kallajxhi  
Lincoln  
1

**Vepra e plotë e Xh. Kallajxhiut  
botohet nën kujdesin e z. Ilir Kallajxhi**

**Botues: Ilir Lleshi  
Shtëpia Botuese ILAR, Tiranë, 2009**

**Korrektore letrare: Dr. Prof. Klara Kodra  
Punoi në kompjuter: Meliha Balla  
Përkujdesja grafike: Artur Shyti**

**ISBN 978-99956-07-62-3**

**©: Alqi Jani**

**Botimet ILAR  
Rr. "Muhamet Gjolleasha", Nr.17, Zogu i Zi  
(ish-ndërmarrja e U.E.M)  
Tel.:+355 (0) 4 270 592; Fax: +355 (0) 42 270 594  
E-mail: ilirlleshi@ilar.al**

**Teqesë**  
**Bektashiane Shqiptare**  
**në Detroit,**  
**e para në Shtetet e Bashkuara,**  
**për kujtim dhe nderim**  
**të veprimtarisë së ndritur kombëtare**  
**që zhvilloi në Shqipëri**  
**dhe të shërbimit të shquar njerëzor**  
**që bën në Amerikë,**  
**këtë vepër modeste,**  
**autori ia kushton**  
**me admirim.**



**Abraham Lincoln-i**

*"Besimi ynë qëndron në dashurinë për liri, të cilën Perëndia e ka rrënjësuar në shpirtat tonë. Mbrojtja jonë qëndron në ruajtjen e frymës që e çmon lirinë si një trashëgim për të gjithë njerëzit, kudo".*

**ABRAHAM LINCOLN**

## PËRMBAJTJA

|  |     |
|--|-----|
| Hyrje .....                                    | 11  |
| I. Xhevat Kallajxhi, - Jeta - Veprimtaria..... | 11  |
| II. Krijimtaria .....                          | 18  |
| III. Monografia “Lincoln” .....                | 25  |
| Parathënie.....                                | 41  |
| Fëmijëria e Lincoln-it .....                   | 53  |
| Lincoln-i në rrugën e një jete të re.....      | 69  |
| Dalja e Lincoln-it në skenë.....               | 81  |
| Martesa e Lincoln-it.....                      | 91  |
| Çështja e skllavërisë .....                    | 100 |
| Debatet historike Lincoln-Douglas.....         | 111 |
| Lincoln-i President i Amerikës .....           | 122 |
| Shkëputja e shteteve nga bashkimi i kombit     | 136 |
| Lufta civile .....                             | 143 |
| Fjalimi i famshëm i Gettysburg-ut.....         | 155 |
| Guximi i Lincoln-it .....                      | 159 |
| Lincoln-i përsëri President.....               | 166 |
| Mbarimi i Luftës .....                         | 173 |
| Vrasja e Lincoln-it .....                      | 182 |
| Monumenti i Lincoln-it në Washington.....      | 189 |

## HYRJE

### I. XHEVAT KALLAJXHI - *Jeta - veprimtaria*

Xhevat Kallajxhi, për vlerat që mbart si gazetar, politikan, studiues dhe si atdhetar i palodhur, ka zënë një vend të merituar në historinë e Shqipërisë në shekullin e fundit. Nga historianët është cilësuar “një figurë madhore e kombit tonë”.

Shqiptaro-amerikani Xh. Kallajxhi lindi në Gjirokastrë më 25 shkurt 1903 dhe vdiq në SHBA-ës më 8 nëntor 1989.

Arsimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmin në gjimnazin “Zosimea” të Janinës. Studimet universitare i ka ndjekur në Bolonja të Italisë dhe i plotësoi me studimet vetjake dhe përvojën e jetës.

Zgjodhi gazetarinë për të përballuar jetën në moshë të re. Ende i ri, 22 vjeçar, nxori gazetën “Labëria” (1925). Pokëtë vit botoi “Demokratia” (1925-1939). Aty botuan firma të njohura të kohës si Vangjel Koça, Branko Merxhani, Jorgji Meksi, Et’hem Haxhiademi, Safet Butka, Javer Hrushiti, Petro Marko, Sterjo Spasse etj. “Demokratia” u bë gazeta më serioze në jugun



## XHEVAT KALLAJXHI

e vendit. “Demokratia”, shprehej Kallajxhiu, pronari, drejtori, editori i saj, “është një fletore misioni”. Këtë mision, e gjejmë të shprehur në shtyllat e veçanta të saj që trajtonin politikën kombëtare, ekonomike, arsimore, sociale etj. “Demokratia” publikoi gjerësisht lëvizjen mendore “Neoshqiptarizma” të Branko Merxhanit dhe të Vangjel Koçës. Gazeta u rezervoi vend të posaçëm ngjarjeve të rëndësishme të Rilindjes sonë Kombëtare dhe figurave të shquara si Naim Frashëri, A.Z.Çajupi, Abdyl Frashëri, Koto Hoxhi, Pandeli Sotiri, Çerçiz e Bajo Topulli, Idriz Guri, Thoma Papapano etj. “Demokratia” për vite e vite me radhë mbajti gjallë problemin e Çamërisë, Kosovës dhe Pavarësinë e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë – së bashku me “hërmoninë e admirueshme ndërmjet feve kryesore në Gjirokastrë dhe në krejt hapësirën shqiptare”. Xhevati ishte nismëtar dhe drejtues i fushatës për të ngritur përmendoren e Çerçiz Topullit, i kërkesës qytetare për shkollë të mesme të plotë, për një ujësjellës që të plotësonte nevojat e qytetit, për nderimin e Koto Hoxhit, të Luftës së Mashkullorës, apo kremtimin e përbashkët nga myslimanët e të krishterët të ditëve të shenjta të Pashkëve, të Bajramit etj. Ndërkohë përkrahu emancipimin e femrës shqiptare, shkollimin e saj dhe heqjen e perçes.

## LINCOLN

Pas vitit 1938 Xhevati mori përsipër detyra shtetërore. Së pari kryetar i bashkisë së Sarandës. Më vonë, kur u bë bashkimi i trojeve etnike, në vitet '40, Xhevati, me shumë dëshirë e përkushtim, shkoi në Gostivar me detyrën e nënprefektit dhe pak kohë në Tetovë në detyrën e kryetarit të bashkisë. Në tokat e çliruara përkrahu çeljen e shkollave shqipe, të institucioneve shqiptare dhe ushqe u propagandoi shqiptarizmen si të vetmen ideologji për liri e bashkim kombëtar. "Miqësia me Xhemë Gostivarin ndikoi tek ai për të formuar çetën nacionaliste më të fuqishme të asaj treve".

Në vitin 1943 e gjejmë kryetar të bashkisë në Gjirokastrë. Në korrik të vitit 1943 u arrestua nga karabinieria italiane dhe u izolua në burgun e Vlorës nga ku mundi të arratisëj. Marrëveshjen e Mukjes që siguronte luftë të përbashkët kundër okupatorëve dhe projektonte një Shqipëri të pavarur, të lirë e demokratike e priti me gëzim të madh. Po aq e hidhëroi prishja e saj nga komunistët nën diktatin e emisarëve të PKJ, Miladin Popoviçit e Dushan Mugoshës.

Në këto rrethana të reja forcoi edhe më shumë lidhjet me Mit'hat Frashërin, Hasan Dostin, Hysni Lepenicën, Skënder Muçon, Jani Dilon e të tjerë figura të shquara.

## XHEVAT KALLAJXHI

Me fitoren e komunistëve, vendosjen e diktaturës në Shqipëri, u mbyll çdo mundësi për jetë e veprimtari, çka e detyroi të marrë rrugën e mërgimit.

Së pari në Itali, në kampet e refugjatëve. Më vonë u zhvendos në SHBA. Në Nju Jork boton gazetën "Shigjeta" (1950), organ i Frontit Antikomunist Shqiptar në SHBA.

Shpejt tërhoqi vëmendjen e botës së medias dhe thirret të punojë si gazetar në "Europa e Lirë" dhe më vonë, përsëri si gazetar, te "Zëri i Amerikës".

Ndihmesë të veçantë Xhevati dha bashkë me peshkop Nolin për themelimin e Teqesë Bekdashiane në Detroit. Teqenë e udhëhoqi me sukses Baba Rexhepi nga Gjirokastra. Ajo u kthye në një qendër të madhe fetare dhe në një vatër bashkimi për të gjithë shqiptarët e Amerikës. Për këtë teqe Kallajxhiu shkroi një studim të veçantë historik me titull "Bektashizmi dhe Teqeja shqiptare në Amerikë". Duhet shtuar se monografinë "Lincoln-i" ia kushton teqesë shqiptare në Detroit.

Dekadën e fundit të jetës (1976-1986), Xhevati, edhe pse në moshë të kaluar, drejtoi për 10 vjet rresht me sukses të madh gazetën "Dielli". Studiuesit bashkëkohorë për punën e vyer si editor të Diellit e thirrën "Kryeplak të gazetarisë shqiptare".

## LINCOLN

Puna e Xhevatit si atdhetar i përkushtuar është vlerësuar nga Federata Panshqiptare "Vatra" me pllakën e bakërt me shkronja të arta për përpjekjet e tij në shërbim të popullit shqiptar e të Shqipërisë etnike. Vlerësim të veçantë i ka bërë Kisha Shqiptare e Bostonit. Ajo e nderoi me medaljonin me fytyrën e Shën Gjergjit, emër i shenjtorit që mban Kisha Ortodokse Shqiptare në Boston.

Si shef i Seksionit për Ballkanin në "Zërin e Amerikës" dhe komentator i programeve në gjuhën shqipe punoi plot 19 vjet. Gjatë kësaj kohe mbajti të gjallë frymën e shpresës për liri e demokraci, te dëgjuesit shqiptarë e më tej, i bindur se ditët e komunizmit dhe përmbysja e tij tani numëroheshin me gishtat e dorës.

Për këtë mision të madh që kreu, për gati dy dekada me radhë, Xhevat Kallajxhiu Departamenti Amerikan i Informacionit e ka vlerësuar punën e tij "Of Patriotic to the Government of the United States of America".

Xhevat Kallajxhiu vdiq më 8 nëntor 1989 në prag të rënies së komunizmit në Shqipëri gjë që e pat ëndërruar gjatë gjithë jetës së tij.

\*

\* \*


Një ngjarje, jo e zakonshme, në kohën kur gazetar ishte Xhevat Kallajxhiu, më lidhi fort e

## XHEVAT KALLAJXHI

më pas për dekada me radhë, me radion “Zëri i Amerikës”. Ishte data 13 mars 1965. Rastësisht, duke lëvizur poshtë e lart butonin e radios, kapa stacionin “Zëri i Amerikës”. Në lajmin e kësaj dite dëgjova të flitej me dhembje e nderim për vdekjen e Imzot Nolit. “Zëri i Amerikës” foli për ceremoninë madhështore dhe nderimet që i bëheshin në Amerikë në Kishën e Shën Gjergjit, ku Noli kishte kaluar një pjesë të rëndësishme të jetës së tij. Mbi kapakun e një fletoreje të zakonshme për nxënës, shënova me ngut sa dëgjova për jetën dhe veprën e Nolit. Disa nga të dhënat që jepte komentatori i talentuar i “Zërit të Amerikës” i dëgjoja për herë të parë. Xhevati, komentatori i famshëm i “Zërit të Amerikës”, me fjalën e tij më nxiti të mendoja për ç’mund të bëhej për F. S. Nolin e pavdekshëm. Ato informacione që dëgjova për ceremoninë e funeralit të përmortshëm të Nolit në Amerikë, ndryshonin shumë si nata me ditën me të dhënat e thata e të censuruara të shtypit partiak. Nga Tirana u dërgua për shqiptarët e Amerikës edhe ndonjë telegram zyrtar, sa për të larë gojën. Kudo dukej një paraqitje shumë e rezervuar për jetën dhe veprimtarinë e Nolit. Kjo binte në sy qartë. Isha mësues i letërsisë në shkollën e mesme në Gjirokastër, ndieja detyrë të bëja diçka më tepër se të tjerët, sepse ishte ndarë nga jeta korifeu

## LINCOLN

i letrave shqipe. Ato sa dëgjova në fshehtësi të thellë nga “Zëri i Amerikës” dhe detyra e mësuesit nuk më lanë të qetë. Nëpër disa klasa u bënë biseda të shkurtëra përkujtimore. Në rrethin letrar të shkollës që mbante emrin “Migjeni” u fol për krijimtarinë e Nolit e u recituan poezi të tij. Gazeta “Letrari i Ri” nxori një numër të veçantë. Lindi ideja që nga shkolla e mesme “Asim Zeneli” në Gjirokastrë të dërgohej një telegram ngushëllimi në drejtim të Kishës së Shën Gjergjit në Boston të Amerikës. Telegrami, i përgatitur prej nesh, ishte modest, i shkurtër, jo më shumë se gjashtë rreshta. Iu paraqit me ndruajtje drejtorit si dëshirë e disa nxënësve të klasës III<sup>B</sup>. Ai duhet ta miratonte. Drejtori i shkollës (S.V.) me të cilin ruaja një konfidencë mirëkuptimi, pasi kishte pyetur “diku” më tha prerë e me zë të ulët: “Telegram drejt Amerikës? Je në vete?!...”. Me kaq u mbyll kjo orvatje pa sukses. Telegramin bashkë me shënimet e shkurtra gati me initiale mbi kapakun e një fletore, ruhen si relike të shenjta nga një kohë, kur sundonte terrori dhe dhuna e përbindshme e diktaturës moniste. Në ato shënime, aq të përmbledhura, ruhen fjalët e Xhevat Kallajxhiut, komentatorit të famshëm të “Zërit të Amerikës” nga buronte zëri i së vërtetës për çdo shqiptar në epokën komuniste.



## II. KRIJIMTARIA

### Veprat biografike dhe historike

Veç shkrimeve publicistike, Xh.Kallajxhiu ka një krijimtari mjaft të gjerë në prozë e në poezi. Ka shkruar vepra të llojeve të ndryshme. I suksesshëm ka qenë si biograf. Janë të njohura tri monografitë për tri figurat e mëdha nga historia e Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës: Skënderbeu, Abraham Lincoln-i dhe John F.Kennedy.

Secila nga këto biografi ishte e lidhur me ngjarje të veçanta. Kështu "**Lincoln**", NY, 1961, u shkrua për shqiptarët e Amerikës me rastin e 150 vjetorit të Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Biografia e dytë është "**Skënderbeu**", NY 1975, një libër manifest për liri. Në qendër të vet ka heroin kombëtar të popullit shqiptar Gjergj Kastriotin - Skënderbeun. Xh. Kallajxhiun, figura madhështore e heroit legjendar të shqiptarëve e ka joshur dhe në shkrime të tjera. Ai ishte shumë i dashur për të, siç është edhe ajo e Nënë Terezës, Ali Pashë Tepelenës, Bushatllinjve, udhëheqësve të Besëlidhjes Shqiptare të Prizrenit, I. Qemalit etj.

## LINCOLN

Shkas për të hartuar këtë monografi u bë krentimi i 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Me këtë rast, një jubile jo i zakonshëm, shqiptarëve të Amerikës u fali një “dhuratë të vogël për figurën më të madhe të historisë së popullit të vet”. Vetë studiuesi shkruan: “Këtë vepër të bazuar në fakte historike e legjenda e shkrova si një ndihmesë të vogël në përpjekjen e madhe që bëjnë shqiptarët kudo për të përkujtuar pesëqind vjetorin e vdekjes së Skënderbeut”. Librin autori ua kushton **“dëshmorëve të Shqipërisë të të gjitha luftrave për pavarësinë dhe lirinë e saj”**. Është vendi të ndalemi në këtë kushtim me të cilin hapet monografia: Xhevati ua kushton “gjithë dëshmorëve” pa dallim, sigurisht një ide me shumë dritë bashkimi. Ai nuk i ndan dëshmorët siç bënte diktatura komuniste në Shqipëri, e cila dallonte dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga komunistët, të cilëve edhe festat edhe vlerësimet edhe varret ua krijonte të veçanta. Me këto dukuri demokrati liberal Xhevat Kallajxhiu nuk pajtohej. Ky qëndrim i Kallajxhiut për të patur varreza të përbashkëta është një risi mendimi për jetën shoqërore e politike në Shqipërinë ku sundonte diktatura më e ashpër në vendet e Europës Lindore. Kjo vepër mbeti e panjohur në atdheun e autorit, sepse në atë kohë si autori dhe veprat e tij ishin të ndaluara.



## XHEVAT KALLAJXHI

Vepra në fjalë sot i shërben edukimit atdhetar të brezit të ri në bashkësinë shqiptaro-amerikane, në Shqipëri, Kosovë e kudo që ka shqiptarë edhe pse vepra “nuk ka ndonjë risi në historinë e Gjergj Kastriotit”.

Monografia e tretë **“John F. Kennedy, kampion i paqes dhe lirisë”**, NY, 1980, u shkrua pas bujës së madhe që shkaktoi vrasja kriminale e njërit prej presidentëve më të ri të SHBA-ës. Autori e trajton këtë personalitet si kampion të lirisë, drejtësisë dhe demokracisë për gjithë njerëzimin. Vepra u prit ngrohtë nga diaspora shqiptare në Amerikë e më gjërë. Përkundrazi kjo monografi edhe si “Lincoln”-i “aludojnë qartë për gjendjen e skllavëruar të popullit shqiptar nën regjimin komunist”.

Të gjitha “Veprat biografike tregimtare të frymëzuara nga ideale humane, heroike e demokratike dallohen për një stil të shtruar, emocional e shpeshherë edhe mjaft elegant”.

Në radhën e studimeve historike bën pjesë dhe libri **“Bektashizmi dhe teqeja shqiptare në Amerikë”**, NY, 1964. Studimi doli në dritë 4 vjet pas suksesit që pati monografia për “Lincoln”-in. Si në botimet biografike edhe në studimin për bektashizmin dhe teqenë shqiptare në Detroit, tek autori kanë ndikuar shumë motivet personale. Familja Kallajxhi është familje bektashiane prej

## LINCOLN

shumë brezash me një të kaluar të ndritur atdhetare. Ajo pati lidhje të ngushta me familje të tjera të mëdha bektashiane, siç është familja e vëllezërve Frashëri. Këto lidhje midis dy familjeve të mëdha bektashiane, po edhe të krishtera (familja e Koto Hoxhit, apo katolike, ajo e Pashko Vasës), i nisën miqësitë në Shqipëri, i vazhduan në Turqi (Stamboll) dhe arritën deri në SHBA, midis pasardhësve të tyre siç është rasti i Xhevatit dhe Mit'hat Frashërit. Këto lidhje midis familjeve dhe personaliteteve të shquara të kohës me besime të ndryshme fetare do të luanin role të rëndësishme për fatet e atdheut në periudha të ndryshme të historisë së tij.

Tek bektashizmi, Xhevat Kallajxhiu dhe tek teqetë shqiptare, ai shihte foletë e zgjimit kombëtar dhe embrionin ku mori jetë shqiptarizma.

I lidhur shpirtërisht me besimin bektashian, Xhevati luajti një rol të rëndësishëm në themelimin në vitin 1954 të teqesë në Detroit nën hijen e Baba Rexhepit. Është e vërtetë që vetë Baba Rexhepi u përkujdes për botimin e librit për bektashizmin të Xh.Kallajxhiut. Teqeja që për Xhevatit një "Welcome spiritual and social retreat", siç thotë në Buletinin Katolik Shqiptar të vitit 1990 autori i shkrimit "In memoriam" i nënshkruar "A Friend of Xhevat".

Me një angazhim të tillë shpirtëror, Xhevati

## XHEVAT KALLAJXHI

hartoi dhe botoi librin me vlera të spikatura “Bektashizmi dhe teqeja shqiptare në Amerikë”. Në vepër del rëndësia e bektashizmit në jetën kombëtare të popullit tonë. Aty del mirë në pah se teqetë u bënë qendra të platformës politike dhe ideologjike të shqiptarizmit në shek. XIX, XX. Për këtë të vërtetë historike, historia e kohës së monizmit ka heshtur me prapamendim dashakeqas. Kjo dukuri akoma reflektohet edhe në këto 20 vjet tranzicion, sigurisht jo në të mirën e shqiptarëve.

### Vepra letrare

Xhevati shkroi në prozë e në poezi dhe ishte suksesshëm në të dyja gjinitë.

Në prozë botoi përmbledhjen me pjesë humoristike “**Për të qeshur**”, NY, 1978. Është libër i mirë për të kaluar kohën e lirë.

Vepra madhore në prozë, romani voluminoz “**Larg Atdheut**” mbeti në dorëshkrim dhe na mungojnë të dhënat që të flasin për të.

Xhevat Kallajxhiu nuk u shqua vetëm si historian, biograf e mendimtar, publicist e prozator, po edhe si poet me dy vëllime poetike “**Lot’ e shpresa**”, NY, 1976 dhe “**Tingëllimet e zemrës**”, Kaliforni, 1988.

Vëllimi “Lot’ e Shpresa” ngërthen në bre-

## LINCOLN

ndinë e vet 43 vjersha të botuara kohë pas kohe në shtypin e mërgimit. Vëllimi ka dhe një baladë shumë të bukur të Bilal Xhaferit për Çamërinë, një përkthim-adaptim të një poezie të nobelistit rus Boris Pasternakut. Vëllimi ka parathënie dhe shënime të ndryshme shpjeguese.

Shumë vend zënë vjershat për martirët e rënë në luftën për liri e pavarësi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Poezitë e kësaj natyre e me këtë tematikë, larg përsosmërisë artistike, kanë vlera njohëse e dokumentare.

Tematika e gjerë e këtij vëllimi ngërthen vargje të shumta për fatin e trojeve etnike shqiptare të Kosovës e të Çamërisë nën sundimin serb e grek. Jeta e mërgimtarit me vështirësitë, vuajtjet, mallin për vendlindjen, Atdheun etj. zënë një pjesë të këtij vëllimi.

“Tingëllimet e zemrës”. Tematika e këtij vëllimi afron me atë të vëllimit “Lot’ e shpresë”. Aty spikat dashuria dhe malli për Atdheun, dëshira e mërgimtarit për të parë vendlindjen, tokën e të parëve, po kjo dëshirë mërgimtarit i është mohuar. Vëllimit nuk i mungojnë as poezitë erotike me personazhe nga jeta baritore, si ajo për bareshën, as vjershat për Shemo Gjirokastritin apo Mbretëreshën Argjiro, etj.

## XHEVAT KALLAJXHI

### Publicistika

Në shkrimet e Xhevat Kallajxhiut zënë shumë vend botimet publicistike në shtypin e kohës si në gazeta, revista apo botime të tjera. Shkrimet gazetareske janë përmbledhur dhe presin botimin në dy vëllime kryesore: Vëllimi i parë i takon harkut kohor 1925-1944 dhe lidhen kryesisht me shkrimet në fletoren "Demokratia".

Vëllimi i dytë i takon harkut tjetër kohor, viteve të mërgimit, 1944-1989 dhe lidhen kryesisht me shkrimet e tija të botuara në gazetën "Dielli" në SHBA.

\* \* \*

Dhamë më sipër një përshkrim informues për jetën, veprat, krijimtarinë poetike e të tjera dukuri nga krijimtaria e Xhevat Kallajxhiut, larg analizave kritike e vlerave që mbartin. Kjo punë i takon së ardhmes. Sidoqë të shprehemi, krijimtaria e shumanshme e Kallajxhiut meriton vëmendje të veçantë për vlerat që ka. Me të drejtë shtypi i diasporës ka shënuar se vepra e Kallajxhiut nuk duhet t'u mungojë bibliotekave familjare e publike në Shqipëri, Kosovë, Tetovë, diasporë dhe kudo ku ka shqiptarë.

## LINCOLN

### III. MONOGRAFIA "LINCOLN-I"

Neve në Shqipëri na ka munguar me kohë një libër i tillë si "Lincoln-i". 48 vjet më parë këtë boshllëk e ka plotësuar Xhevat Kallajxhi me rastin e 150-vjetorit të Presidentit XVI të SHBA-ës. 150-vjetori i Lincoln-it, në SHBA dhe në mbarë botën demokratike të kohës u kremtua me madhështi. Përjashtim bëri Shqipëria dhe ish vendet diktatoriale të Lindjes. Në Shqipëri për Lincoln-in në këtë përvjetor sundoi heshtja e varrit. Për shqiptarët e diasporës, në veçanti për shqiptarët e shumtë në Amerikë, heshtjen e theu studiuesi dhe historiani Xhevat Kallajxhi. Librin e munguar ua dha në dorë shqiptaro-amerikanëve, po në atdheun mëmë monografia për këtë burrë të madh shteti, që vendit të vet i bëri shërbime të paçmuara, kurse në historinë e botës la gjurmë të pashlyera, iu mbyllën dyert, sepse tek ne nuk frynte era e Lirisë; erën e Perëndimit e pengonte "Perdja e hekurt". U desh që edhe në vendin e shqipeve, të binte "Muri i Berlinit", të vinte Jubileu i 200-vjetorit të lindjes së Lincoln-it që lexuesi i gjerë shqiptar të merrte në duar "librin e ndaluar", jo vetëm

## XHEVAT KALLAJXHI

kaq, po dhe të përkujtonte me këtë rast një nga personalitetet më të ndritura të njerëzimit.

Kur i urti e i mençuri, atdhetari dhe demokrati i mirënjohur Xhevat Kallajxhi, shkroi e botoi një monografi si kjo për Lincoln-in, me shumë të drejtë, ka menduar se kështu do të shprehte një mirënjohje të thellë të shqiptarëve për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në atdheun e Lincoln-it në këto 120 vjetët e fundit, siç është shkruar në shtypin e diasporës, bashkatdhetarët tanë gjetën strehë, punë e bukë; gjetën liri për t'u organizuar në shoqata kulturore, mundësi të botonin gazeta, revista dhe arritën suksese të lakmueshme në ekonominë e tyre personale në tregun e lirë.

Nga gjiri i shqiptarëve të Amerikës dolën njerëz të shquar atdhetarë që kanë bërë histori, politikanë, publicistë, shkrimtarë, burra që me përkushtim, si askush tjetër, dolën zot, me luftë e përpjekje të jashtëzakonshme për Shqipërinë e re të pavarur. Si të tillë, mund të përmendim: Peshkopin Theofan Stilian Noli, mendimtarin brilant Faik Konicën, historianët Kostë Çekrezi e Kristo Dako, motrat Qiriazhi, Sotir Peci e Kristo Floqi me shumë të tjerë. Mirësitë që u kanë ardhur shqiptarëve, Shqipërisë, Kosovës e gjithë të tjerëve prej tyre, nuk kanë të shlyer. Në SHBA ka vepruar e vepron Federata Panshqiptare "Vatra" me gazetën e saj "Dielli" që

## LINCOLN

për gati një shekull u priu shqiptarëve në rrugën e lirisë dhe demokracisë, mbajti të gjallë e të ndezur problemin e Kosovës deri sot, kur ajo është e lirë, demokratike dhe aspiron Bashkimin European dhe futjen në NATO.

Për sa kanë bërë SHBA për Shqipërinë, i takon çdo shqiptari, brez pas brezi, që kurdoherë në jetë të ruajë si gjënë më të shenjtë, miqësinë me kombin amerikan dhe mirënjohjen e përjetshme për “Tokën e premtuar”. Botimi në Shqipërinë e lirë dhe demokratike, e monografisë për Lincoln-in me rastin e 200-vjetorit të tij, është një shfaqje e vlerësimit, e nderimit për atë dhe miken më të madhe të tij SHBA-së.

Monografia për Lincoln-in nga Xh. Kallajxhiu është hartuar me shumë dashuri, kujdes dhe me nivel shkencor. Në vepër është pasqyruar e vërteta historike e kohës me të gjitha vlerat që mbart me vete. Gjuha e veprës e thjeshtë, e pastër, e rrjedhshme me stil të kuptueshëm e të qartë, japin së bashku figurën e burrit të shquar të shtetit amerikan që me aftësi udhëhoqi vendin e vet drejt lirisë, demokracisë, të drejtave njerëzore dhe bashkimit të përjetshëm kombëtar.

Ne, shqiptarët, kudo ku jemi, brenda dhe jashtë shtetit amë kemi një histori, një gjuhë hyjnore, - shqipen mijëravjeçare, një kulturë me zakone e tradita të njëjta, por edhe me



## XHEVAT KALLAJXHI

një qëllim të përbashkët që të jemi të lirë në demokracinë Euro-Atlantike dhe të bashkuar. Po t'i shqyrtojmë hallet dhe nevojat tona me këtë sy, mund të themi se kemi çfarë të mësojmë nga jeta, veprimtaria dhe shembulli i Presidentit Lincoln. Shqiptarëve u duhet bashkimi dhe vetëm bashkimi, ashtu siç na duhet uji, buka dhe drita e Diellit në jetën e përditshme. Është diçka sublime nevoja e bashkimit kombëtar për çdo popull. Shtetet e Evropës bashkimin kombëtar e kanë bërë me kohë. Edhe Lincoln-i këtë nevojë ndjeu, andaj bëri bashkimin e përjetshëm të kombit amerikan. Përrjashtim në Evropë bën Shqipëria, e cila në katër pikat e horizontit kufizohet me shqiptarë (!!!). Në Evropë të gjithë kanë hyrë të bashkuar. Po ne?

**Ne kemi shumë për të mësuar nga Lincoln-i**

### *Varreza Kombëtare – Varreza e Bashkimit*

Ishte koha e kulmit të Luftës Civile (1861-1865) midis Veriut dhe Jugut. Saktësisht data 19 nëntor 1863 kur Presidenti Lincoln me qeveritarë të tjerë të lartë shkoi në fushën e Gettysburg-ut ku ishte zhvilluar një nga betejat më të përgjakshme të kohës. Atje ranë në fushën e luftës 23.000 luftëtarë veriorë, 30.000 luftëtarë jugorë. Jo pak, 53.000 bij të një nëne,

## LINCOLN

bij të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në fushën e Gettysburg-ut u varrosën, pa dallim pranë e pranë, përbri njëri-tjetrit, në krah të njëri-tjetrit, shumë ushtarë të vrarë të Jugut e të Veriut, të cilët para flijimit ishin të ndarë, të armiqësuar për jetë, sot, në praninë e vetë Presidentit Lincoln u bashkuan, u vëllazëruan përsëri në amshim, hodhën prapa egërsinë dhe hakmarrjen e luftës që i kacafyti për jetë a vdekje. Askund në botë nuk kishte ndodhur ndonjëherë që armiqtë e papajtuar në betejë, në një ditë të bukur e të lumtur, të preheshin në shtëpinë e përjetshme në krah të njëri-tjetrit, në atë vend që Lincoln-i e quajti me ligj qeveritar "Vorreza Kombëtare" për të nderuar të gjithë ata që ranë trimërisht në Gettysburg pa dallim vendi (jugë-veri), race (të bardhë - me ngjyrë), besimi, apo partish politike.

Për të gjithë pjesëmarrësit e panumërt që ndodheshin në këtë ceremoni nga më mbresëlënëset, për të gjithë qytetarët e Shteteve të Bashkuara dhe për të gjithë botën e ditëve tona, Lincoln-i tregoi se popullit të vet i duhej paqja e lartësimi e jo shkatërrimi, lufta e ndarja, po bashkimi i përjetshëm i kombit të ri amerikan.

Lincoln-i me këtë frymë universale, tepër humane, mësimdhënëse për kohën e vet, fjalë e gjallë për gjithë njerëzimin sot, është shembull

## XHEVAT KALLAJXHI

në veçanti për të gjithë shqiptarët kudo që janë. Kemi shumë për të mësuar nga “Fjalimi i famshëm i Gettysburg-ut”, ku midis të tjerash ai tha:

“Jemi mbledhur për të kushtuar një pjesë të kësaj lufte, si vend çlodhjeje të përjetshme, për ata që dhanë jetën e tyre këtu, që ky komb të mund të jetojë. Kjo që bëjmë ne është një gjë me vend dhe e përshtatshme. Por, në një kuptim më të gjerë, ne nuk mund ta kushtëzojmë, nuk mund ta bekojmë, nuk mund ta shenjtërojmë këtë truall. Të gjithë heronjtë, të gjallë dhe të vdekur, që luftuan këtu, e kanë shenjtëruar aq shumë sa fuqia jonë e varfër nuk mund të shtojë e as të pakësojë asgjë. Bota do ta vërë re fare pak dhe nuk do ta mbajë mend për shumë kohë atë që bëjmë ne këtu, por nuk do ta harrojmë kurrë atë që bënë ata trima në këtë vend. Na takon neve të gjithëve që t’i kushtohemi veprës së pambaruar, të cilën ata, që luftuan këtu, e përparuan aq fisnikërisht gjer në këtë shkallë”.

\*

\* \*

Nga këto që u thanë nga Abraham Lincoln-i në Gettysburg dhe ajo që u vendos prej tij më pas, sot shqiptarët mund të mësojnë shumë.

Së pari, le t’i bashkojmë ata që patën një

## LINCOLN

ideal, lirinë, po i ndanë rrugët që ndoqën në jetë. Ashtu si Lincoln-i më përpara le të bashkojmë të vdekurit në strehëzën e përjetshme. Këtu dhe kështu fillon bashkimi ynë, i popullit, i trojeve, i interesave kombëtare dhe shpirtërore. Në të njëjtën atdhe të zë syri “Varrezat e dëshmorëve” të mbajtura mirë. Ato u takojnë të rënëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjatë tranzicionit, aty këtu nëpër atdhe, u ngritën “Varrezat e martirëve”. Edhe këto u takojnë të rënëve të krahut të shqiptarizms gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Një atdhe, dy palë varre, dy emërtime (“dëshmorë” dhe “martirë”) për ata, që edhe pse kundërshtarë patën një ideal, - Lirinë e Shqipërisë të pavarur dhe demokratike.

T’i bashkojmë varret, se ata u flijuan për Nënë e përbashkët. Në shtëpinë e përjetshme për shkak të kësaj Nënë ne nuk na lind asnjë e drejtë të lemë bijtë tanë, kujtimin dhe gjakun e tyre, trupat e tyre përjetësisht të ndarë e të përçarë, si popull pa tokë e Atdhe të përbashkët. E kërkon nderi ynë madhor, - bashkimi, vlera më e shenjtë që mbart një komb në historinë e vet.

Le t’i bashkojmë të rënët tek “Varreza e Kombit”, pa dallim ngjyrash ideologjike e politike. Ato i bashkon gjaku i tyre, që e falën për Shqipërinë.

## XHEVAT KALLAJXHI

Shembulli i Lincoln-it na grish që të flijuarit e çdo krahu e të çdo ngjyre, pa “yje” e “shpata liktori” të prehen në përjetësi te “Varreza e Kombit”, nën hijen e flamurit kuq e zi. Le të na zgjojnë të vdekurit. Nisma le të jetë shembull bashkimi për çdo shqiptar në trojet natyrore që edhe kombi ynë të mund të jetojë.

### *Ushtrimi i pushtetit*

Presidentët e fortë e të suksesshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kurdoherë janë mbështetur fort në ligj dhe zbatimin e tij pa lëkundje. Presidentët e shquar të Amerikës kanë nxjerrë p.sh. nga fjalët e thjeshta të nenit II të Kushtetutës Amerikane pushtet të madh presidencial.

Të tillë kanë qenë presidenti Xhorxh Uashington, Abraham Lincoln, Th. Ruzvelt, U. Uilson, Frenklin D. Ruzvelt. Presidenti Xh. Uashington u bë figurë kryesore në punët e jashtme kurse A. Lincoln-i, për të cilin e kemi fjalën, mbahet mend se si e përdori pushtetin e garantuar nga neni II i Kushtetutës Amerikane për të zhdukur skllavërinë dhe për të çliruar skllëverit gjatë Luftës Civile (1861-1865).

Lincoln-i, armik i betuar i skllavërisë, për zhdukjen e saj u mbështet në Kushtetutën e

## LINCOLN

Shteteve të Bashkuara në nenin II, amendamenti XIII, ku tekstualisht theksohet, citoj: “As skllavëria, as shërbimi i detyruar, me përjashtim të rasteve kur kjo shërben si formë dënimi për një krim, autori i të cilit gjykohet si fajtor në një proces të rregullt gjyqësor, nuk ekziston brenda Shteteve të Bashkuara apo në çfarëdo zone që ndodhet nën juridiksionin e tyre”.

“Shpallja e çlirimit” (lirisë së skllavërve - A.J.), siç cilësohet në “Shënimet sqaruese” të Kushtetutës së Sh.B.A-së është bërë nga Lincoln-i në vitin 1863.

Amendamenti XIII (në nenin II të Kushtetutës së Sh.B.A) u propozua më 31 janar 1865 dhe u ratifikua në 6 dhjetor 1865. Me këtë ligj iu dha fund skllavërisë dhe për kombin amerikan u çel një epokë e re.

Emri i Abraham Lincoln-it, me ligjin për zhdukjen e skllavërisë, u bë i pavdekshëm në Amerikë dhe jashtë saj.

Ushtrimi i pushtetit mbështetet në zbatimin rigoroz të kushtetutës, nenet e së cilës, sipas praktikës amerikane nuk mund të ndryshohen kohë e pas kohe, sipas interesave të ndryshme klanore apo politike.

Ushtrimi i pushtetit sipas shembullit të Lincoln-it është vlerë, është meritë...

Këtë meritë historike botërore Henry Kissinger

në librin “Diplomacia” e shpjegon kështu: “Asnjë president, me përjashtim mbase të Abraham Lincoln-it nuk është dalluar kaq shumë në historinë e Amerikës”. Pyetet përse ka ndodhur kështu. Përgjigjen e marrim përsëri nga Kissinger-i: “Çdo udhëheqës i madh ka rrugën e vet. E veçanta e tyre (pra edhe e Lincoln-it - A. J.) vjen nga aftësia për të dalluar sfidat që ende nuk janë të dukshme për bashkëkohësit e tyre”.

Dihet: Lincoln-i arriti të sendërtojë, mbi bazën e ushtrimit të pushtetit dy sfida historike: zhdukjen e skllavërisë dhe bashkimin e përjetshëm kombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

### *Qeveria e popullit*

Sot në botë abuzohet shumë kur trumbetohet me vend e pa vend sllogani “qeveri e popullit”. Kur ideja, shprehja e artë “Qeveri e popullit” shpërdorohet për interesa të tjera, larg interesave të sovranit, atëherë qeveria nuk është kurrë e popullit. Ajo është “qeveri” e klaneve të veçanta, e partive politike, apo qeveri që u shërbejnë interesave të familjarëve të zyrtarëve. Këto qeveri janë nepotike. Qeveri të tilla janë qeveri për “pushtet” personal, po kurrë për shtet ligjor e demokratik.

## LINCOLN

Qeverinë e vërtetë të popullit e gjejmë në kuptimin më të saktë të fjalës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tek shprehja “qeveri e popullit, prej popullit, për popullin”, ka vërejtur me të drejtë analisti Xhevat Kallajxhi, del në pah kuptimi i vërtetë i demokracisë amerikane, formuluar 146 vjet më parë nga A. Lincoln-i.

Demokracia amerikane është demokracia më e përparuar dhe më e konsoliduar në këto dy shekujt e fundit.

Abraham Lincoln-i kur bëri fjalë për “qeverinë e popullit”, së pari kupton se ajo i takon sovranit popull, ka dalë nga gjiri i sovranit dhe do t’i shërbejë me përkushtim sovranit popull.

Një qeveri e tillë “e popullit”, ka mbështetjen e gjerë dhe pëlqimin e të qeverisurve, është ajo që ndryshe nënkupton sundimin e shumicës.

“Qeveria e popullit është në angazhim të plotë të sigurojë të drejtat themelore të shumicës së qytetarëve, po pa prekur të drejtat e pakicës. Qeveria e dalë nga populli siguron zbatimin e drejtë të ligjit, përpara të cilit të gjithë pa dalim race, pasurie, rangu shoqëror apo fetar, ndihen të barabartë.

Në një shoqëri dhe qeveri të tillë e mbështetur në parime demokratike si ato që përmendëm më lart, shtetasit pa përjashtim mund të gjejnë të gjitha mundësitë për të bërë një jetë të lirë dhe



## XHEVAT KALLAJXHI

të marrin përsipër përgjegjësinë e vetqeverisjes, “pa qenë të shtypur nga dora e rëndë e shtetit”. (Cituar nga “Çfarë është demokracia?”, Botim i Agjencisë së Informacionit të Shteteve të Bashkuara, Dhjetor 1991, faqe 6).

### *Shpifjet... Gënjeshttrat...*

Në kohën që kalon shoqëria jonë sot, kushdo dëshmon pa ngurrim se shpifjet... gënjeshttrat... sharjet... diskriminimet në moralin personal apo familjar janë bërë modë. Konkurrenca si në tregun e mallrave të zhvleftësuar në mjediset e politikanëve, partiakëve, parlamentarëve dhe qeveritarëve kanë kapur sferat më të larta. Me shpifje e gënjeshttra mund të bësh karrierë të betonuar, mjaft të kesh guximin të shpifësh edhe për nuset e shenjta, edhe për motrat e ndershme. Kur shpif, trillon të paqena, kur përlyen edhe arin, kur gënjen me vetëdije, kur mashtron për të fshehur me vetëdije të vërtetën aq sa kërcënon edhe me “koburen” e brezit, merret me mend batakun ku kanë rënë zyrtarët e paguar nga xhepi i shpuar i taksapaguesve shqiptarë.

Shpifja dhe gënjeshttra në mjediset shqiptare i kishte rënë në sy edhe mendimtarit Faik Konica. Për këtë qëllim të “Gazeta e Korçës” (1926) në shtyllën e vet boton një episod nga

## LINCOLN

jeta e Abraham Lincoln-it. E vlen ta përmendim për vetë arsyen e thjeshtë se tek ne shpifja dhe gënjeshtria janë shkrirë e bërë njësh me të vërtetën në një amalgamë ku nuk mund të dallosh asnjërin.

Episodi që tregon Konica është ky: “Një ditë një oficer që kishte prova të plota për disa shpifje i kërkoi presidentit Lincoln që t’i botojë. Lincoln-i nuk i dha leje dhe i tha: “Po të shkojmë kohën duke përgënjeshtuar shpifjet, duhet ta mbyllim “këtë dyqan” se nuk do të na mbetej asnjë minutë për punë”. Dhe shtoi: “Në qoftë se veprimet tona venë mbarë, sukcesi ynë për të mirën e popullit është përgënjeshtrimi i plotë i shpifjeve; në qoftë se nuk mbarojmë dot punë, atëherë sikur dhjetë engjëj të dëshmojnë në favorin tonë, s’kemi për të shpëtuar nga dënimi”.

Konica shton dhe këto: “Sado të trasha të ishin të sharat, sado qesharake të ishin shpifjet e gënjeshttrat, Lincoln-i, kurrë s’ka bërë kabull t’i përgënjeshtrointe.”.

Lincoln-i këtu gjykon sipas një pasioni personal të cilin e shpreh shumë qartë kështu: “Të gjithë njerëzit mund t’i gënjeshtrojnë për disa kohë. Disa njerëz mund t’i gënjeshtrojnë për gjithë kohën. Por nuk është e mundur të gënjeshtrojnë gjithë njerëzit për të gjithë kohën”. Çdo koment do të ishte i tepërt me këto fjalë aq të qarta.

## XHEVAT KALLAJXHI

- *Karl Senberg, Abraham Linkoln, "Apollonia", 1993.*
- *Uran Butka, historian, referat: Jeta dhe veprimtaria e Xhevat Kallajxhiut, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Tiranë, 2004.*
- *Xh. Kallajxhi, Lincoln, NY, 1961.*
- *Xh. Kallajxhi, John F. Kennedy, NY, 1980.*
- *Alqi Jani, studiues, referat: Xhevat Kallajxhiu, personalitet i shquar i nacionalizmit shqiptar, me rastin e 95-vjetorit të lindjes, Gjirokastër 1999.*
- *Anton Çeta, "Dielli", Oktober-December 1915, page 7.*
- *Faik Konica, Presidenti Lincoln dhe shpifjet, "Gazeta e Korçës", 1926, nr. 292.*
- *Stefan Bulo, studiues, "Skënderbeu" i Xh. Kallajxhiut, shprehje e formimit dhe krenarisë kombëtare të autorit.*
- *"Republika", Kallajxhiu, ambasador i gazetarisë, 19, 12. 2004.*
- *Petro Vinçani, Xhevat Kallajxhiu, kryeplak i fletorisë shqiptare, "Koha Jonë", nr.1-2-3, janar-shkurt-mars 1984.*
- *"Koha Jonë", nr. 4-5-6, prill-maj-qershor 1979.*
- *"Rilindja Demokratike", Abraham Lincoln, një burrë që fliste vetë, dt. 20.06.2009, përgatitur nga Klareta Bajraktari.*
- *Çfarë është demokracia, Agjensia e informacionit e Shteteve të Bashkuara, Dhjetor 1991.*

## LINCOLN

### PARATHËNIE

Dita 12 Shkurt 1809 është një datë e shënuar në historinë e Shteteve të Bashkuara. Në atë ditë lindi Abraham Lincoln-i, të cilin fati e caktoi të bëhej presidenti i 16-të i Amerikës dhe t'i sillte shërbime të shquara kombit të tij. Abraham Lincoln-i lindi në një kasolle të drunjtë të një familjeje të thjeshtë e të varfër pionierësh, në pyjet e Shtetit Kentucky. Si në moshën e foshnjërisë ashtu dhe në atë të rinisë kaloi një jetë vobeksije të madhe. Nuk pati mundësi të marrë një arsim të rregullt dhe gjer në moshën njëzetedyvjeçare punoi si bujk, si druvar, si detar, etj. Kur ishte i vogël, mezi kreu ndonjë vit shkollë. Por kishte një vullnet të fortë dhe studioi vetë, duke zhvilluar në këtë mënyrë vetveten. U bë më në fund avokat dhe mori pjesë aktive në politikë. Dhe për hir të përpjekjeve të pareshtura, ndjenjave patriotike të pastra, ideve liberale dhe ndershmërisë së madhe, Abraham Lincoln-i mundi të ngjitej, nga një shtresë e ulët e shoqërisë, në majën më të lartë të pozitës shtetërore.

Në vitin që kaloi<sup>1</sup> u mbushën 150 vjet qysh

<sup>1</sup> Autori e ka fjalën për vitin 1959, - "viti i Lincoln-it", kur ai mbushi 150 vjetorin e lindjes (1809-1959). Red.

## XHEVAT KALLAJXHI

prej kohës që lindi Abraham Lincoln-i. Për këtë arsye, populli amerikan ia kushtoi vitin 1959 kujtimit të Lincoln-it. Gjatë atij viti u organizuan një varg kremtimesh e manifestimesh të ndryshme në kujtim të këtij biri të madh e të pavdekur të Amerikës. Ndërkohë u botuan edhe një sërë veprash të reja për Lincoln-in. Përveç kësaj, 150-vjetori i lindjes së Lincoln-it u përkujtua edhe nga të gjithë njerëzit e lirë kudo. Me këtë rast, edhe ne e pamë të arsyeshme që t'u paraqitim diçka lexuesve shqiptarë, në gjuhën shqipe, mbi jetën dhe veprat e Abraham Lincoln-it<sup>1</sup>. Ky botim i ynë nuk është një histori ose biografi e shkruar me kritere teknike dhe shkencore. Është vetëm një përshkrim i thjeshtë i bazuar, natyrisht, në fakte dhe shënime historike.

\* \* \*

Abraham Lincoln-i është një nga figurat më të shquara të historisë amerikane dhe një nga njerëzit e rrallë të botës. Jo vetëm në historinë

*1. Më 1926 i ndjeri C.A.Chekrezi botoi në Shqipëri një vepër të vogël me titullin "Shpërbleja e Përplotë" mbi Lincoln-in. E përktheu shqip nga vepra e shkrimtares së njohur amerikane M.R.S.Andrews në gjuhën anglishte kjo vepër e ka titullin "The Perfect Tribute", dhe në "të përshkruhet, në formë romani, një episod nga jeta e Lincoln-it. Këtë përkthim i ndieri Chekrezi e ka shoqëruar edhe me një parathënie të shkruar prej tij, në të cilën ve në dukje disa njoftime mbi jetën dhe veprat e Lincoln-it.*

## LINCOLN

e Republikës së re Amerikane, por në krejt atë të njerëzimit kanë qenë të paktë ata burra që kanë lënë gjurmë të thella të veprës së tyre, gjurma të cilat nuk mund t'i mbulojë kurrë pluhuri i kohës. Midis këtyre burrave të paktë, ngrihet lart me madhështi figura e Lincoln-it si njeri dhe si patriot. Prandaj populli amerikan nderon kujtimin e Lincoln-it pa rezervë dhe pa ndryshim besimesh politike. Populli amerikan, duke nderuar Lincoln-in, nuk nderon vetëm një nga presidentët e tij të shquar, por edhe një nga burrat e rrallë, të cilët, në të gjitha kohët, kanë kontribuar - me besimin e apostujve dhe vendosmërinë e martirëve - në rrënjosjen e idesë demokratike gjatë historisë shekullore.

Lincoln-i mbrojti gjithnjë në jetën e tij me vetëmohim kauzën e lirisë. Foli për të me vendosmëri dhe besim të thellë. Ai që flet për liri në një mënyrë të tillë flet për të gjitha kohët dhe për të gjithë njerëzimin. Ai tha në një rast këto: "Përpyekja për liri duhet të vazhdojë gjithnjë. Kauza e lirisë nuk duhet të marrë fund në mbarimin e një viti ose në mbarimin e një shekulli. Në të drejtën e tyre për të jetuar të lirë e të lumtur, të gjitha racat janë të barabarta. Zemra njerëzore është me ne... Perëndia është me ne... Gjithë njerëzimi duhet të jetë i lirë". Këto dhe shumë fjalë të tjera të skalitura të

## XHEVAT KALLAJXHI

Lincoln-it - drejtuar ndërgjegjes së njerëzimit - frymëzojnë kurdoherë shpirtat e miliona vetëve për të luftuar me guxim çdo formë të tiranisë.

“Duke u dhënë lirinë atyre që janë skllëvër, ne e sigurojmë gjithashtu lirinë edhe për ata që janë të lirë”, tha Lincoln-i më 1861. Këto fjalë mbajnë gjithnjë vulën e së vërtetës. Fakti është që pas një shekulli këto fjalë të Lincoln-it përbëjnë një paralajmërim edhe për kohën e sotme, kur bota ndodhet në vigjiljen e një periudhe të re historike, në të cilën mund të vendoset fati i krejt njerëzimit për shumë shekuj të ardhshëm. Besojmë se s’ka asnjë njeri që nuk e kupton se në epokën tonë - që cilësohet si një epokë e ndritur dhe qytetërimtare - bota ka rënë disa herë në një humnerë shkatërrimesh, persekutimesh, urrejtjesh e pasionesh, të cilat e bëjnë një person aq skllav sa ç’ishin edhe ata që liroi Lincoln-i.

\* \* \*

Në një rast tjetër Lincoln-i tha këto: “Nuk dëshiroj të jem as skllav, as zot skllëvëri”. Këto pak fjalë pasqyrojnë filozofinë e politikës së ndërgjegjshme të Lincoln-it, i cili luftoi si skllavërinë fizike, ashtu dhe skllavërie politike. Por ai luftoi njëkohësisht edhe një skllavëri tjetër, të cilën mund ta quajmë skllavëri morale. Kjo skllavëri - që robëron shpirtin - konsiston

## LINCOLN

në urrejtje dhe në hakmarrje. Qëndrimin e tij kundër kësaj skllavërie Lincoln-i e ritheksoi me fjalët fisnike që përdori në ligjëratën që mbajti përpara Kongresit kur u zgjodh për herën e dytë president i Shteteve të Bashkuara më 1864. Fjalët e tij ishin këto: “Me urrejtje kundër askujt, me mirëdashje ndaj të gjithëve...”. Me këto fjalë - në të cilat vihen në dukje ndjenja të thella njerëzore - Lincoln-i vulosi një pakt dashurie. Gjithashtu me këto fjalë vihet qartë në dukje njeriu i zhveshur nga pasionet partizane; njeriu i lirë në shpirt e në trup; vëllai i të gjithëve, i cili, si president, qëndroi përmbi grupet dhe partitë dhe foli si përfaqësues i krejt kombit.

Prandaj në ditët tona, në të cilat shpesh herë urrejtja, cmira dhe hakmarrja duket se përbëjnë të vetmet mjete që e vënë në lëvizje njerinë, pamja e jetës dhe e veprës së këtij Amerikani të Madh shkëlqen në një mënyrë madhështore. Dhe vlen të përmendet këtu se Lincoln-i kujtohet gjithnjë me fjalët “Honest Abe” për drejtësinë dhe ndershmërinë e tij. Në fakt, ai nuk e përdori kurrë gënjeshtren për të arritur një qëllim dhe nuk tradhtoi kurrë ndonjë nga idealet e tij për të patur një përfitim politik. Me gjithë këtë, edhe Abraham Lincoln-i, si njeri, kishte të meta. Kishte gjithashtu edhe kundërshtarë, sidomos në kohën gjatë së



## XHEVAT KALLAJXHI

cilës zhvilloi një veprimtari të gjallë politike dhe u zgjodh Presidenti i Amerikës. Këta kundërshtarë e sulmuan me rreptësi dhe e përçmuan me epitete të ndryshme. Por, përsëri, të metat e pakta shuheshin përpara virtyeteve të shumta që kishte Lincoln-i, të cilat i njihnin edhe kundërshtarët e tij më të rreptë.

Lincoln-i, i cili jetoi me popullin dhe punoi për popullin, ishte i vetëdijshëm për realitetin e gjërave dhe dobësitë e njerëzve. Por, me gjithë këtë, nuk e humbi nga sytë kurrë rrugën që kishte për të ndjekur. Vendosmëria në idealet dhe karakteri i tij i fortë, e lejuan atë që të shkojë përpara dhe të kapërcejë ngjarjet e vështira që kishin rënë mbi kryet e kombit në kohën kur ishte ai president. Lincoln-i e përqafoi me guxim kauzën e të dobëtëve dhe të mjerëve. Me të njëjtin guxim ai shpalli kushtin e domosdoshëm për respektimin e dinjitetit të njeriut, cilado që të ishte raca, gjuha dhe feja e tij.

\* \* \*

Me besim të thellë ndaj Zotit dhe me ndërgjegje të pastër ndaj veprës së tij njerëzore, Lincoln-i deklaroi një herë se “do ta mbronte të vërtetën dhe të drejtën gjer në vdekje”. Dhe e mbrojti. Nuk u ndal dhe nuk u tut kurrë. Ishte

## LINCOLN

i vendosur në mendimin e tij. Ishte gjithashtu i vetëdijshëm për rolin që i kishte caktuar fati të lozte në shërbim të atdheut. Lincoln-i e gjente zakonisht frymëzimin, për të plotësuar misionin e vet, në vetvete, në mendimin e tij të qartë, në guximin e tij moral, në zemrën e tij të sinqertë dhe bujare. Qëndrimi njerëzor i Lincoln-it, por njëkohësisht edhe intransigjent përkundrejt një prej problemeve më të rënda të kohës së tij, krijoi një shembull të çmuar për të gjithë ata që, pas tij, u desh të përballonin zgjidhjen e problemeve të tjera të vështira e të koklavitura, si në fushën politike ashtu dhe në fushën ekonomike e shoqërore.

Lincoln-i e kishte theksuar qartë se shoqëritë lartësohen vetëm duke u njohur të gjithë pjesëtarëve të drejta të barabarta. Ai nuk kufizohej vetëm të shpallte idera dhe parime, por njëkohësisht i pasonte ato dhe përpiquej me të gjitha fuqitë e tija që t'i realizonte. Lincoln-i vepronte kështu jo vetëm se ndihej përgjegjës për misionin e tij, por edhe sepse kishte besim të patundur në të ardhmen e kombit të vet. Prandaj shpalli solemnisht se “qeveria e popullit, prej popullit, për popullin nuk do të zhduket nga faqja e dheut”. Ky ishte një nga trashëgimet e çmuara që la Lincoln-i, njeri prej bijve më të shquar të Botës së Re.

Lincoln-i, ky burrë i madh që lindi në një

## XHEVAT KALLAJXHI

kasolle të vogël, plotësoi, si prijës i një kombi të ri, një mision historik me rëndësi. Ky ishte një mision tepër i rëndë dhe Lincoln-i, me gjithë se e kuptoi tragjedinë e Jugut dhe ndjeu dhimbje të thellë për luftën civile, qëndroi i patundur në bindjen e tij, pasi nuk ekzistonte asnjë justifikim moral që të lejonte vazhdimin e skllavërisë në një vend ku shumica e madhe e popullit dëshironte ndërtimin e një shoqërie me të vërtetë të lirë e demokratike. “Besimi ynë - tha një herë Lincoln-i - qëndron në dashurinë për liri, të cilën Perëndia e ka rrënjosur në shpirtrat tona. Mbrojtja jonë qëndron në ruajtjen e frymës që e çmon lirinë si një trashëgim për të gjithë njerëzit, kudo.

Leon Tolstoi e ka përshkruar Lincoln-in si humanitarin më të madh të botës. Dhe historiani francez Henri Martin, ka thënë se “Lincoln-i do të qëndrojë në traditat e vendit të tij dhe të botës si një mishërim i popullit dhe i vetë demokracisë moderne”. Lincoln-i besonte që populli është burimi më i madh i një kombi; besonte që çdo njeri i varfër ka të drejtë të përmirësojë fatin e jetës së tij me mjete të ndershme; besonte në të drejtën e të mësuarit për të gjithë njerëzit, pa ndryshim ngjyre ose shkalle shoqërore; besonte se të gjithë njerëzit kanë mundësinë të jetojnë në një gjendje të begatshme, po të jetë se zhvillohen aftësitë e tyre të brendshme; besonte se respekti

## LINCOLN

ndaj ligjeve duhet të jetë si një farë “fe politike”; besonte gjithashtu në traditën e lirisë. Dhe arsyeja që Lincoln-i foli gjithnjë në favor të lirisë së mendimit, të lirisë së fjalës, të lirisë së shtypit, të lirisë së mbledhjes dhe të lirisë së fesë.

Mund të thuhet se, pas George Washingtonit, Abraham Lincoln-i qëndron si figura më e madhe në kujtimin e popullit amerikan, qoftë se njeri, qoftë si president. Ndofta figura e Lincoln-it merr një pamje akoma më madhështore edhe për faktin se u ngjit lart nga një shkallë e ulët e shoqërisë dhe e zhvilloi vetveten në një mënyrë të habitshme. Mund të thuhet gjithashtu se, pas George Washingtonit - që quhet “Babai i Kombit” - asnjë president tjetër në historinë e Amerikës nuk i përballoi përgjegjësitë e detyrës së tij të lartë me një vetëdije dhe vendosmëri aq të madhe sa i përballoi Abraham Lincoln-i, i cili mundi të arrijë dy objektiva me rëndësi: *zhdukuri sistemin e skllavërisë dhe siguroi bashkimin e përzjetshëm të kombit.*

\* \* \*

Kanë kaluar 95 vjet<sup>1</sup> qysh prej ditës që plumbi i një atentatori i dha fund jetës së Abraham Lincoln-it në një kohë kur kishte triumfuar plotësisht kauza së cilës ai i ishte

<sup>1</sup> Nga viti 1863 kur u vra Lincoln-i deri në vitin 1958 kur autori i librit punonte për monografinë kishin kaluar 95 vjet.

## XHEVAT KALLAJXHI

kushtuar me gjithë zemër. Por fjalët e tij, që i drejtoi ndërgjegjes së përjetshme të njerëzimit për drejtësi dhe liri, vazhdojnë të qëndrojnë të gjalla në zemrat e krejt popullit amerikan dhe në zemrat e miliona vetëve në të gjitha anët e botës. Janë fjalë të skalitura, të cilat i bëjnë shpirtrat e njerëzve të fitojnë gjithnjë një forcë të re kundër çdo sistemi shtypës.

Lincoln-i tha një herë se “njerëzit nuk mund të jetojnë gjysmë të lirë dhe gjysmë skllavër”, dhe e përshkroi “Deklaratën e Pavarësisë Amerikane” me këto fjalë: “Liri jo vetëm për popullin e këtij kombi, por edhe shpresë për të gjithë botën dhe për të gjitha kohët e ardhme”. Dhe në një rast tjetër ai tha këto: “Ne duhet të marshojmë krah për krah me armatën e madhe të lirisë... Ka një Perëndi, dhe Ai e urren padrejtësinë dhe skllavërinë... Ai që nuk dëshiron të jetë skllav, nuk duhet të pranojë të ketë skllavër. Ata që u mohojnë lirinë të tjerëve, nuk e meritojnë lirinë për vete; dhe nën drejtësinë e Zotit, nuk do të vazhdojnë të sundojnë një kohë të gjatë”.

Abraham Lincoln-i cilësohet si “kampioni universal i lirisë, drejtësisë dhe demokracisë” dhe emri i tij është bërë i pavdekshëm jo vetëm në historinë e Amerikës, por edhe në historinë e gjithë botës. Llogaritet se qysh prej vitit 1837 e gjer sot janë botuar në Shtetet e Bashkuara

## LINCOLN

më tepër se 5000 libra, biografi, broshura e të tjera mbi Lincoln-in. Janë botuar gjithashtu mbi të edhe me qindra vepra e biografi në vende të huaja, në më tepër se 32 gjuhë të ndryshme.

Përveç këtyre, në të gjithë anët e Shteteve të Bashkuara janë ngritur me qindra statuja, përmendore dhe buste për Lincoln-in. Ndërkohë me emrin e tij janë quajtur qytete, institute të ndryshme, kopshte publike dhe shumë gjëra të tjera. Gjithashtu për Lincoln-in janë ngritur statuja e buste edhe në disa vende të ndryshme të botës si në Angli, Norvegji, Filipinet, Francë, Kubë, Itali e gjetkë.

Mund të themi se nuk ka asnjë njeri tjetër në botë që të jetë nderuar e përkujtuar aq shumë sa Lincoln-i si në vendin e tij ashtu dhe në vende të tjera. Por, me gjithë këtë, mund të themi përsëri se, për ta bërë të pavdekshëm kujtimin e këtij Biri të Madh të Amerikës, ndofta do të mjaftonin vetëm dy fjalë: ABRAHAM LINCOLN.

Washington D.C. Prill 1960

XHEVAT KALLAJXHIU

## FËMIJËRIA E LINCOLN-IT

I pari i Abraham Lincoln-it quhesh Samuel, i cili, së bashku me të shoqen Martha, erdhi nga Anglia në Botën e Re më 1637 dhe u vendos në Hingham, Massachusetts. Ai ishte “Quaker”<sup>1</sup> dhe kishte shumë fëmijë. Pas një kohe tepër të gjatë pasardhësit e Samuel-it u transferua në Berks County të Pennsylvania-s ku kishte një numër të madh “Quaker” - ish englezë, gjermanë, holandezë, skocezë etj. Shumë vjet më vonë, pasardhësit e të parëvet të Libcoln-it shkuan në Rockingham County të Virginia-s. Andej gjyshi i Lincoln-it, Abraham-i, emigroi në Keuntucky midis vitit 1781-1782, ku pas nja dy vjete u vra nga Indianët, jo në luftë por në pusi, kur po punonte për të spastruar një copë tokë për ta përdorur për bujqësi.

1. *“Quaker”-t janë anëtarë të një sekti fetar, të cilët kundërshojnë çdo formë të despotizmit. Përkrahin pushtetin qeveritar, por njëkohësisht kërkojnë që të garantohet e drejta e popullit nga çdo abuzim nga ana e pushtetit. Respektojnë ligjin, sepse - sipas besimit të tyre - “liria pa bindje është konfuzion dhe bindja pa liri është skllavëri”. Me gjithë se janë kundër përdorimit të armëve, kundër lufës dhe kundër shërbimit ushtarak, përsëri “Quaker”-it ishin të parët që ngritën krye kundër Anglisë për pavarësinë e kombit të tyre të ri, dhe ishin gjithashtu të parët që kërkuan zhdukjen e skllavërisë.*

## XHEVAT KALLAJXHI

Gjyshi Abraham kishte gjashtë fëmijë, më i vogli prej të cilëve ishte Thomas-i. Kur u vra gjyshi Abraham, Thomas-i ishte nja gjashtë vjeç. Thomas-i u rrit me vuajtje të shumta dhe nuk mundi të mësojë dot as të shkruajë e të lexojë emrin e tij. Në Qershor të vitit 1806 Thomas-i u martua me Nancy Hanks. Kur u martuan, ndërjuan një kasolle të drunjtë në vendin Licking River dhe filluan jetën familjare. Mjeshtëria kryesore e Thomas-it ishte bujqësia, por kishte mësuar njëkohësisht edhe mjeshtërinë e zdrukthtarisë. Prandaj kur u vendos në Licking River, Thomas-i shkonte shpesh herë punonte edhe si zdrukthtar në Elizabethtown, ku ndërtoheshin banesa, kisha dhe shkolla të reja. Elizabethtown ishte disa kilometra larg nga vendi ku jetonte Thomas-i me të shoqen. Në Licking River u lindi një çupë, të cilën e pagëzuan me emrin Sarah.

Më vonë Thomas-i me të shoqen u shpërngulën në vendin Harding County, nja gjashtë kilometra në jug të Hodgenville. Atje ai ndërtoi një kasolle në pikën Nolin River dhe filloi të merresh me bujqësi. Në atë kasolle lindi ai të cilin fati e caktoi të bëhej presidenti i 16-të i Shteteve të Bashkuara. Ky mysafir i ri, i cili lindi më 12 shkurt 1809, u pagëzua me emrin Abraham, në kujtim të gjyshit të tij.



## LINCOLN

Më 1811, kur Abraham-i ishte dyvjeçar, familja e tij u shpërngul në Knob Creek. Knob Creek-u që ndodhesh nja 16 kilometra larg nga vendi ku kishte lindur Abraham-i i vogël, ishte një zonë me brigje shkëmbore, me pyje të dendur, me gremina të thella dhe me lugina romantike. Edhe atje Thomas-i ndërtoi një kasolle të re, spastroi disa dynym tokë, mbolli misër, patatet e kunguj, dhe gjuajti drerë e gjela-deti të egër. Në atë vend familja e Thomas-it qëndroi afro pesë vjet.

Më 1816, kur Abraham-i ishte shtatë vjeç, familja e Thomas-it u shpërngul në vendin Pigeon Creek, në një kënd në jugperëndim të Indiana-s. Ai ishte një vend i egër dhe banorët në të ishin shumë të pakët. Kasollja e drunjte e familjes së Thomas-it në Pigeon Creek kishte çatinë, dyshemenë dhe ishte e mbyllur vetëm nga tri anë, ndërsa nga ana e katër hynte shiu, suferina dhe dëbora. Në atë kasolle, pjesëtarët e familjes së Thomas-it flinin në shtretër të bëra prej drurësh dhe për shtresë e mbulesë përdornin lëkurë të shtazëve të egra. Dhe stinët e dimrit në atë krahinë ishin shumë të rrepta.

Abraham-i nuk mundi dot të merrte një arsim të rregullt. Arsyeja ishte se në shumë vende, ku kaloj moshën e vegjëlisë, nuk kishte shkolla. Por edhe në ndonjë vend ku kishte shkollë, ai nuk mund të vazhdonte gjatë për shkak të kushteve të

## XHEVAT KALLAJXHI

vështira ekonomike në të cilat ndodhej familja e tij. Me gjithë këtë, më parë se familja e Thomas-it të largohesh nga Kentucky, Abraham-i dhe motra e tij Sarah shkuan për të mësuar, për një kohë të shkurtër, në një farë shkolle që kishte çelur një i quajtur Hazel Dorsey.

Hazel Dorsey nuk ishte një mësues i karrierës dhe shkolla e tij - e cila ndodhej disa kilometra larg nga kasollja e Thomas-it - nuk mund të quhesh shkollë. Dorsey ishte një njeri i mirë, dinte të shkruante e të lexonte dhe njihte rregullat fillestare të matematikës. Prandaj vetëm këto gjëra mund t'u mësonte nxënësve të tij fshatarë. Për këtë shërbim, komuniteti i paguante një shpërblim të vogël. Bile në kohët e lira ai merrej me punëra bujqësore dhe priste dru.

Dorsey kishte simpati për Abraham-in e vogël dhe e ndihmonte që të mësonte sa më mirë, se e shihte që kishte një zell të madh për të mësuar. Por, me gjithë këtë, Abraham-i mundi ta vazhdojë shkollën vetëm nja gjashtë muaj. Rruga e gjatë dhe dimri i keq e pengonin fort. Pastaj ndonëse i vogël, duhesh të ndihmonte edhe të atin me ndonjë punë të lehtë.

Por përsëri, vlen të thuhet këtu se Abraham-i mundi të mësojë të shkruajë e të lexojë, në radhë të parë, për hir të interesimit të madh që tregoi nëna e tij Nancy, dhe, në radhë të

## LINCOLN

dytë, për hir të kujdesit të veçantë që tregoi mësuesi-druvar, Hazel Dorsey, Nancy kishte një dhëmshuri të thellë për birin e saj Abraham-in dhe dëshironte me gjithë shpirt që të shihte një fat më të mirë për 'të, por, mjerisht, nuk pa kurrë një shenjë të tillë. Abraham-i ishte i vetëdijshëm për dhëmshurinë dhe aspiratat që kishte mëma e tij për 'të. Prandaj në dashurinë e saj gjente ngushëllim dhe forconte shpresat për një të ardhme më të mirë. Dhe disa vjet më vonë ai tha këto: "Çka jam e çka shpresoj të jem i a detyroj mëmës s'ime engjëll".

Nancy vuajti tërë jetën e saj. Qysh në fillim e gjer në mbarim nuk pa kurrë një ditë të bardhë. Ndoshta është e tepruar, por thuhet se ajo, duke mos qenë në gjendje të blente gjilpëra, i qepte ndërresat e familjes me thumba prej pishe! Kjo tregon se në ç'gjendje të mjerueshme ndodhej familja e Thomas Lincoln-it. Por kjo gjendje nuk vazhdoi një kohë të gjatë, të paktën për Nancy-n, e cila u sëmur nga "sëmundja e qumështit" dhe më 5 tetor 1818 mbylli sytë për jetë. Nga kjo sëmundje vdiqën në Pigeon Creek edhe disa të tjerë, dhe vdiqën pa asnjë shërbim mjekësor, pasi në ato vende, në mes të pyjeve, nuk kishte doktorë.

Kjo ishte asikohejeta e vështirë që përballonin përgjithësisht pionierët...

## XHEVAT KALLAJXHI

Besohet se Nancy vdiq në moshën 35-vjeçare. Nuk dihet me saktësi as vendi ku lindi dhe as data. Emri i saj filloi të kujtohet e të nderohet shumë vjet më vonë kur i biri Abraham u bë i famshëm. Mirëpo atëherë njerëzit që e kishin njohur ose parë Nancy-n ishin shpërndarë ose kishin vdekur pothua që të gjithë. I vetmi nga këta që kishte mbetur akoma gjallë ishte William Wood-i, i cili kishte qenë dikur në Indiana një nga fqinjët e Thomas Lincoln-it për dy vjet me radhë dhe kishte kaluar një natë të tërë pranë shtratit të Nancy-t kur ra e sëmurë dhe vdiq. Wood-i e kishte njohur mirë. Nancy-n dhe kishte parë vuajtjet e saj të tmerrshme, të cilat ajo i përballonte me një durim të çuditshëm. E kujtonte gjithnjë me admirim për shpirtin bujar dhe sjelljet e saj fisnike. Në moshën 82-vjeçare, William Wood-i i bëri William Herndon-it<sup>1</sup>, më 15 shtator 1865, këtë deklaratë mbi Nancy-n:

“Abraham-i u zhvillua mendërisht dhe vuri baza morale nga mëma e tij e mirë. Zonja Lincoln ishte një grua shumë e zgjuar dhe e mësuar. Ajo kishte një zgjuarsia natyrale të madhe. Ishte një grua e sjellur, fisnike dhe zemërmirë. Ishte

*1 William Herndon e njohu mirë Abraham Lincoln-in, sepse shumë vjet më vonë, më 1844, këta të dy u bënë ortakë në një zyrë avukatore në Springfield të Shtetit Illinois. Dhe më 1889 Herndon-i, së bashku me J.W.Weik, botoi një vepër në tre volume mbi jetën e Lincoln-it me titullin “The True Story of a Great Life”.*

## LINCOLN

një e krishtere e sektit baptist. Ishte një grua e pashme dhe e sinqertë. Unë nuk besoj që ajo vdiq kryesisht nga “Sëmundja e qumështit”. Ndofta kjo ndihmoi për vulosjen e fatit të saj”.

Fleta e fundit e librit të jetës plot hidhërimi të Nancy-t u mbyll midis lotëve të të shoqit, sidomos të fëmijëve të mjerë, të cilët e vajtuan një kohë të gjatë. Varrimi i Nancy-t u bë në një mënyrë të thjeshtë - ashtu sikundër e thjeshtë kishte qenë edhe jeta e saj - nga i shoqi, nga të dy fëmijët dhe nga disa fqinj të tyre. Kur vdiq Nancy, Abraham-i ishte 9 vjeç dhe motra e tij Sarah 11 vjeç. Me vdekjen e Nancy-t gjithë barra për punët e shtëpisë ra mbi kurrizin e njomë të Sarah-ës, ndërsa Abraham-i i vogël i u shtrua punëvet të jashtme të ndryshme së bashku me të atin.

Në shtëpinë e Thomas-it mungonte çdo gjë. Me vdekjen e Nancy-t mungoi edhe dashuria e nënës. Prandaj motër e vëlla mblidheshin shpesh herë kokë më kokë në ndonjë kënd të kasolles dhe qanin me ngashërim orë të tëra. Jetimët e mjerë gjenin një farë ngushëllimi vetëm në lotët që buronin nga fundi i shpirtit të tyre të zhuritur.

Pasi kaluan shumë muaj, Thomas-i e pa se në kasollen e tij ndihej nevoja për një grua tjetër. Në atë rast mendja i vajti tek Sarah Bush Johnston,

## XHEVAT KALLAJXHI

e cila banonte në Elizabethtown, në Kentucky. Sarah quhej edhe me emrin Sally. Thomas-i e kishte njohur kur punon si zdrukthëtar në Elizabethtown. Burri i saj Johnston kishte vdekur dhe ajo kishte mbetur e ve me tri fëmijë: me një djalë dhe dy vajza, të cilët quheshin John, Matilde dhe Sarah. Thomas-i u nis për në Elizabethtown, ku më 2 dhjetor 1819 u martua me Sally-n. Pas disa javësh u kthye në kasollen e tij në Pigeon Creek, duke sjellur me vete një njerjë për Abrahamin dhe Motrën e tij Sarah.

Sally ishte një grua e fortë, e pashme, e qeshur dhe e gëzuar. Ishte krejt e kundërta e natyrës melankolike të Nancy-t. Me arritjen e Sally-t, rrethi familjar i Thomas Lincoln-it u shtua, pasi ajo, së bashku me mobilet dhe orenditë e shtëpisë solli me vete edhe të tri fëmijët e saj. Porsa arriti, Sally pastroi e rregulloi banesën e braktisur të Thomas-it. Lau, pastroi dhe filloi të ushqejë me kujdes të dy fëmijët e mbetur shkretë të Nancy-t. Abraham-it i hoqi cergat e vjetra, e veshi siç duhesh dhe e dërgoi në shkollën e fshatit së bashku me të tjerët. Ajo e nxiste Abraham-in që të mësonte. Duket se vuri re disa cilësi të rralla tek ai djalë i rritur në pyje. Dhe e quajti Abraham-in djalin më të mirë që kishte parë në jetën e saj. Për këtë dhëmshuri dhe kujdes që tregonte Sally, Abraham-i filloi

## LINCOLN

ta shihte jo si njerke, por si një mëmë të vërtetë, si një grua fisnike që e bëri ta ndjente veten, për të parën herë, njeri.

Abraham-i vazhdonte shkollën, ndihmonte të atin në punëra të ndryshme dhe studionte vetë duke shkruar, me një kokërr qymyr, mbrapa një lopate të drunjtë, të cilën e përdorte në vend të dërrasës së zezë. Abraham-i lexonte çdo gjë që i binte në dorë. Në fillim, në kasollen e Thomas Lincoln-it ndodheshin vetëm këto tri libra të vjetra: një Abetare, një Ungjill dhe një Almanak, të cilat Abraham-i i kishte studiuar me rrënjë. Kur erdhi Sally solli me vete edhe këto libra: “Jeta e Robinson Crusoe”, “Përparimi i Pelegrinëvet” dhe “Prallat e Esopit”. Edhe këto libra Abraham-i i studioi me rrënjë. Veçanërisht me studimin e Ungjillit, ai mësoi të vërteta e mëdha morale dhe formoi stilin dhe mënyrën e tij për të shkruar e për të folur.

Më vonë Abraham-i studioi “Historinë e Shteteve të Bashkuara”, “Dekllaratën e Pavarësisë”, “Kushtetutën” dhe “Jetën e George Washingtonit”. Këto vepra ai i bleu me të hollat që fitoi duke punuar disa ditë për Josiah Crawford për 25 qindarka në ditë.

Librat që përmendëm më sipër përbënin krejt bibliotekën e Abraham Lincoln-it gjatë kohës që ai jetoi në Pigeon Creek. Me gjithë

## XHEVAT KALLAJXHI

këtë, ai kishte rast të lexonte edhe vepra të tjera. Crawford-i huante, herë pas here, libra të ndryshme Abrahamit përkundrejt ndonjë pune të vogël që ky i bënte atij.

Edhe në Pigeon Creek Abraham-i vazhdoi në shkollë vetëm gjashtë muaj, duke plotësuar kështu - së bashku me të gjashtë muajt e Knob Creek-ut të Mektucky-t - një vit shkollë të rregullt. Me gjithë këtë, me këtë pak shkollë dhe me studimet e bëra vetë, Abraham-i zhvilloi mjaft njohurinë dhe imagjinatën e tij në një moshë fare të re.

Shpesh herë ai shëtiste vetëm në pyje dhe lexonte me zë të lartë shumë gjëra nga ato që kishte mësuar vetë. Shkruante ku mundte dhe lexonte sa mundte. Mbrëmanet zakonisht shtrihej në dyshemenë e kasolles dhe lexonte e shkruante në dritën e zjarrit. Edhe në mëngjes bënte, shpesh herë, të njëjtën gjë, dhe nuk tundej gjër sa e thërriste me zemërim i ati që të shkonte të punonte.

Abrahamit i pëlqente vetmia, por nuk ndahej edhe nga shoqëria. Dhe sa herë ndodhej më ndonjë mbledhje të miqve të tij kishte dëshirë të kallëzonte anekdota e historira. Shprehja e tij ishte e lehtë dhe tërheqëse. Ai ishte gjithashtu i urtë dhe i sjellur. Për këto cilësi, ai shquhej ndërmjet shokëve të moshës së tij dhe që të gjithë e rrethonin me simpati.



## LINCOLN

Abrahami kishte një zemër shumë të mirë dhe nuk donte t'i bënte keq askujt. Ndjente dhembshuri edhe për kafshët dhe mizat e dheut. Një ditë, vëllai i tij me tjetër baba, John-i, zuri një breshkë dhe e përplasi disa herë pas tringut të një peme, duke e bërë të vuajë shumë. Atje u ndodh edhe Abrahami, i cili u pikëllua tepër nga kjo pamje dhe filloi të japë disa këshilla, me gjithë se nuk ishte më i madh se 15 vjeç. Abrahami tha se nuk është mirë të përdoren keq as edhe kafshët. Tha gjithashtu se “edhe kafshët kanë shpirt dhe jeta për ‘to është aq e ëmbël sa ç’është edhe për njerëzit”. Këtë episod e kallëzoi më vonë motra e John-it, Matilda.

Në moshën 16 vjeçare Abrahami njihej mirë për fuqinë e tij të madhe. Asikohe ai punonte në dyqanin e një kallajxhiu në Gentryville. Punonte gjithashtu duke prerë dru në pyll dhe duke bërë punëra të vogla në bujqit fqinj. Dhe pasi ishte shakaxhi dhe i lezeçëm në kallëzimin e anekdotave dhe historive, dhe pasi e bënte çdo punë mirë, çdo familje në Pigeon Creek - numri i të cilavet arrinte në disa dhjetëra - ishte e gëzuar kur shkonte Abrahami për të kryer ndonjë punë të vogël. Në moshën 17 vjeç ai e përdorte sopatën me një lehtësi të madhe, duke prerë dru në pyll. Gjithashtu ai, me një grusht, mund të rrëzonte përdhe çdo njeri. Në moshën

## XHEVAT KALLAJXHI

18-vjeçare Abraham-i ishte djaloshi më i gjatë dhe më i fortë në pyll. Ishte i hollë, me shpatulla të gjera, me këmbë të mëdha, me duar të mëdha dhe me një fytyrë jo të pashme dhe melankolike. Dhe pasi ishte shumë i gjatë, një ditë një nga shokët e tij i bëri me tallje këtë pyetje:

- Sa të gjata duhet të jenë këmbët e njeriut?

- Aq të gjata sa të arrijnë gjer në tokë, - u përgjegg Abrahami.

\*

\* \*

Më 2 gusht 1826 një rreze gëzimi hyri në kasollen e familjes së Thomas Lincoln-it. Atë ditë u martua motra e Abrahamit, Sarah, me Aaron Grigsby-n. Me gjithë se me këtë martesë u nda nga rrethi i Abrahamit motra e tij Sarah - e cila kishte zëvendësuar deri-diku dashurinë e mëmës Nancy - përsëri ai u gëzua që ajo gjeti fatin e saj. Por, mjerisht, pas disa kohësh, një zi *e re e mbuloi* kasollen e Thomas Lincoln-it. Më *20 janar 1828 Sarah* vdiq nga lindja në moshën *21-vjeçare*. Kjo vdekje i pikëlloi që të gjithë, veçanërisht Abrahamin.

Pas kësaj ngjarje tepër të trishtuarshme, Abrahami shkoi në Anderson Crekk dhe ndërtoi një barkë për të çuar udhëtarë dhe mallra nga të dy anët e lumit Ohio. Në atë vend ishte një pikë trafiku me rëndësi midis Veriut dhe Jugut. Gjatë

## LINCOLN

kohës që punoi atje, Abrahami pa të kalojnë tregtarë lëkurësh të shtazëve të egra, tregtarë skllëvërish, avokatë, lojtarë cirkuish etj. Pa njerëz që për të holla ishin gati të bënin çdo gjë të keqe. Pa gjithashtu edhe njerëz që mbanin në duart e tyre flakën e besimit e të lirisë për të ndriçuar rrugën e historisë.

Në vjeshtën e vitit 1828, kur ishte në moshën 18-vjeçare Abrahami hyri në shërbim të James Gentry me 8 dollarë në muaj për të çuar një barkë të madhe, të ngarkuar me prodhime bujqësore, në qytetin New Orleans, duke lundruar nëpërmjet lumit Ohio dhe lumit Mississippi, që quhet “Ati i Ujra vet”. Ky udhëtim, i cili u krye me mundime dhe rreziqe ishte një eksperiencë e madhe për Abrahamin. Gjatë këtij udhëtimi ai pa shumë gjëra. Pa qytetin më të madh të jugut, të asaj kohe, pa rrugët dhe skelën e bukur të tij; pa vendin ku Andrew Jackson-i - presidenti i 7-të i Shteteve të Bashkuara - fitoi famë si hero i popullit, disa vjet më parë; pa mbi të gjitha, për të parën herë, edhe tregun ku shiteshin zezakët skllëvër!<sup>1</sup>

Abrahami kishte dëgjuar me kohë të flitej rreth

<sup>1</sup> *Qysh në vitin 1619 një anije holandeze zbarkoi në skelën Cheseapeake, në Virginia, një grup prej 20 zezakësh. Ky ishte i pari grup skllëvërish që u soll nga Afrika në Amerikë për t'u përdorur për punë bujqësore. Më vonë u sollën të tjerë zezakë. Numri më i madh i tyre u soll nga viti 1750 gjer në vitin 1880. Më 1808 Qeveria Federale Amerikane e ndaloi me ligj sjelljen e zezakëve afrikanë si skllëvër në Shtetet e Bashkuara.*

## XHEVAT KALLAJXHI

skllevërve, por nuk kishte parë me sytë e tij që burra e gra, si edhe fëmijë - të rrëmbyer me zor nga gjiri i mëmave të tyre - të shiteshin në ankand, sikur të ishin kafshë! Kjo pamje e tmërroi dhe la vragë të thella në shpirtin e tij. Dhe në këtë rast që ai tha se nuk do të pranonte kurrë të ishte një skllav dhe aq më pak një zot skllevërish. Tha gjithashtu se, po t'i jepej rasti, do ta luftonte skllavërinë me të gjitha fuqitë e tij.

Pas disa ditësh, si e ngarkoi barkën me sheqer, pambuk dhe duhan, Abraham-i mori rrugën e kthimit së bashku me njerëzit që kishte nën drejtimin e tij. Gjatë udhëtimit mendimi i tij drejtohej shpesh herë nga pamja e tmerrshme e tregut të skllevërve. Dhe një psherëtimë e thellë i dilte nga fundi i shpirtit për këto qenie njerëzore që shfrytëzoheshin pa mëshirë!

Kur u kthye në vendin e tij, ai u përvesh përsëri punës duke përdorur herë sëpatën, herë kazmën, herë parmendën. “Duket se kam lindur vetëm për të punuar rëndë”, i tha një herë një shokut të tij. Dhe pushoi kështu një kohë të gjatë, për gjer sa Thomas-i vendosi të shpërngulej përsëri familjarisht në një vend tjetër. Dikush i kishte lavdëruar viset e bukura të Shtetit Illinois. Prandaj Thomas-i vendosi të shkojë atje.

Kështu, në fillim të marsit të vitit 1830, familja

## LINCOLN

e Thomas-it u nis me dy qerre të tërhequra nga buaj për në vendin Decatur, në të cilin arriti pas një udhëtimi që zgjati dy javë. Atje Thomas-i, i ndihmuar nga Abraham-i, ndërtoi një kasolle tjetër nja 13 kilometra në jugë-perëndim të Decatur-it, afër lumit Sangamon. Nga ky vend, familja e Thomasit, - pasi kaloi një dimër të rreptë dhe me dëborë të madhe midis vitit 1830-1831 - u nis për në vendin Coles County, të Shtetit Illinois.

Në Coles County, që ishte ndalesa e fundit, familja e Thomas-it ndërtoi një kasolle të re dhe çeli një tokë për të mbjellë misër, patate, fasule dhe të tjera prodhime bujqësore. Në këto punime Abrahami dha ndihmën e tij më të madhe. Ndërkohë ai, së bashku me kushërirën e tij Dennis Hanks, preu nja 3000 traversa të holla e të trasha për t'i shitur. Traversat e holla përdorshin për të rrethuar oborret e banesave dhe ato të trasha për t'u shtruar nën binarët e hekurt të rrugës së trenit. Abrahami ndihmoi gjithashtu edhe për ndërtimin e një barke në fshatin Sangamo-n, nja 12 kilometra në veriperëndim të Springfield-it.

Pas disa kohësh, në verën e vitit 1831, Abrahami bëri udhëtimin e dytë për në New Orleans, duke çuar atje një sasi prodhimesh bujqësore të ndryshme të tregtarit Denton Offut. Dhe kur u kthye nga udhëtimi që bëri në New

## XHEVAT KALLAJXHI

Orleans, ai vendosi të ndahet nga gjiri i familjes së tij, për të gjetur vendin e vet në këtë botë. Kështu, me disa plaçka të paka në krahë dhe me disa të holla të pakta në xhep, Abrahami u nis për në New Salem, në kërkim të një fati të ri.



**Kasollja ku lindi Abraham Lincoln-i**

## LINCOLN

### LINCOLN-I NË RRUGËN E NJË JETE TË RE

Abraham Lincoln-i arriti në New Salem në vjeshtën e vitit 1831. New Salem-i ishte një vend i vogël, i cili u bë banesa e tij për pesë vjet. I varfër e i reckosur, dhe pa ndonjë mjeshtëri të veçantë, Lincoln-i në fillim u ndodh në një gjendje të ngushtë e të vështirë. Prandaj, për të siguruar bukën e gojës, në kohën e parë ai përdori përsëri sopatën dhe bëri çdo punë tjetër krahu. Më vonë miku i tij Denton Offut çeli një dyqan me sende ushqimore dhe e mori Lincoln-in si ndihmës.

Ky vend i vogël, i ngrehur prej pak vjetësh, paraqiste përsëri një farë kënaqësie për djaloshin e pyjeve, i cili, pas një ditë pune të lodhëshme, mund të mblidhej me miq e me shokë dhe të bisedonte e të përrallonte me ta. Lincoln-i ishte një njeri pa vese: nuk pinte pije alkoolike, nuk lozte me kartra dhe nuk tymoste duhan. Por pasi ishte një njeri i lezeçëm në bisedime dhe kallëzonte me plot kripë anekdota e historira të ndryshme, pjesëmarrja e tij në mbledhje me miq e me shokë pritej gjithnjë me gëzim.

Në New Salem kishte edhe njëfarë klubi

## XHEVAT KALLAJXHI

sportiv të rinisë, i cili quhej “Clary’s Grove Boys”. Pjesëtarët e këtij klubi merreshin përgjithësisht me boks dhe me mundje greko-romane. Kryetari i këtij klubi ishte një i quajtur Jack Armstrong, i cili konsiderohej si djaloshi më i fortë në krejt atë rreth. Ky i bëri sfidë Lincoln-it që të matesh me ‘të. Në fillim Lincoln-i u mendua pak, por më në fund pranoi dhe fitoi. Kjo fitore ngriti menjëherë prestigjin e tij dhe bëri që ai të fitonte simpatinë e banorëve të New Salemit dhe të rrethit. Lincoln-i fitoi edhe nderimin e anëtarëve të klubit dhe u bë mik i ngushtë me ta.

Pas kësaj ndeshje, plasi një luftë e vogël kundër një çete të madhe indianësh, të kryesuar nga Black Hawk. Kjo çetë po prishte qetësinë në disa vende të shtetit Illinois, duke vrarë e duke grabitur. Dhe kur guvernatori i shtetit Illinois bëri thirrje për vullnetarë më 1832, për të ndihmuar në shtypjen e kësaj çete, të përbërë nga 500 veta, Lincoln-i u regjistrua menjëherë për një kohë të caktuar. Ndërkaq u regjistruan edhe të gjithë anëtarët e klubit “Clary’s Grove Boys”, të cilët e zgjodhën Lincoln-in si kapitenin e tyre. Kjo fushatë vazhdoi dy muaj dhe gjatë kësaj kohe çeta nuk u pa gjëkund, kështu që nuk u shkrep asnjë pushkë.

Kur vullnetarët e komanduar nga Lincoln-i ndodheshin në pushim afër Ottawa-s, në Illinois, një plak indian shkoi si mik pranë tyre, dhe ata



## LINCOLN

pa menduar shumë, vendosën ta vritnin për hakmarrje. Por ndërhyri menjëherë Lincoln-i dhe mundi ta shpëtojë plakun e gjorë. Me këtë gjest Lincoln-i i zemëroi fort vullnetarët dhe mend rrezikoi jetën e vet.

Si mori fund kjo ndërmarrje kundër çetës indiane, Lincoln-i, me gradën e kapitenit, por pa asnjë qindarkë në xhep, u kthye në New Salem ku, gjatë kohës që mungonte, dyqani i Denton Offut-it kishte falimentuar. Me falimentimin e këtij dyqani kishte marrë fund edhe puna e Lincoln-it.

Kur u kthye në New Salem, Lincoln-i u gjet përballë fushatës së zgjedhjeve për anëtarë të legjislaturës së Shtetit. Me këtë rast miqtë e tij e bindën që të shtronte kandidaturën në listën e partisë liberale që quhej "Whig". Lincoln-i pranoi dhe, me ndihmën e mësuesit Graham, përgatiti, me të shkruar, të parën deklaratë të tij për zgjedhje. Me këtë deklaratë, e cila u shtyp dhe u shpërnda, Lincoln-i zotohesh se, po të zgjidhesh, do të përpiqesh për përmirësimin e rrugëve dhe të mjeteve të lundrimit në lumin Sangamon. Dhe e përfundonte deklaratën me këto fjalë:

"Thuhet se çdo njeri ka ambiciet e tij të veçanta. Ambicia ime më i madh është të fitoj besimin e të tjerëve, duke dhënë unë vetë prova se e meritoj besimin dhe nderimin e tyre... Unë jam i ri dhe i panjohur për shumë nga ju. Unë u linda dhe u

## XHEVAT KALLAJXHI

rrita në një gjendje shumë të varfër. Unë nuk jam i pasur dhe nuk kam miq dhe lidhje me qarqe me influencë që të më rekomandojnë. Shpresa ime qëndron krejtësisht në dorën e votuesve të pavarur të këtij rrethi... Në qoftë se do të zgjidhem, do të përpiqem ta kryej detyrën time me zell dhe ndershmëri... Por edhe në qoftë se populli nuk do ta shohë të arsyeshme që të më zgjedhë, përsëri unë nuk do të hidhërohem, pasi jam mësuar me humbje...”

Lincoln-i humbi në këto zgjedhje, me gjithë se pothuajse çdo njeri në rrethin e New Salemit votoi për të. Lincoln-i nuk u shkurajua nga kjo humbje. Vazhdoi në rrugën e jetës së tij me vullnetin dhe durimin që e karakterizonin. Së bashku me William Berry-n çeli një dyqan të vogël me sende ushqimore dhe iu shtrua me gjithë fuqi studimit të librave të ndryshme, sidomos të librave mbi drejtësinë. Këto libra i a jepte hua Stout Bowling, gjykatësi paqtues, i cili njëkohësisht i jepte shpjegime për pika të ndryshme mbi drejtësinë.

Mirëpo puna në dyqan nuk vente mbarë. Lincoln-i në vend të kujdesej për dyqanin dhe të përpiqej të kënaqte myshteritë, e kalonte tërë ditën i shtrirë, duke lexuar libra. Ortaku i tij, Berry, ishte gjithnjë i dehur: rakinë, që duhej t'u a shiste myshterive, e pinte vetë. Kështu dyqani falimentoi më në fund dhe kur Berry vdiq një vit

## LINCOLN

më vonë, Lincoln-i mori përsipër të paguante të gjitha borxhe të mbetura.

Lincoln-i mbeti prapë pa punë. Jetesa e tij u vështirësua përsëri. Por në Maj të vitit 1833 u emërua si nëpunës i postës në New Salem. Këtë detyrë e mbajti gjer në maj të vitit 1836, kur zyra e shpërngul në Petersburg. Me këtë punë siguroi deri-diku jetesën dhe pati rast të lexonte të gjitha gazetat që arrinin në New Salem. Leximi i gazetave e ndihmoi mjaft për të zgjeruar njohurinë dhe për t'u vënë në dijeni të ngjarjeve të brendshme e të jashtme. Por Lincoln-i e vazhdoi njëkohësisht edhe studimin e librave të ndryshme. Ndër të tjera, ai lexoi komentet e Blackstone-it mbi Kushtetutën Amerikane dhe një pjesë të veprave të Shakespeare-it.

Lincoln-i krijoi një rreth miqsh të mirë në New Salem, me të cilët mblidhesh shpesh herë dhe bisedonte rreth problemeve të ndryshme. Ndërkohë ai kishte lexuar edhe fjalimet politike të Henry Clay-t dhe të Daniel Webster-it, avokatit të New Hampshire-it, për të cilin thuhej se “kishte futur djallin në thes!”. Me këto lexime të ndryshme e të shumta, Lincoln-i kishte fituar disa njohuri të përgjithshme në fushën e problemeve politike, shoqërore, juridike dhe shkencore. Ai kishte lexuar gjithashtu edhe mjaft vepra historie dhe filozofie. Prandaj, në bisedimet që zhvillonte

## XHEVAT KALLAJXHI

me miqtë e tij, Lincoln-i dëgjohej kurdoherë me kujdes. Jo vetëm dëgjohej, por edhe nderohej. Nderohej veçanërisht për mendimet e tij liberale.

Ai dhe miqtë e tij mbledheshin zakonisht në pijetoren e James Rutledge-it. Atje shkonin pothuajse çdo të shtunë mbrëma. Lincoln-i merrte pjesë me gjithë dëshirë në këto mbledhje, jo vetëm se i pëlqente të bisedonte me shokët dhe miqtë, por edhe sepse kishte filluar të ndjente një simpati të madhe për të bijën e James Rutledge-it të quajtur Anna. Kjo ishte një vajzë 19 vjeçare, me shtat të rregull, me trup të derdhur, me fytyrë engjëjllore, me sy të kaltërt dhe me flokë të verdha e të përdredhura, të cilat i ndritnin mbi ballë si një kurorë floriri.

Për fat të keq, Anna ishte e fejuar me një djalë nga New York-u, të quajtur John McNeil, i cili kishte një tregti në New Salem. Prandaj Lincoln-i e dashuroi atë në heshtje. Por një ditë i fejuari i Annës u nis për në New York, duke i premtuar se do të kthehej shpejt dhe do ta merrte për grua. Në fillim shkroi disa herë dhe më vonë nuk u dëgjua më. Kjo heshtje e dëshpëroi fort Annën, e cila, më në fund, i shkroi një letër dhe i tha që ta quante fejesën të prishur. MbNeil-i nuk u përgjegj dhe kështu lidhja midis tij dhe Annës mori fund.

Lincoln-i e shihte shpesh herë Annën jo vetëm në pijetoren e të atit, por edhe në shtëpinë e saj

## LINCOLN

kur shkonte të shpërndante postën në zona të ndryshme. Dhe sa herë takonte të kalonte nga shtëpia e Annës, ndalej dhe bisedonte me të. Ai e dinte që fejesa e saj me djaloshin McNeil ishte prishur, por ishte i turpshëm dhe nuk guxonte t'i shfaqte dashurinë që i përvëlonte shpirtin. Por Lincoln-i druhej të shfaqte ndjenjat e tij edhe për një arsye tjetër: ishte i varfër dhe nuk kishte mundësi të martohej e të krijonte familje.

Por duket se edhe Anna, që tani ishte e lirë, ndjente në brendësinë e shpirtit të saj një simpati për Lincoln-in. Sa herë që ky bisedonte me miqtë më pijetoren e atit të saj, dhe sa herë që tregonte anekdota e historira, Anna dëgjonte që nga larg me vëmendje të veçantë. Ajo e dinte që Lincoln-i ishte i varfër dhe i mbushur me borxhe, por përsëri kishte besim në të ardhmen e tij. Çmonte karakterin dhe vullnetin e fortë, si edhe cilësitë e ralla të këtij djaloshi pionier, i cili - ndonëse i lindur dhe i rritur në pyje - kishte mundur të studionte vetë.

Dëshira më e madhe e Lincolit ishte të mësonte gjithnjë gjëra të reja. Pikërisht në atë kohë ai i ishte vënë studimit të gjeometrisë e të matematikës, për t'u bërë gjeometër. Me ndihmën e miqve të tij, Mentor Graham dhe John Calhoun, ai mundi të mësojë bazat e gjeometrisë. Si i mbaroi këto studime, bleu - me kredi - një kalë, një kompas dhe disa vegla të tjera të nevojshme, dhe nga fillimi

## XHEVAT KALLAJXHI

i vitit 1833 u bë ndihmës gjeometër. Asikohe hapeshin rrugë të reja, ngriheshin qytete të vogla, mateshin toka, etj., dhe, pra, kishte mjaft punë për gjeometra dhe ndihmës gjeometra. Matjet e para, si ndihmës gjeometër, Lincoln-i bëri në një tokë të gjerë në Sanagramon County. Më vonë ai bëri planin rregullues të qytetit të vogël New Boston, afër lumit Mississippi, si edhe të qyteteve të tjera të vogla Petersburg, Huron, Albany dhe Bath. Edhe punën e gjeometrit e kreu me zotësi dhe e vazhdoi gjer nga mbarimi i vitit 1836.

Ndërkaq, në zgjedhjet që u bënë në verën e vitit 1834, Lincoln-i u zgjodh një nga të katër anëtarët e Sanagramon County për në dhomën e ulët të Asamblesë së Përgjithshme të Shtetit të Illinois, kryeqyteti i të cilit atëherë ishte në Vandalia. Lincoln-i u rizgjodh edhe tri herë të tjera për në këtë dhomë: më 1836, më 1838, dhe më 1840. me zgjedhjen si deputet, gjendja ekonomike e Lincoln-it filloi të përmirësohesh pak. Dhe ishte pikërisht në atë rast që Lincoln-i arriti të veshë një palë rroba të reja, për të parën herë në jetën e tij.

Tani Lincoln-it i u shtuan edhe shpresat për t'u martuar me Annën, nga e cila nuk e largonte kurrë mendimin e tij. Prandaj mori guxim dhe, në një mënyrë fisnike, i shfaqti ndjenjat e dashurisë si edhe dëshirën për t'u martuar me të. Ky propozim i Lincoln-it u kundërkëmbye me të njëjtat ndjenja

## LINCOLN

edhe nga ana e Annës, e cila i tha se “e priste me padurim një çast të tillë”. Pas shprehjes së këtyre ndjenjave, ata shpallën fejesën e tyre dhe bënë plane që të martoheshin në një rast të volitshëm. Por më parë vendosën që Anna të shkonte të mbaronte shkollën në Jacksonville.

Gjatë kohës që Lincoln-i qëndroi në New Salem, para se të shkonte të zinte vendin e tij në parlamentin e Shtetit Illinois, ai e frekuentoi vazhdimisht shtëpinë e Annës. Ishte i gëzuar dhe fytyra e tij melankolike buzëqeshte gjithnjë. Qëndronte afër saj orë të tëra, e ndihmonte në punët e shtëpisë, bisedonte mbi gjëra të ndryshme dhe priste me padurim orën e lumtur që të ngrehte çerdhen e dashurisë familjare.

Kur afroi koha, Lincoln-i u nis për në Vandalia, për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, në të cilën u paraqit në fillim të Dhjetorit të vitit 1834. edhe në Vandalia shkoi me pak plaçka, ashtu sikundër pat shkuar në fillim në New Salem. I vetmi ndryshim këtë radhë ishte ky: në New Salem kishte shkuar më këmbë, ndërsa në Vandalia shkoi kaluar.

Por, për fat të keq, në verën e vitit 1835 një epidemi e tifos u përhap në New Salem dhe në vendet rreth e rrotull, nga e cila nuk shpëtoi dot as edhe e gjora Annë. Vuri kryet mbi jastëk dhe nuk e ngriti më... Dhe në ditët e fundit, kur gjendja

## XHEVAT KALLAJXHI

shëndetësore e Annës u keqësua shumë, u lajmërua me të shpejt Lincoln-i, i cili u kthye menjëherë në New Salem.

Lincoln-i qëndroi pothuajse vazhdimisht pranë shtratit të Annës, në dhomën e kësaj vajze të re që luftonte, me të gjitha fuqitë e saj, kundër vdekjes. Mjerisht, lufta e kësaj krijese engjëllore, që dëshironte të shijonte jetën, nuk pati sukses. Lincoln-i doli më në fund nga dhoma i pikëlluar dhe me lot në sy: Anna kishte mbyllur sytë për jetë.

Me vdekjen e Annës, për Lincoln-in u nxi çdo gjë. Melankolia e tij u bë më e madhe dhe në buzët e tij u shënuan gjurmët e një hidhërimi të përjetshëm. Ai shkonte çdo ditë në varrin e saj dhe qante me ngashërim. U bë si i çmendur. “Nuk mund të duroj dot”, thoshte me zë të dridhur, “kur e di që ndodhet vetëm nën tokë dhe shiu e breshëri bien mbi varrin e saj”. Dhe kur largohej nga vorrezat, Lincoln-i vente shpesh herë të kalonte disa orë në shtëpinë e Jack Armstrong-ut, djaloshit kolos, i cili ishte bërë një mik i tij i ngushtë. Kjo miqësi kishte lindur qysh atëherë kur Lincoln-i u mat me të, në mundjen greko-romane, disa kohë më vonë pasi u vendos në New Salem. Ai shtrihej përdhe, dhe shpesh herë merrte dhe lëkundte në prehrin e tij Duff-in e vogël - djalin e Armstrong-ut - gjer sa e zinte gjumi.

Lincoln-i qëndronte orë të tëra pa folur dhe të



## LINCOLN

zotët e shtëpisë e linin të qetë. Mendonte vazhdimisht për Annën. Shëndeti i tij keqësohej gjithnjë nga dëshpërimi. Nga ndonjë herë fliste me vete. Prandaj mjeku e këshilloi që të shkonte të kalonte disa kohë në fermën e një miku. Dhe ai shkoi. E kaloi kohën duke bërë shëtitje të gjata, duke u marrë me punëra bujqësore të ndryshme, duke prerë dru. Bënte çdo gjë për të harruar pak hidhërimin e thellë. E lodhte trupin që të mund të flinte natën.

Më në fund, si u bë më mirë, vendosi të largohet nga New Salemi dhe të kthehet përsëri në Vandalia. Dhe para se të nisesesh, vizitoi për herën e fundit varrin e Annës, të cilën nuk e harroi kurrë. Thuhet se gjer në vitet e fundit të jetës së tij ai përsëriste shpesh herë këto vargje të një poeti të panjohur:

*Guri i mermertë përsipër qëndron  
Dhe trupin e vashës e shtyp, e dërmon,  
Që aq fort e desha me dëshir' e zjarr,  
Kur po lulëzonte si lulja në Maj,  
Tash ka kaq vjet që tretet në varr,  
Ç'po qan zëmra ime me lot' e me vaj ...*

Anna ishte dashuria e parë dhe e vërtetë për Lincoln-in. Pas asaj, ai nuk dashuroi më asnjë grua tjetër me atë zjarr të madh me të cilin kishte dashuruar Annën.

## XHEVAT KALLAJXHI



**Punë dhe studim**

## LINCOLN

### DALJA E LINCOLN-IT NË SKENË

Në shtatorin e vitit 1835 Lincoln-i mori leje për ushtrimin e avokaturës në gjyqet e rrethit të Shtetit Illionis. Me këtë rast ai filloi të zhvillojë një veprimtari të gjerë dhe të jetë gjithnjë i zënë me punë. I hipur me kalë ose në karrocë, ai shkonte nga një fshat tek tjetri; kalonte nëpër fusha e brigje me mot të mirë e të keq; udhëtonte nëpër rrugë e shtigje plot baltë; vente në qendra të largëta e të izoluara për të kryer detyrën e tij si avokat. E kalonte kohën duke përgatitur me kujdes paditë që duhej të ndiqte në gjyqet e 14 rretheve të vogla, në pjesën qendrore dhe lindore të Shtetit Illinois.

Më 1837 ai u pranuanë Shoqërinë e Avokatëve të Shtetit Illinois. Me atë rast Lincoln-i shkoi në qytetin Springfield për të ushtruar avokaturën në ortakëri me John Stuart-in. Pas dy vjetësh, me urdhërin e guvernatorit Thomas Carlin, u transferua edhe kryeqyteti i Shtetit Illinois nga Vandalia në Springfield. Atëherë ky qytet kishte nja 1500 banorë, shumica e të cilëve ishin fshatarë, pionierë dhe zanatçinj; njerëz të varfër përgjithësisht. Por në Springfield kishte edhe

## XHEVAT KALLAJXHI

mjaft njerëz të pasur e intelektualë.

Lincoln-i, siç thamë, nuk kishte pasur rast të ndiqte një shkollë të rregullt. Nuk kishte asnjë diplomë. Ishte një autodidakt. Prandaj edhe kultura e tij ishte e kufizuar. Por ai kishte një njohuri të thellë për sa i përkiste ligjit të vendit. Përveç kësaj, me përpjekjet e tija dhe me ndihmën e disa gjyqtarëve dhe kolegëve të vet, si David Davis, Stephen Logan, William Herndon etj., ai mundi të mësojë mjaft mirë edhe ligjet e shtetit.

Ortakëria me John Stuart-in vazhdoi gjer në vitin 1841, kur ky i fundit u zgjodh deputet për në Kongresin e Shteteve të Bashkuara. Kur u largua Stuart-i, Lincoln-i u bë ortak me Stephen Logan, dhe më 1844 u bë ortak me William Herndon, të cilët asikohe ishin nga avokatët më të mirë në Shtetin Illinois.

Me fillimin e ushtrimit të profesionit të avokaturës, Lincoln-i përmbushi një nga ambiciet e tij: hyri në një jetë intelektuale, të cilën e pat ëndërruar qysh prej shumë vjetësh dhe në të cilën u hodh me gjithë entuziazmin e moshës së tij të re. Ai i studionte paditë që do të ndiqte me një vëmendje të veçantë dhe i paraqiste në një mënyrë të qartë. Çdo myshteri, që paraqitej në zyrë, e dëgjonte me kujdes; e këqyrte problemin e tij me vëmendje të veçantë dhe më në fund i

## LINCOLN

thoshte haptazi, si të ishte rasti: “padia juaj është e drejtë” ose “padia juaj është e padrejtë”.

Lincoln-i nuk merrte zakonisht kurrë përsi për mbrojtjen e një padie që e gjykonte si të padrejtë. Ai u dha një herë studentëve të degës së drejtësisë këtë këshillë: “Vendosni të jeni të ndershëm përpara të gjitha çështjeve. Në qoftë se mendoni se nuk mund të bëheni avokatë të ndershëm, atëherë vendosni të jeni të ndershëm pa qenë avokatë”. Dhe në lidhje me ligjet, ai tha një herë edhe këto: “Ligjet, qofshin edhe ato që janë të këqija, duhet të respektohen për gjer sa qëndrojnë në fuqi”.

Argumentat e Lincoln-it ishin të forta, të thjeshta dhe bindëse. Pretendimet e tij, për shpërblime avokatore, ishin modeste. Ai nuk kërkonte kurrë të paguhej më tepër se sa vllente shërbimi i tij, sipas gjykimit të tij. Një herë, një myshteriu të tij, të quajtur George P. Floyd, i dërgoi këtë letër:

“I dashuri Zotëri: Mora letrën tuaj të datës 16 (shkurt) së bashku me çekun e lëshuar nga Flagg-Savage për 25 dollarë. Ju duket se mendoni që unë pretendoj të paguhem shumë. Ju jeni tepër dorëhapët me të hollat tuaja. 15 dollarë janë mjaft për punën që ju bëra. Po ju dërgoj një dëftesë për 15 dollarë dhe ju kthej mbrapsht 10 dollarë. Juaji me besë: A. LINCOLN”.

## XHEVAT KALLAJXHI

Lincoln-i ishte njeri i thjeshtë. Edhe veshja e tij ishte e thjeshtë. Bile, më tepër se e thjeshtë, mund të themi se ishte e çuditshme. Ai mbante në kokë një kapelë të lartë, vishte një redingot të gjatë e me mëngë shumë të shkurtra, sillte gjithnjë me vete një ombrellë me ngjyrë të blertë të lidhur me spango në qafë, që të mos hapej. Nuk dukej aspak mirë. Me gjithë këtë, ishte tërheqës. Ai njihte mirë shpirtin njerëzor; ai dinte se si të fitonte zemrën dhe mendimin e atyre që e dëgjonin.

Të folurit e Lincoln-it ishte prekës. Me fjalët e tij, ai qëllonte ku duhej. Shpesh herë ato i shoqëronte edhe me ndonjë shaka ose me kallëzimin e ndonjë anekdote. Të njëjtat mënyra përdorte edhe kur mbronte ndonjë padie përpara gjyqit. Nga ndonjë herë nuk mungonte t'i hidhte edhe ndonjë thumb avokatit kundërshtar. Një herë vuri re se avokati i palës tjetër e kishte veshur këmishën gabimisht, nga ana e mbrapme. Lincoln-i e la të mbaronte së foluri. Pastaj, kur i erdhi radha, u ngrit dhe u drejtoi gjyqtarëve këto fjalë: “Çfarë besim mund të keni ju në argumentet e një njeriu që nuk di të veshë as këmishën për së mbari?”. Me këto shakara i bënte të qeshnin jo vetëm njerëzit që ndodheshin në sallën e gjyqit, por edhe gjyqtarët, dhe kundërshtari e humbiste për një çast.

## LINCOLN

Edhe në fushën e avokatisë Lincoln-i fitoi një emër. U bë, me kohë, një nga avokatët më të shquar në Shtetin Illinois. Ai mbahet mend veçanërisht me gjyqin që fitoi për shpëtimin nga dënimi të djaloshit Duff Armstrong, të birin e mikut të djalërisë Jack Armstrong. Kishte kaluar një kohë e gjatë që Lincoln-i ishte larguar nga New Salemi dhe nuk kishte pasur kurrë lajme nga familja Armstrong, për të cilën ruante kujtime të mira. Por një lajm që lexoi në gazetë i solli ndërmend të gjithë të kaluarën: e çoi gjer në vdekjen e Annës dhe gjer në orët e gjata që kalonte i shtrirë në shtëpinë e Armstrongut, duke mbajtur e lëkundur në prehër djalin e vogël Duff, gjer sa e zinte gjumi.

Kjo gazetë shkruante se Duff Armstrongu ishte arrestuar nën akuzën se kishte vrarë natën me një shkop një djalë, në vazhdim të një përleshjeje që kishte ndodhur pas një mbledhjeje që ishte mbajtur në një vend jashtë fshatit. Dhe akuzën më të rëndë kundër Duff-it e kishte bërë një mik i tij, i cili pati deklaruar në hetuesi, në një mënyrë kategorike, se e kishte parë me sytë e tij zhvillimin e këtij krimi.

Kjo vrasje kishte zemëruar të gjithë fshatarët dhe, sikur të mos ishte arrestuar me kohë, Duff-i do të mund të bëhej copa-copa nga ata. Duff-i njihej si një djalë kapadai dhe dihej se kishte

## XHEVAT KALLAJXHI

marrë pjesë disa herë në grindje të vogla. Për këtë arsye, askujt në fshat nuk i dukesh e pamundur që Duff-i të kishte lyer duart me gjak! Por Lincoln-it nuk iu mbush mendja. Nuk besonte që Duff-i të ishte bërë një kriminel. Prandaj i shkroi një letër të shoqes së Armstrong-ut dhe u ofrua ta mbronte djalin e saj pa të holla.

Lincoln-i i studioi materialet e gjyqit me kujdes dhe, mbi të gjitha, kërkoi që gjyqi të zhvillohej në një vend tjetër, që kështu anëtarët e jurisë të mos influencoheshin nga fjalët që fliteshin kundër Duff-it. Kërkesa e tij u mor parasysh.

Ditën që u çel gjyqi, të gjithë pyetnin vet-veten se në çfarë argumenta do ta bazonte avokati Lincoln mbrojtjen e të pandehurit, kur të gjitha provat e ngarkonin me faj. Duff-i, i dëshpëruar dhe i verdhur nga fytyra, u ngrit në këmbë dhe përsëriti fjalët që kishte thënë qysh në fillim: "Jam i pafajshëm". E ndjente veten krejt të humbur, ndërsa nëna e tij qante me ngadalë në një kënd të sallës së gjyqit, e prekur thellësisht nga hidhërimi dhe turpi. Burri i kishte vdekur. Çdo t'i mbetej tani në botë, në qoftë se humbiste edhe djalin, që ishte e vetmja shpresë për të? Lincoln-i i u afrua dhe i tha në vesh: "Mos qani... Kam shpresë se para perëndimit të diellit djali juaj do të lihet i lirë!"



## LINCOLN

Nga ana tjetër e të akuzuarit qëndronte dëshmitari kryesor, Charles Allen, i cili gëzonte simpatinë e përgjithshme. Konsiderohesh nga rrethi i tij si një djalë i drejtë dhe me cilësira. Me gjithë këtë, nga fjalët që thoshte dhe nga mënyra me të cilën i thoshte, Lincoln-i zbuloi se nuk ishte i sinqertë. Dëshmuesi betohej se e pa me sytë e tij mikun. Armstrong që u përfyt me viktimën dhe e goditi me një shkop në kokë për gjer sa e la të vdekur përdhe.

Pas këtyre deklaratave të dëshmitarit, u ngrit Lincoln-i dhe i bëri këto pyetje:

- A e patë me të vërtetë me sytë tuaj këtë përfytje?

- Po e pashë.

- Ku ishit ju kur ndodhi kjo përfytje?

- Nja 50 metra larg.

- Kur ndodhi kjo përfytje?

- Në ora 11 të natës.

- Si mundët t'a shihnit ngjarjen në atë orë nga një largësi e tillë?

- Nga hëna që ndriste si ditë.

- Ishte e plotë hëna atë natë?

- Po, ishte e plotë. Ndriste sikur të ishte ditë.

Për këtë gjë jam krejt i sigurt.

Në atë çast, ndërsa filloi pyetja e dëshmitarëve të tjerë, Lincoln-i i kërkoi Sheriff-it të sillte një kalendar që tregonte fazat e hënës gjatë atij

## XHEVAT KALLAJXHI

viti. Hapi një faqe dhe i tha Allen-it: "Lexoje!" Fytyra e dëshmitarit u zverdh. Ai lexoi që natën e ngjarjes nuk kishte hënë. Përkundrazi ishte aq errët, sa ishte e pamundur të shihej qartë edhe në një distancë prej 7 metrash.

Ky fakt me rëndësi e ndryshoi krejt çështjen. Lincoln-i tha se shkopi nuk i përkiste Duff-it, por dikujt tjetër. Doli në shesh se krejt dëshmia ishte një kurdisje për të shuar jetën e djaloshtit Duff. Juria u hoq në një dhomë të veçantë të gjyqit për të biseduar dhe për të dhënë vendimin e saj. Kur u kthye përsëri në sallë, kryetari i jurisë deklaroi këto fjalë: "I akuzuari është i pafajshëm!"

Në atë rast e veja e Jack Armstrong-ut ra në krahët e të birit të saj, i cili i tha: "Nënë, tani mund të më shohësh si më parë, të lirë e të pafajshëm". Pastaj pyeti: "Ku është Zoti Lincoln?" dhe, duke ecur në mes të sallës, u gjunjëzua përpara shpëtimtarit të tij dhe i puthi dorën, pa mundur të thoshte asnjë fjalë nga mallëngjimi. Ngashërimi nuk e la të shprehte me gojë ato që i ndjente zemra.

Tani gjithë urrejtja e publikut - që qëndronte në një heshtje të madhe - u kthye në simpati për Duff-in, i cili për pak humbi jetën nga një akuzë e padrejtë. Dhe juria zbuloi se krimin e kishte kryer një person tjetër, një i quajtur

## LINCOLN

James Morris.

Lincoln-i ktheu kryet nga dritarja dhe pa që dielli ndriste akoma. I u afrua nënës së Duff-it dhe i tha këto fjalë: “Dielli nuk ka perënduar akoma dhe djali juaj është i lirë”.

Me këtë skenë mallëngjyese përfundoi, me sukses, një proces me rëndësi gjatë karrierës së ndritur avokatore të Lincoln-it, i cili në atë rast mbrojti jo vetëm një çështje të drejtë, por edhe shleu një detyrim mirënjohjeje përkundrejt familjes së mikut të tij të djalërisë, Jack Armstrong-ut.

XHEVAT KALLAJXHI



Mary Todd, e shoqja e Lincoln-it

## LINCOLN

### MARTESA E LINCOLN-IT

Lincoln-i, si avokat dhe si deputet, kishte pasur rast të vizitonte shumë rrethe të Shtetit Illinois dhe të njihesh me një numër të madh njerëzish të çdo shkalle shoqërore. Ai bisedonte me të gjithë: me qytetarë, me fshatarë, me tregtarë, me bujq, me zejtarë, me barinj. Bisedonte jo vetëm për çështje gjyqësore, por edhe probleme të ndryshme që u përkisnin individëve ose komuniteteve. Ai ishte në kontakt të vazhduar me zgjedhësit e tij. Gjithashtu, për shumë veta, ishte bërë një këshilltar atëror. Jepte sa mundte përkrahjen e tij për të shëruar plagët e njerëzve fatkeqë. Emri i Lincoln-it ishte bërë familjar në shumë anë. Pothuaj që të gjithë kishin besim në drejtësinë dhe karakterin e tij. Dhe që të gjithë e thërrisnin “Honest Abe”.

Ndërkohë, me studimin e pareshtur të ligjeve dhe me ndjekjen e padive të ndryshme e të shumta, Lincoln-i e shtonte gjithnjë më tepër eksperiencën e tij në fushën e drejtësisë. Por edhe si anëtar në Asamblenë e Përgjithshme të Shtetit Illinois, ai fitonte vazhdimisht një eksperiencë edhe në fushën politike e parlamentare. Pas

## XHEVAT KALLAJXHI

vitit 1840 Lincoln-i shërbeu edhe si udhëheqës i grupit të Partisë Whig në këtë Asamble<sup>1</sup>. Por, me gjithë këtë, nuk kishte vënë akoma në dukje cilësitë e mëdha që fshiheshin tek ai. Prandaj, kur ishte në moshën 30-vjeçare, ai i shkroi një miku këto fjalë:

“Unë nuk kam bërë akoma asgjë me rëndësi që të kujtohem se jetova në këtë botë. Me gjithë këtë, unë dëshiroj të jetoj që ta lidh emrin me ngjarjet e ditëve të mija dhe të brezit tim; që ta lidh emrin me diçka që t’u interesojë bashkatdhetarëve të mi”.

Por edhe pse Lincoln-i nuk kishte vënë akoma në dukje cilësitë e tij të jashtëzakonshme, përsëri ai gëzonte një respekt të veçantë në rrethet intelektuale të kryeqytetit Springfield. Për logjikën e tij të fortë, për gjuhën e tij të mprehtë, për parimet e tij të qarta e të vendosura, ai kishte fituar një emër në krejt Shtetin Illinois.

Pikërisht në atë kohë, në vitin 1839, arriti në Springfield një vajzë e re, e quajtur Mary Todd. Kjo rridhte nga një familje fisnike e Jugut, e cila i kishte dhënë vendit njerëz të shquar, si gjeneralë dhe guvernatorë. I ati i saj ishte një bankier i

---

<sup>1</sup> Në vitin 1842 Lincoln-i mbushi katër periudha dy-vjeçare si deputet. Në zgjedhjet e reja që u-bënë atë vit ai refuzoi të merrte pjesë. Pas asaj periudhe i u-kushtua krejt profesionit të tij si avokat dhe veprimtarive të Partisë Whig, së cilës i solli shërbime me rëndësi.

## LINCOLN

pasur dhe kishte toka të gjera në Lexington, të cilat punoheshin nga skllevër zezakë. Mary erdhi mysafire në shtëpinë e motrës së saj, martuar me Ninian Edwards.

Mary ishte edukuar në një kolegë që frekuentohej nga vajza të familjeve fisnike e të pasura. Ky kolegë drejtohej nga një çift aristokratësh francezë, të cilët ishin larguar nga vendi i tyre në kohën e revolucionit. Në këtë kolegë Mary kishte mësuar, ndër të tjera, mënyrat e sjelljes së mirë, artin e të biseduarit, vallet e kohës, etj. Prandaj arritja e saj në Springfield u prit me kënaqësi të thellë nga të rinjtë beqarë intelektualë.

Mary ishte një vajzë e pashme, e zgjuar dhe elegante, por edhe ambicioze e madhe. Në një mbledhje, kur dikush i tha: “Këtu në Springfield ka mjaft djem të mirë për t’u martuar”, Mary i u përgjegj menjëherë me këto fjalë: “Unë do të marthem me atë që ka më shumë mundësi të bëhet një ditë president i Shteteve të Bashkuara”. Qeshën që të gjithë; vetëm Mary qëndroi serioze.

Në një pritje që u dha në shtëpinë e kumatit të saj, ajo pati rast të njohë edhe Lincoln-in, për të cilin kishte dëgjuar të flitej shumë në rrethe të ndryshme. Ajo u prek nga trupi gjigand dhe fytyra mistike e Lincoln-it. U prek gjithashtu edhe nga bisedimi që pati me të. Mary u bind që në fillim se kishte të drejtë John Stuart-i

*që i kishte thënë* se “Lincoln-i është një njeri me një zotësi të rrallë”. Pas bisedimeve, ajo e ftoi Lincoln-in që të kërcenin, por atij nuk i pëlqente kërcimi. Bënë një provë, po pa sukses. Atëherë Mary e kuptoi se me Lincoln-in duhesh të bisedohej dhe jo të kërcëhej.

Por edhe Lincoln-it i bëri përshtypje të mirë Mary, jo aq për bukurinë se sa për zgjuarsinë e saj. Ajo bisedonte rreth problemeve politike të kohës me një mënyrë të hollë. Kishte mendime liberale dhe ishte kundër skllavërisë. Për këto cilësi të saj, Lincoln-i filloi të ushqejë për Maryn jo vetëm një simpati, por edhe një farë shprese për martesë. Por Lincoln-i nuk ishte i vetmi. Kishte edhe të tjerë të rinj që e ëndërronin një gjë të tillë, ndër të cilët më i cilësuar ishte djaloshi deputet Stephen Douglas.

Më në fund edhe për Maryn kandidatët më të preferuar mbetën Lincoln-i dhe Douglas. Dhe pasi, siç thamë, ëndërronte të hynte një ditë si zonja e parë e Kombit në Shtëpinë e Bardhë, ajo e hidhte vështrimin e vet herë tek njeri, herë tek tjetri. Për të dy këta djelmosha shpresat dukeshin të mira për një të ardhme të shkëlqyer. Që të dy kishin disa cilësi të veçanta. Por më së fundit, për të mirë a për të keq, shorti ra mbi Lincoln-in. Shpallën fejesën dhe vendosën të martohen më 1 janar të vitit 1841.



## LINCOLN

Por, për fat të keq, ditën e caktuar - “ditën fatale të 1 janarit” - Lincoln-i nuk u paraqit në shtëpinë e kumatit të Mary-t, Ninian Edwards, për të celebruar martesën, me gjithë se çdo gjë ishte gati! Lincoln-i ra papritur i sëmurë në jatak me një ethe të fortë dhe nuk pati rast e kohë të lajmëronte në shtëpinë e nuses për çka i kishte ndodhur. Ai u bë si i çmendur dhe, po të kishte mundësi, nuk do t’i vinte aspak keq t’i jepte fund jetës me dorën e tij. Dhe një mikut i shkroi më vonë këto fjalë: “Tani jam njeriu më i mjerë në këtë jetë. Sikur ajo që ndjej unë të ishte pjesëtuar, në mënyrë të barabartë, në krejt familjen njerëzore, atëherë nuk do të kishte asnjë fytyrë të gëzuar në botë...”.

Mary, kjo vajzë e bukur dhe elegante 23-vjeçare, u prek shumë, por e mbajti lart dinjitetin e saj. I shkroi një letër Lincoln-it me fjalë të matura dhe i njoftoi se e konsideronte fejesën të zgjidhur. Të afërmit e Mary-t u kënaqën nga prishja e fejesës dhe e këshilluan atë me këmbëngulje që të martohej me Stephen Douglas, i cili nuk e kishte hequr akoma mendimin prej saj. “Me gjithë se edhe Douglas-i”, i thoshin ata, “është nga një familje e thjeshtë, ai di të qëndrojë në shoqëri, është elegant, ka sjellje fisnike, ka pasur sukses në politikë, dhe duket se e ardhmja e tij do të jetë e shkëlqyer”.

## XHEVAT KALLAJXHI

Por Mary qëndronte indiferente përpara këtyre fjalëve. Për disa kohë u mbyll në vetvete, por më në fund mori përsëri pjesë, si edhe më parë, në pritje dhe mbledhje të ndryshme. Gjatë atyre mbledhjeve, ajo pati rast ta shohë prapë Lincoln-in dhe u soll me të në një mënyrë miqësore dhe fisnike, sikur nuk kishte ndodhur asgjë! Ndërkohë u mor vesh mirë edhe fatkeqësia që i kishte ndodhur papritur Lincoln-it. Si rrjedhim, rifilluan marrëdhëniet dhe Lincoln-Mary u fejuan përsëri. Duket ishte caktuar nga fati që këta të martoheshin.

Nuk ka dyshim se për Lincoln-in kjo nuk ishte martesë e një dashurie të thellë, si ajo që pat ndjerë për Annën. Ndofta nuk ishte as për Maryn. Por një fjalë e urtë shqipe thotë se “nuk mund të pengohet ajo që është shkrojtur nga Zoti”. Bile Lincoln-i e dinte se Mary ishte një vajzë kapriçioze, nervoze dhe egoiste, gjëra të cilat nuk mund të harmonizoheshin me urtësinë dhe modestinë e tij. Ai dinte gjithashtu se Mary e hiqte rëndë edhe për shkak të familjes së saj fisnike e të pasur. Prandaj një mikut që i bëri një ditë këtë pyetje: “Pse emri Todd shkruhet me dy “d”?, Lincoln-i iu përgjegj, me një buzëqeshje sarkastike, me këto fjalë: “Në qoftë se një “d” është e mjaftë për të shkruar emrin e Perëndisë (God) a nuk mendoni se duhen të paktën dy “d”

## LINCOLN

për të shkruar emrin “Todd?”

Lincoln-i dhe Mary u martuan më 4 nëntor të vitit 1842. Atë ditë Lincoln-i shkoi me të shpejt në shtëpinë e mikut të tij Butler që të vishte një palë rroba të reja. Në atë rast, një nga fëmijët e vegjël të shtëpisë i bëri këtë pyetje:

- Ku po shkoni me kaq nxitim, i veshur me rroba të reja?

- Ndofta në skëterrë! u përgjegy Lincoln-i.

Dhe pas disa ditësh, në një letër që i shkroi një mikut, i tha, ndër të tjera, këto: “Këtu nuk ka asgjë të re, me përjashtim të martesës sime, e cila përbën akoma për mua çudinë më të madhe!”

Disa kohë më vonë pas martesës, në Maj të vitit 1844, Lincoln-i bleu edhe një shtëpi në Springfield, në të cilën u vendos familjarisht. Mary e pajisi dhe e rregulloi shtëpinë me një kujdes të veçantë, në të cilën priste e përcillte, me fisnikërinë që e karakterizonte, miqtë dhe të njohurit e shumtë të Lincoln-it.

Por Mary përpiqesh njëkohësisht edhe që të përmirësonte mënyrat e sjelljes e të veshjes së bashkëshortit. Dëshironte që ai të vishej me gusto dhe të shquhej midis shokëve. Natyrisht ishte e vështirë që të ndryshohej natyra e Lincoln-it, i cili nuk u jepte aspak rëndësi formave të jashtme. Ai vetë tha një herë se

## XHEVAT KALLAJXHI

“veprimi i njeriut mund të ndryshojë deri-diku, por natyra e tij nuk mund të ndryshojë kurrë”.

Këto nxitje të Mary-t shkakttonin shpesh herë grindje, por ajo nuk ndalej në përpjekjet e saja. Bile ajo e shtynte Lincoln-in që të vepronte në një mënyrë më të gjallë edhe në fushën politike. Dëshironte që ambicia e saj të realizohesh me siguri dhe sa më shpejt. Dhe ka disa njerëz që besojnë se këto nxitje të Mary-t ndihmuan mjaft që Lincoln-i të bëhesh president.

Brenda në dhjetë vjet, nga 1843 e gjer më 1853, Lincoln-it i lindën katër djem, të cilët i pagëzoi me këto emra: Robert Todd, Edward Baker, William Wallace dhe Thomas Tad. Nga këta. Edwardi vdiq në Springfield më 1850 në moshën 4-vjeçare. Kjo vdekje e pikëlloi shpirtin e trishtuar të Lincoln-it, i cili ishte jo vetëm një familjar i mirë, por edhe një at i dhemshur.

LINCOLN



Sarah Bush, njerka e Lincoln-it

## ÇËSHTJA E SKLLAVËRISË

Në gusht të vitit 1846 Lincoln-i u zgjodh një nga të shtatë deputetët e Shtetit Illionis për në Kongresin e Shteteve të Bashkuara. Lincoln-i ishte i vetmi person që bënte pjesë në Partinë Whig, ndërsa të gjashtë vetat e tjerë ishin anëtarë të Partisë Demokratë. Ai u transferua në Washington në tetor të vitit 1847 për të filluar nga detyra si deputet. Dhe vendin e tij në kongres e zuri në javën e parë të muajit dhjetor. Një nga veprimet kryesore që bëri Lincoln-i ishte ky: paraqiti në Dhomën e Deputetëve një projekt-ligj për zhdukjen e skllavërisë në kryeqytetin e Amerikës. Projekt-ligji i tij nuk u pranua. Dhe kur mbaroi periudhën dy-vjeçare, Lincoln-i nuk u zgjodh përsëri. U kthye në Springfield dhe ushtroi profesionin si avokat, për disa vjet me radhë. Në mars të vitit 1849 u pranua të ndjekë padije edhe në Gjykatoren e Lartë të Shteteve të Bashkuara. Në atë rast ai u bë një nga avokatët e radhës së parë.

Në kohën e Lincoln-it një nga çështjet kryesore ishte ajo e skllavërisë. Kjo çështje ekzistonte qysh prej shumë vjetësh dhe kishte

## LINCOLN

shkaktuar krijimin e një grindjeje të madhe midis shteteve të veriut dhe atyre të jugut. Shtetet e Veriut kërkonin që skllavëria të zhduej. Shtetet e Jugut ngulnin këmbë që të mbahesh. Në të vërtetë, kjo grindje nuk rridhte vetëm për arsye njerëzore, por edhe ekonomike dhe politike. Skllavërit zezakë përbënin një bazë me rëndësi për punimin e tokave në shtetet e Jugut, ekonomia e të cilëve mbështetej, në pjesë të madhe, në bujqësi, sidomos në prodhimin e pambukut. Pronarët e Jugut i punonin çifligjet e tyre me skllavër, pa asnjë pagesë, ndërsa pronarët e Veriut i vinin në punë fabrikat dhe tokat me punëtorë që u kostonin shtrenjtë. Pastaj pronarët e Jugut, përveç votës së tyre, kishin edhe nga një votë për çdo pesë skllavër.

Ideja për zhdukjen e skllavërisë përkrahej edhe nga shumica e anëtarëve të Partisë Whig. Këta e quanin skllavërinë një gjë të keqe dhe që vinte në kundërshtim me parimet kristiane dhe njerëzore. Me gjithë këtë, për të shmangur keqësimin e grindjes dhe të marrëdhënieve midis Jugut dhe Veriut, qysh prej vitit 1820 ishin bërë disa kompromise në lidhje me çështjen e skllavëve. Mirëpo këto kompromise nuk ishin respektuar vazhdimisht. Interesat e kundërta i kishin lënë pa fuqi, në disa raste.

Por edhe veriorët, që nuk e pëlqenin skllavë-

## XHEVAT KALLAJXHI

rinë përgjithësisht, ndaheshin në dy grupe: një grup kufizohej duke kërkuar që skllavëria të mos përhapej në vende ku nuk kish skllëvër; grupi tjetër ngulte këmbë që të liroheshin të gjithë skllëverit. Një nga pjesëtarët e grupit të dytë, një djalosh nga Bostoni, i quajtur William Lloyd Garrison, botoi edhe një gazetë me titullin “The Liberator”, me anën e së cilës filloi një fushatë të rreptë në favor të skllëvërve. Në një nga numrat e kësaj gazete ai shkroi këto:

“Unë do të luftoj me gjithë fuqi për lirin e menjëhershëm të skllëvërve... Nuk do të kërkoj marrjen e masave mesatare... nuk do të tërhiqem asnjë pëllëmbë... Dhe fjalët e mija do të merren parasysh... Unë do të jem brutal sikundër është e vërteta. Do të jem intrasigjent sikundër është drejtësia... Apatia e skllëvërve duhet të bëjë të lëvizin edhe statujat mbi piedestalet e tyre dhe të ngrerë të vdekurit nga varret...”

Për fatin e keq të Garrison-it - i cili u burgos më në fund - fillimi i kësaj fushate rastisi me vrasjen e 60 të bardhëve nga ana e zezakëve në Virginia. Skllavi që kishte udhëhequr këtë lëvizje. Nat Turner-i, dinte të lexonte dhe faji për influencimin e tij, në kryerjen e kësaj vepre të shëmtuar, iu ngarkua atyre që kërkonin zhdukjen e skllavërisë, veçanërisht gazetës “The Liberator”. Pas këtyre vrasjeve u vunë në fuqi



## LINCOLN

ligje të rënda, të cilat e vështirësuan më tepër gjendjen e zezakëve, si të atyre që ishin skllëvër, si të atyre që ishin të lirë.

Gjuhën e ashpër e përdorur nga Garrison-i e dizaprovuan edhe mjaft nga njerëzit e njohur të Shtetit Massachusetts, me gjithë se e favorizonin zhdukjen e skllavërisë. Dhuna zakonisht nuk sjell përfundime të mira. Dhe intransigjenca shkatërron edhe çështjet më të drejta. Ky ishte mendimi i mjaft vetave, të cilët i gjykonin punët me gjakftohtësi, dhe të cilët ishin kundër skllavërisë. Një nga këta ishte edhe Lincoln-i, i cili përkrahte mendimin që reformat duhesh të bëheshin me mjete paqësore dhe duke respektuar ligjet.

Më vonë në Kansas filloi një grindje e madhe midis atyre që ishin kundër skllavërisë dhe atyre që ishin në favor të skllavërisë. U themeluan dy qeveri rivale dhe luftuan haptazi kundër njëra-tjetrës. Pronarët e tokave, që kishin skllëvër, qëndronin me armë në dorë. Qyteti Lawrence u dogj dhe u grabit nga ata që ishin në favor të skllavërisë. Nga ana tjetër, John Brown-i, i cili kërkonte zhdukjen e skllavërisë pushkatonte zotërit e skllëvërve. John Brown-i kryesonte një çetë, në të cilën bënë pjesë edhe pesë djem të tij. Ai besonte se misioni i tij ishte ky: të lironte

## XHEVAT KALLAJXHI

skllevërit me forcë. Nuk e tronditnin vrasjet që bënte, me gjithë se, siç thuhet, kishte shpirt të mirë. Besonte se ishte një mjet hakmarrjeje, i ngarkuar nga perëndia! Kështu, gjaku solli gjakun, dhe ky qytet u pagëzua me emrin “Kansas i përgjakur”.

Pas ngjarjeve në Kansas, John Brown-i u bë gjithnjë më i rreptë. Në krye të një çete, duke pasur më vete edhe djemtë e tij, sulmoi qytetin e vogël Harper's Ferry, në Virginia, ku zaptoi arsenalin e Qeverisë federale. Qëllimi i tij ishte të merrte armë, të armatoste zezakë dhe të fillonte luftën e çlirimit! Një grup ushtarësh, i komanduar nga Koloneli Robert Lee, e rrethoi këtë depo armësh dhe, pas disa orë luftimesh të rrepta, e mori përsëri në dorëzim. John Brown-i u kap i gjallë, i plagosur. U dënua me vdekje nga një gjykatore e Virginia-s dhe u ekzekutua në litar. Gjatë zhvillimit të procesit, John Brown tha këto:

“Unë besoj se kjo gjykatore do të njohë vlerën e Ligjit të Zotit... Ky Ligj më mëson se unë duhet të bëj për të tjerët atë që do të dëshiroja të bëhej për mua. Unë u detyrova t'i bindem këtij Ligji... Tani, në qoftë se është e nevojshme që të jap jetën për drejtësi dhe të përziej gjakun tim me atë të bijve të mi dhe me atë të miliona njerëzve të tjerë, të drejtat e të cilëve janë marrë nëpër këmbë kaq çnjerëzisht nga skllavëria, unë

## LINCOLN

jam gati ... U bëftë ajo që është thënë ...”

Dhe një natë para se të ekzekutohej, ai u shkroi djemve një letër, të cilëve u tha këto: “Jam i gëzuar që po jap jetën për mbrojtjen e së vërtetës së përjetshme së Perëndisë”. Në atë rast mendimet mbi John Brown-in u ndanë më dysh: ata që ishin kundër skllavërisë e quajtën një martir; ata që ishin në favor të skllavërisë e quajtën një kriminel. Dhe më vonë Emerson-i e cilësoi “Një idealist i madh, me një shpirtgjerësi të pakufishme”.

Gjendja e skllavërve zezakë, si përfundim të këtyre kundërshtimeve, u vështirësua gjithnjë më tepër. Mjaft prej tyre filluan të arratisen. Për këtë arsye u bë një ligj i posaçëm, me të cilin ngarkoheshin autoritetet e Qeverisë Federale që të arrestonin të gjithë ata që largoheshin fshehurazi nga zotërit e tyre. Ligji parashikonte dënime edhe për ata qytetarë të bardhë që i nxitnin skllavërit të arratiseshin ose ndihmonin ata që arratiseshin. Për arrestimin e një zezaku nuk duhesh asnjë provë. Dëshmia e tij ishte e pavlefshme. Gjykimi i tij nga ana e jurisë ishte mohuar. Këto masa kaq të rrepta e të padrejta tronditnin shpirtin e shumë njerëzve.

Një ditë në qytetin Galesburg të Shtetit Illinois arriti një zezak i reckosur dhe gjysmë

## XHEVAT KALLAJXHI

i vdekur nga uria. Ai kallëzoi se ishte arratisur nga një çiflig në Missouri së bashku me pesë të tjerë, nga të cilët dy u vranë dhe tre u kapën. Disa nga banorët e qytetit Galesburg e fshehën zezakun e arratisur dhe u kujdesën ta dërgojnë në Kanada, që ishte bërë një tokë shpëtimi për skllëverit. Pas kësaj ngjarje, në shumë qytete u organizuan, vetvetiu dhe njëra pas tjetrës, dega të një organizate të fshehtë për të ndihmuar skllëverit zezakë që arratiseshin nga tokat e zotërve të tyre.

Më 1852 u botua një libër me titullin “Kasollja e Xha Tomit”, në të cilën përshkruheshin, në një mënyrë të gjallë dhe prekëse, gjendja tragjike e skllëvërve zezakë, shitblerja e tyre si kafshë, dhe arratisja e tyre plot rreziqe e peripecira. Autorja e kësaj vepre, Harriet Beecher Stove, bijë dhe bashkëshorte fetarësh puritanë, kishte jetuar disa kohë në vise ku kishte skllëvër zezakë dhe i kishte parë me sytë e saj vuajtjet e tyre të tmerrshme; kishte parë burra, gra e fëmijë të vënë pothuajse lakuriq mbi një tryezë për t’u shitur në ankand!

Është e vërtetë se edhe më parë poetë si Whittier, Lowell, Emerson dhe Longfellow kishin shprehur, me vargje, ndjenjat e dhimbshme të shpirtit të tyre për vuajtjet çnjerëzore të

## LINCOLN

sklleverve zezakë. Të njëjtën gjë kishin bërë, me fjalime dhe shkrime, edhe mjaft klerikë dhe burra shteti. Por libri i Harriet Beecher Stove bëri një bujë të madhe brenda dhe jashtë Amerikës. Me këtë vepër, shkrimtarja vuri në dukje se ishte një gjë antikristiane skllavëria dhe shit-blerja e njerëzve. Nga ky libër u shtypën 300.000 kopje dhe u përhapën në të gjitha anët e Shteteve të Bashkuara. Shumë veta derdhën lot me ngashërim kur lexuan ngjarjet e tmerrshme që kallëzoheshin me të. Dhe një shkrimtar i huaj, në komentimin që i bëri shumë vjet më vonë kësaj vepre, tha këto:

“Tragjedia e skllavërisë është përshkruar në një mënyrë të ngjethshme në këtë vepër të pavdekshme, të cilën mund ta quajmë si “poemën e hidhërimit”. Kjo vepër ushtroi një influencë vendimtare për të thyer zinxhirët e urryer që qëndronin, qysh prej shumë kohësh, rreth qafës së kaq kreatyrave fatkeqe. “Kasollja e Xha Tom’-it nuk është vetëm një roman plot lëvizje dhe pasione, por është edhe një betejë që u fitua me emrin e së vërtetës, së ndjenjës njerëzore dhe së drejtësisë...”

Me gjithë se shkrimtarja, Harriet Beecher Stove, dha prova se ishte e paanshme në ato që shkruajti, përsëri Jugu e gjikoi romanin e saj të gënjeshtërt dhe të shkruar me një frymë

## XHEVAT KALLAJXHI

partizanije. Mirëpo bota e tërë e pranoi si të vërtetë dhe romani “Kasollja e Xha Tomit” u përkthye në shumë gjuhë të huaja. Dhe më vonë, kur Lincoln-i e takoi autoren gjatë Luftës Civile, tha këto fjalë: “Ja një grua e vogël që shkaktoi një luftë të madhe”.

Një tjetër ngjarje me rëndësi ishte ajo e një zezaku të quajtur Dred Scott. Ky ishte skllav i një mjeku ushtarak nga Missouri, i quajtur Emerson, i cili u transferua në Illinois, një shtet pa skllavë. Pas dy vjetësh doktori u kthye përsëri në Missouri, duke pasur gjithnjë më vete Dred Scott-in. Më vonë, kur vdiq i zoti, Scott-i kërkoi nga e veja e doktorit që ta linte të lirë, pasi - duke qëndruar për një kohë në një vend të lirë - e quante vehten të dalë nga gjendja e skllavërisë. Scott-i u drejtua gjykatores së qytetit St. Louis, e cila mori parasysh kërkesën e tij. Mirëpo vendimi i kësaj gjykatoresje u hodh poshtë nga gjykatorkja e lartë e Missourit. Atëherë Scott-i i u drejtua një gjykatoresje federale, por edhe kjo aprovoi vendimin e gjykatores së lartë të Missourit. Pas disa vjetësh, çështja e Scott-it arriti gjer në Gjykatoren e Lartë të Shteteve të Bashkuara.

Në të vërtetë Scott-i ishte një analfabet dhe nuk qe në gjendje të ndiqte një proces kaq të gjatë, por u nxit dhe u ndihmua me çdo mënyrë

## LINCOLN

nga ata që ishin kundër skllavërisë, të cilët dëshironin që të merresh një vendim në favor të Scott-it. Por edhe Gjyktorja e Lartë e Shteteve të Bashkuara vërtetoi vendimin e gjykatores së lartë së Missouriit, duke e hedhur poshtë kërkesën e Dred Scott-it. Kryetari i Gjykatores së Lartë së Shteteve të bashkuara, Roger Taney, përkrahu pikëpamjen se Kushtetuta ishte bërë vetëm për të bardhët, se zezakët nuk kishin asnjë të drejtë dhe, pasi konsideroheshin si pronë, Qeveria Federale nuk mund të ndërhynte.

Ky vendim i Gjykatores së Lartë bëri një përshtypje shumë të keqe në të gjitha shtetet e Amerikës, që ishin kundër skllavërisë. Nuk ishte dhënë kurrë më parë një vendim kaq i rreptë dhe çnjerëzor, i cili, duke u shërbyer interesave të zotërve të skllavëve, krijonte një precedencë të keqe. Dhe Lincoln-i, në një fjalim që mbajti në Springfield, e dënoi këtë vendim. Ai tha se ishte një vendim krejt i gabuar dhe kërkoi që të mos pranohej si një precedencë.

Këto dhe ngjarje të tjera shkaktuan që grindjet midis Veriut dhe Jugut të keqësoheshin gjithnjë më tepër, dhe çështja e skllavërisë të bëhej një problem kombëtar. Banorët e shteteve të veriut e quanin skllavërinë si një gjë që vinte në kundërshtim me Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara dhe kërkonin që t'i

## XHEVAT KALLAJXHI

jepej fund. E konsideronin si një gjë të padrejtë, çnjerëzore dhe pa asnjë justifikim dhe bazë morale. Banorët e shteteve të jugut thoshin se Kushtetuta nuk përmban asnjë dispozitë që e ndalon skllavërinë, dhe se Qeveria Federale nuk ka të drejtë të ndërhyjë në këtë çështje. Përkrahnin pikëpamjen se çdo shtet është sovran për rregullimin e punëve të tij të brendshme. Thoshin gjithashtu edhe këto: “Ne e duam skllavërinë si syt’ e ballit dhe jemi të vendosur ta mbajmë, me mjete paqësore, po të mundim; dhe me luftë, po të jetë nevoja”.



## LINCOLN

### DEBATET HISTORIKE LINCOLN- DOUGLAS

Prej vitit 1849 e gjer në vitin 1854 Lincoln-i u tërhoq nga jeta politike dhe u mor përgjithësisht me profesionin e tij si avokat. Por pas vitit 1854, ai iu kushtua, me një gjallëri të madhe, veprimtarisë politike. Atë vit, nga grupet e ndryshme të partisë Whig, u formua Partia Republikane me parime liberale. Lincoln-i u bë një nga organizatorët më aktivë të kësaj partie, e cila caktoi si pikë të parë të programit të saj sigurimin e Bashkimit të Kombit dhe mbrojtjen e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara.

Lincoln-i ishte një dishepull i Jefferson-it, kauzën e të cilit për liri dhe drejtësi e kishte bërë të vetën. Lincoln-i kishte një admirim të thellë për Jeffersonin, për të cilin tha një herë këto: “Jefferson-i është njeriu që, në përpjekjen e tij për pavarësi, pati zgjuarsinë dhe aftësinë të futë një të vërtetë abstrakte brenda në një dokument revolucionar për të gjithë njerëzit dhe për të gjithë kohët; është njeriu që vuri bazat e një kështjelle mbrojtëse të fortë kundër çdo forme të tiranisë e të shtypjes...”

## XHEVAT KALLAJXHI

Lincoln-i u shty të veprojë me gjallëri jo vetëm se besonte në parimet që frymëzonin partinë në të cilën bënte pjesë, por edhe sepse u prek fort nga hedhja poshtë e “Kompromisit të Missouriit” të vitit 1850. Me anulimin e këtij kompromisi çelej rruga që skllavëria të përhapesh edhe në shtete e territore ku nuk kishte skllavër, dhe i jepej një hov i ri kapjes së skllavërve zezakë, që arratiseshin nga tokat e zotërve të tyre. Njëkohësisht u bë edhe ligji Kansas-Nebraska, i cili lejonte ekstradimin e zezakëve që arratiseshin dhe gjenin strehim në viset e Veriut, ligj të cilin Lincoln-i e cilësoi si “legalizimin e një krimi”.

Në kuvendin e parë të Partisë republikane, që u mbajt në Philadelphia në qershor të vitit 1856, mori pjesë si delegat edhe Lincoln-i. Ai kuvend caktoi kandidatin e Partisë Republikane për në zgjedhjet për president të Amerikës. Si të tillë caktoi John Fremont-in, i cili nuk fitoi dot në zgjedhjet. Përkundrazi fitoi kandidati i Partisë Demokrate, James Buchanan. Ai kuvend aprovoi edhe një rezolutë, me të cilën theksoi se “Kongresi i Shteteve të Bashkuara ka të drejtë dhe detyrë ta zhdukë skllavërinë”.

Në kohën kur u organizua Partia Republikane, Lincoln-i mbajti shumë fjalime në vise të ndryshme. Ai mbajti fjalime edhe në kohën kur

## LINCOLN

shtroi kandidaturën për president Fremonti. Dhe ishte, në pjesë të madhe, për hir të fjalimeve të Lincoln-it që Partia republikane mori në atë rast një shumicë të madhe votash nga populli. Dhe një nga fjalimet me rëndësi që mbajti Lincoln-i në Edwardsville, me të cilin u vunë në dukje zotësia e ligjërit dhe parimet e tij të qarta, ishte ky:

“Cila është ajo që përbën kështjellën e lirisë e të pavarësisë sonë? Besimi ynë qëndron në dashurinë për liri, të cilën Perëndia e ka rrënjosur në shpirtin tonë. Mbrojtja jonë qëndron në ruajtjen e frymës që e çmon lirinë si një trashëgim për të gjithë njerëzit, kudo. Po të shkatërrojmë këtë frymë, atëherë do të mbjellim farën e despotizmit në vatrat tona. Po të familjarizohemi me zinxhirët e skllavërisë, atëherë do të arrijnë që ata zinxhirë t’i lidhim edhe në qafën tonë. Po të pengojmë të drejtat e të tjerëve, atëherë do të humbasim edhe të drejtat tona dhe do të çelim rrugën për të hyrë nën sundimin e tiranisë...”

Më 1858 Partia Republikane e caktoi Lincoln-in si kandidat të saj kundër senatorit demokrat, Stephen Douglas, i cili kërkonte të zgjidhej për herën e dytë për në senatin e Shteteve të Bashkuara. Në atë rast u parashikua se fushata e zgjedhjeve do të zhvillohej në një mënyrë të

## XHEVAT KALLAJXHI

rreptë midis këtyre dy rivalëve, veçanërisht për sa i përkiste çështjes së skllavërisë.

Por vlen të theksohet këtu se Lincoln-i, ndonëse e dënonte skllavërinë, nuk ishte fanatik në mendimin e tij dhe nuk kërkonte që kjo çështje të zgjidhej me mënyra arbitrare. Në të vërtetë, ai e kuptonte fare mirë gjendjen e Jugut dhe nuk predikonte urrejtje kundër zotërve të skllëvërve. Nga ana tjetër, ai bënte ç'ishte e mundur që të evitohet me çdo kusht një çthurrije eventuale e Bashkimit të Kombit.

Po kur Lincoln-i pranoi caktimin e tij nga partia si kandidat për në zgjedhjet senatoriale, e përcaktoi fare qartë qëndrimin e tij kundër skllavërisë me një fjalim që mbajti në qershor të vitit 1858. Në atë fjalim, që njihet në histori me titullin “Shtëpia e Ndarë”, Lincoln-i tha, ndër të tjera, këto:

“... Pas mendimit tim, ky problem nuk mund të zgjidhet pa u kapërcyer një krizë. Një shtëpi e ndarë nga brenda nuk mund të qëndrojë më këmbë. Unë mendoj se vendi ynë nuk mund të jetojë për kurdoherë gjysmë skllav dhe gjysmë i lirë. Unë nuk pres të shoh që Bashkimi i Kombit të shthuret. Unë nuk besoj që shtëpia do të rrëzohet, por besoj se do të marrë fund ndarja e saj. Do të përfundojë ose të jetë krejt e njerës palë, ose të jetë krejt e palës tjetër...”

## LINCOLN

Para se ta mbante këtë fjalim me rëndësi, Lincoln-i ua tregoi disa miqve të tij në Springfield, por as njeri prej tyre nuk e pëlqeu. Që të gjithë i thanë se ishte pa vend dhe tepër i dëmshëm. Bile njeri e quajti një vetëvrasje politike për Lincoln-in. Por ai u tha këto fjalë:

“Dëgjoni miqtë e mi: Kjo çështje është zvargur mjaft. Besoj se nuk pret më. Edhe durimi ka një kufi. Në qoftë se unë do të humbas për shkak të këtij fjalimi, atëherë le të humbas. Le të bije viktimë e mbrojtjes së një të vërtete. Le të vdes për atë që është një çështje e drejtë”.

Fjalimi i Lincoln-it bëri, në një shumicë të madhe, përshtypje të mirë.

Ajo që parashikohej u vërtetua: fushata e zgjedhjeve u zhvillua në një mënyrë të rreptë midis Lincoln-it dhe Douglasit. Lincoln-i i bëri sfidë kundërshtarit të tij që të zhvillonin një sërë debatesh publike, në disa qytete të shtetit Illinois, mbi çështjen e skllavërisë. Douglasi e pranoi, dhe debatet u zhvilluan në këto qytete: Ottawa, Freeport, Jonesboro, Charleston, Galesburg, Quinct dhe Alton. Debatet ishin shtatë, nga të cilët i pari u bë më 21 gusht dhe i fundit më 15 tetor të vitit 1858.

Thema e këtyre debateve ishte kjo: Douglasi përkrahte tezën që në çështjen e skllavërve

## XHEVAT KALLAJXHI

territoret dhe shtetet duhesh të ishin autonome. Lincoln-i përkrahte tezën që vetëm Kongresi i Shteteve të Bashkuara ishte kompetent të merresh me problemin e skllavërisë. Lincoln-i e konsideronte pikëpamjen e Douglassit si një kurth, sepse, në qoftë se çështja e skllavërisë do të liresh në dorën e çdo shteti, atëherë kjo e keqe nuk do të zhdukesh kurrë.

Lincoln-i dhe Douglassi nuk ndodheshin në kushte të barabarta. Douglassi kishte qenë senator në Kongresin e Shteteve të Bashkuara, kishte qenë kryetar' i Partisë Demokrate, dhe kishte qenë kandidat për president i Amerikës në zgjedhjet e vitit 1856. Lincoln-i kishte qenë vetëm deputet në Kongresin e Shteteve të Bashkuara. Me gjithë këtë, në Shtetin Illinois, ku ushtronte profesionin si avokat, ai respektohej për ndershmërinë e tij, për logjikën e tij, për karakterin e tij.

Douglassi ishte edhe një orator i mirë dhe dinte të tërhiqte masat e popullit. Përveç këtyre, ishte i pasur, i zgjuar, i pashëm, i shkathët; dinte të paraqitesh mirë në shoqëri, vishej bukur dhe, me qenë se ishte i shkurtër nga shtati, kishte fituar mbiemrin “gjigandi i vogël”. Pastaj në qendrat e qyteteve, ku zhvilloheshin debatet, shkonte me salltanet dhe i hipur në një karrocë të hapët, ndërsa Lincoln-i vinte më këmbë dhe

## LINCOLN

i veshur në mënyrë të thjeshtë: me redingotin e famshëm me mëngë shumë të shkurtra!

Por Lincoln-i kishte diçka të veçantë që i mungonte Douglasit: kishte parime të qarta dhe ishte i patundur në to; ishte i sqartë dhe frymëzohej nga ndjenja të vërteta njerëzore; dhe mbi çdo gjë vinte interesat e kombit e të popullit. Prandaj argumentet e tij ishin të forta. Fakti është që gjatë debateve Douglasi u vu shpesh herë në një gjendje të vështirë. Lincoln-i përmendi në disa raste ngjarjet e Kansas-it dhe vendimin gjyqësor që ishte dhënë kundër zezakut Dred Scott. Përballë këtyre pikave delikate, Douglasi mendohej gjithnjë të shkiste ose të jepte përgjigje të vakëta e me dy kuptime.

Douglasi përpiqej të manovronte sipas rasteve dhe evitonte të shprehej haptazi mbi pika delikate. Arsyeja ishte se ai kërkonte jo vetëm të zgjidhej përsëri senator, por ëndërronte që një ditë të bëhej edhe president i Amerikës. Prandaj kërkonte, siç thotë një proverb shqip, që “edhe mishi të piqej, edhe helli të mos digjej”. Dhe kishte shumë njerëz që e pasonin dhe e brohoritnin.

Kur zhvilloheshin këto debate, merrnin pjesë me mijëra veta nga vende të afërta e të largëta, të cilët shkonin me trena, me karroca, me kuaj dhe më këmbë. Që të gjithë dëshironin të dëgjonin

## XHEVAT KALLAJXHI

fjalimet e këtyre dy burrave që përkrahnin dy pikëpamje të kundërta. Dhe në këto debate herë duartrokitej Lincoln-i e fërshëllehej Douglasi, herë fërshëllehej Lincoln-i e duartrokitej Douglasi. Atje ku kishte një shumicë të madhe njerëzish në favor të skllavërisë triumfante Douglasi. Atje ku kishte një shumicë të madhe njerëzish kundër skllavërisë triumfante Lincoln-i. Bile në këto debate ndodhte nga ndonjëherë edhe ndonjë skenë komike: një herë një grua e bardhë kishte bërë një kukull të zezë, të cilën e lëvizte përpara syve të Lincoln-it. Ky, pa e humbur gjakftohtësinë, i u drejtua asaj dhe i bëri këtë pyetje:

- Zonjë, fëmija juaj është kjo?

Në një nga fjalimet me rëndësi që mbajti Lincoln-i tha, ndër të tjera, këto: "...Çështja e skllavërisë ka rrezikuar Bashkimin e Kombi... Amerika duhet të qëndrojë e bashkuar... Amerika duhet të jetojë e lirë, dhe jo pjesërisht, por krejtësisht... Skllavëria është një krim... Në qoftë se skllavëria nuk është një krim, atëherë asgjë tjetër në botë nuk mund të quhet krim... Sikundër nuk dua të jep një skllav, po ashtu nuk dua të jem një pronar skllavërisht. Kjo shpreh idenë time të demokracisë. Çdo gjë që ndryshon nga kjo pikëpamje nuk është demokraci..."



## LINCOLN

Dhe në një fjalim tjetër, që mbajti më vonë - i cili u fërshëllye kur përmendi çështjen e skllavërisë - Lincoln-i tha këto: "... E di mirë se ju do ta përkrahni pikëpamjen tuaj vetëm këtu dhe vetëm tani, dhe kurrë më në të ardhmen. Por unë di edhe që çdo njeri vjen në këtë botë me një trup që kërkon të vishet, dhe me një gojë që kërkon të ushqehet. Di gjithashtu se çdo njeri ka dy duar, dhe mendoj se ato dy duar u krijuan për të ushqyer gojën dhe për të veshur atë trup. Unë ju bëj të ditur se cilido që do të kërkojë të ndalojë duart nga funksioni i tyre, ai do të dhunojë drejtësinë, dhe drejtësia do ta verë në vend... Për mua qëndron gjallë shembëlla e lirisë dhe e drejtësisë e atyre që themeluan këtë Republikë... Fërshëllimet e tuaja nuk do t'i rrëxojnë muret e drejtësisë... Skllavëria është një krim..."

Me gjithë këto mendime të qarta e të sinqerta të Lincoln-it, Douglas u zgjodh përsëri senator. Por Lincoln-i fitoi një emër të madh. Me fjalimet e tij, ai preku dhe tronditi shpirtrat e shumë vetave. Ai tronditi edhe vetë radhët e Partisë Demokratë. Ndofta asnjë mjet tjetër nuk do të kishte mundur t'i shërbente aq mirë Lincoln-it sa i shërbyen debatet që pati me kundërshtarin e tij, Stephen Douglas. Kudo u hap fjala se

## XHEVAT KALLAJXHI

logjika e Lincoln-it e rrëzoi poshtë elokuencën e Douglas-it. Emri i Lincoln-it u dëgjua jo vetëm në krejt Amerikën, por edhe në shumë vende të botës. Vlera e këtij avokati të ndershëm të Springfield-it u mësua dhe u çmua në të gjitha anët e vendit të tij. Dhe kjo gjë çeli rrugën për një të ardhme më të shkëlqyer për këtë njeri të madh që lindi në një kasolle të vogël ...

Lincoln-i nuk u dëshpërua dhe nuk u shkura-jua që nuk u zgjodh senator. Përkundrazi ai fitoi një gjallëri më të madhe. Dhe një miku të tij i shkroi këto: “Harroje këtë gjë. Ne së shpejti do ta ndjejmë veten më mirë. Në një kohë të afërt do të japim një grusht tjetër më të madh. Ne do të shohim gjëra të tjera më të çuditshme...”

Pas mbarimit të zgjedhjeve senatoriale, Lincoln-i, mbajti gjatë vitit 1859 dhe gjer në muajt e parë të vitit 1860, shumë fjalime në vise të ndryshme të Amerikës. Ai kërkonte të ndriçonte opinionin publik mbi shumë gjëra. Dhe kishte besim në zgjuarsinë e popullit, për të cilin tha një herë këto: “Të gjithë njerëzit mund t’i gënjesht për disa kohë. Disa njerëz mund t’i gënjesht për gjithë kohën. Por nuk është e mundur t’i gënjesht të gjithë njerëzit për gjithë kohën”.

LINCOLN



**Senatori Stephen A. Douglas**

## LINCOLN-I PRESIDENT I AMERIKËS

Viti 1860 ishte viti i zgjedhjeve presidenciale në Amerikë. Me atë rast, më 23 prill, në qytetin Charleston të Shtetit South Carolina u mbajt kuvendi i Partisë Demokrate për të emëruar kandidatin e vet për në ato zgjedhje. Mirëpo gjatë bisedimeve delegatët e Partisë Demokrate u ndanë në dy grupe: në njërin grup shkuan demokratët e Veriut dhe në tjetrin grup shkuan demokratët e Jugut. Më vonë këto dy grupe u mbledhën veç e veç në Baltimore për të caktuar kandidatët e tyre për president. Demokratët e Veriut caktuan Stehpehn Douglas-in. Demokratët e jugut caktuan John Breckenridge, i cili ishte nënpresident i Amerikës.

Kuvendi i partisë Republikane u mbledh, më 16 Maj në Chikago. Në atë Kuvend njerëzit më të preferuar, për t'u caktuar si kandidatë për president, ishin William Seward, Kryetari i Partisë Republikane dhe Abraham Lincoln-i. Por në përfundim të tre votimeve që u bënë, u zgjodh Lincoln-i. Sewardi me gjithë se mbeti i prekur, i siguroi menjëherë përkrahjen e tij Lincoln-it, emërimi i të cilit u prit me dëshpërim

## LINCOLN

të thellë në shtetet e Jugut. Ndërkohë, kuvendi i Partisë Republikane miratoi edhe një program me të cilin theksoi, ndër të tjera se “Kushtetuta, Bashkimi i Kombit dhe të drejtat e shteteve duhet të mbahen dhe do të mbahen të pacenuara”.

Fushata e këtyre zgjedhjeve u zhvillua me një ashpërsi të jashtëzakonshme. Shtetet e Jugut e luftuan Lincoln-in me një rreptësi të madhe, dhe e përshkruan me epitetet më përçmuese. “Lufta kundër Lincoln-it është bindje ndaj Zotit”. Kjo ishte një nga parullat e ndryshme që u përdorën asikohe kundër kandidatit të Partisë Republikane. Me gjithë këtë luftë të ashpër, në zgjedhjet që u bënë më 6 Nëntor fitoi Lincoln-i.

Vlen të vihet në dukje këtu se në votat e përgjithshme popullore, që u dhanë në krejt kombin, Lincoln-i nuk mori ndonjë numër të madh, por ai fitoi shumicën në “votat elektorale”. Në shtetet e Jugut ai mori vetëm 24.000 vota. Nëntë shtete të Jugut votuan unanimisht kundër tij<sup>1</sup>. Fitorja e Lincoln-it i zemëroi akoma më shumë banorët e shteteve të Jugut. Dhe shumë veta, me letra anonime, e kërcënuan se “nuk do të hynte i gjallë në Shtëpinë e Bardhë”.

<sup>1</sup> Në këto zgjedhje u dhanë 4.676.855 vota popullore, nga të cilat Lincoln-i mori 1.866.352. Votat e tjera u ndanë midis Stephen Douglas, John Breckenridge dhe John Bell. Ky i fundit ishte kandidat i Partisë “Constitutional Union”. Por nga “votat elektorale” Lincoln-i mori 180, Breckenridge 72, Bell 39 dhe Douglas 12.

## XHEVAT KALLAJXHI

Në kohën kur u bënë zgjedhjet, Lincoln-i ndodhej në Springfield. Dhe ditën kur u njoftua lajmi mbi përfundimin e votimeve, ai ishte në zyrën e vet dhe bënte shaka me ortakun e tij, William Herndon. Në atë zyrë ndodheshin edhe disa përkrahës të Lincoln-it. Ndërkaq, kur jashtë në rrugët filluan të dëgjohen zëra të forta “fitoi Lincoln-i”, ky i u drejtua ortakut dhe i tha: “Besoj se një zonjë e vogël në shtëpinë time do ta presë me gëzim këtë lajm; shko lajmëroje, të lutem”.

Por Mary e kishte mësuar lajmin më parë dhe fluturonte nga gëzimi i thellë që do të ishte Zonja e parë e kombit dhe do të mbretëronte disa vjet në Shtëpinë e Bardhë. Përkundrazi Lincoln-i ra në mendime të thella, sepse shihte gjendjen e turbullt të kombit dhe ndjente peshën e rëndë të një përgjegjësie të madhe që merrte përsipër në një nga periudhat më kritike të historisë amerikane.

Lincoln-i, me gjithë se ishte ndarë qysh prej shumë vjetësh nga të afërmit e tij, nuk i kishte harruar kurrë ata. Përkundrazi, si atit të tij ashtu dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij u kishte dërguar shpesh herë të holla dhe ishte interesuar për mirëqenien e tyre. Prandaj, para se të largohej nga Springfieldi për në Washington, ai

## LINCOLN

shkoi vizitoi, më 31 janar të vitit 1861, në Coles County, njerikën e tij plakë, për të cilën ndjente një dashuri dhe respekt të thellë, sepse ajo kishte zëvendësuar për Lincoln-in dhembshurinë e vërtetë të nënës së tij, Nancy. I ati i Lincoln-it, Thomas-i, kishte vdekur më 1851, në moshën 76-vjeçare.

Lincoln-i, së bashku me të shoqen dhe të tre djemtë u nis më 11 shkurt 1861 për në Washington, për të marrë përsipër detyrën e tij të lartë. Kur u nis ishte një mëngjes melankolik. Qielli ishte i mbuluar me re dhe binte një shi i hollë. Në stacionin e trenit kishin dalë pothuajse të gjithë banorët e Springfield-it për ta përcjellë dhe për t'i uruar udhën e mbarë. Që të gjithë qëndronin në heshtje. Lincoln-i dukej i pikëlluar. Në melankolinë e atij mëngjesi bashkohesh edhe melankolia e tij. Në fytyrën e Lincoln-it dukeshin shenjat e një hidhërimi të thellë. Ai parandjente se kombin dhe popullin amerikan e prisnin ditë të zeza. Një gazetar, që u ndodh atje, shkroi se Lincoln-i atë ditë dukesh si "një statujë e gjallë trishtimi". Para se të nisesh treni, Lincoln-i u drejtoi njerëzve që e përcillnin këto pak fjalë:

"Miq të mi: Asnjë njeri, që nuk ndodhet në gjendjen time, nuk mund ta kuptojë trishtimin që ndjej unë që ndahem nga ju. Këtij vendi dhe këtij populli fisnik unë i detyroj çdo gjë.

## XHEVAT KALLAJXHI

Këtu jetova një çerek shekulli; erdha i ri dhe u plaka. Këtu lindën bijtë e mi, dhe këtu është varrosur njeri prej tyre. Unë tani po largohem dhe nuk e di se kur do t'ju shoh dhe në se do t'ju shoh përsëri. Mbi mua rëndon një detyrë e madhe dhe e vështirë, ndofta më e vështirë se çdo detyrë që ka provuar ndonjë tjetër njeri pas Washington-it. Ai nuk do të kishte mundur të delte faqebardhë pa ndihmën e Perëndisë, në të cilën besoi kurdoherë. Lutjuni, o miq të mi, që të më ndihmojë edhe mua... Ju lë lamtumirën me gjithë zemër”.

Udhëtimi i Lincoln-it gjer në Washington zgjati nja dy javë. Ai u ndal në shumë vende dhe kudo u prit përgjithësisht me dashuri. Dhe kudo mbajti fjalime të shkurtra optimiste. Përpiqej t'i mbante shpirtrat të gjalla. Thoshte se “nuk ekziston veçse një krizë e përciptë”. Thoshte gjithashtu se “Bashkimi i Kombit nuk do të çthurret”. Shprehte dëshirën e tij të thellë për paqe e harmoni dhe theksonte vazhdimisht se “nuk do të derdhet asnjë pikë gjaku për gjer sa nuk do të provokohet qeveria”. Lincoln-i u ndal edhe në Philadelphia dhe vajti vizitoi “Independence Hall”, sallën ku u nënshkrua Deklarata e Pavarësisë Amerikane më 1776. Atje ai mbajti edhe një fjalim të papërgatitur, në të cilin tha këto:



## LINCOLN

“Unë, në çdo fjalim politik që kam mbajtur, jam frymëzuar kurdoherë nga ndjenjat dhe parimet që përmbahen në Deklaratën e Pavarësisë..., e cila siguron jo vetëm liri për këtë komb, por edhe shpresë për të gjithë botën dhe për të gjitha kohët e ardhme ... me këtë deklaratë është premtuar se me kohë do të hiqen peshat e rënda nga kurrizi i të gjithë njerëzve, dhe se të gjithë do të gëzojnë raste e të drejta të barabarta. Pra, o miq të mi, a mund të shpëtohet ky komb në bazë të këtij parimi? Në qoftë se po, atëherë unë do ta ndjej veten një nga njerëzit më të gëzuar në botë, sikur të mund të ndihmoj për shpëtimin e tij. Në qoftë se nuk mund të shpëtohet në bazë të këtij parimi, atëherë do të jetë një gjë e tmerrshme... dhe unë do të desha më mirë të vritesha në vend, se sa të pranoja shkeljen e këtij parimi”.

Gjatë këtij qëndrimi në Philadelphia, u mor vesh se ishte përgatitur një komplot kundër jetës së Presidentit, komplot i cili do të kryesh në qytetin Baltimore. Gjenerali Winfield Scott, që shoqëronte Presidentin, bëri menjëherë një ndryshim në programin e udhëtimit. Lincoln-i u nis fshehurazi jashtë orarit, me një tren të thjeshtë. Më vonë u nis edhe treni i Presidentit, i cili nuk u ndal në Baltimore. Nuk ndodhi asgjë. Lincoln-i arriti në Washington më 23 shkurt

## XHEVAT KALLAJXHI

dhe, gjer ditën që mori në dorëzim detyrën si President i Shteteve të Bashkuara, qëndroi, së bashku me familjen, në hotelin Willard, si një qytetar i thjeshtë.

Ditën e 4 Marsit u bë ceremonia e betimit të Lincoln-it si president. Atë ditë gjithë kryeqyteti u zbukuria me flamurët e kombit. Presidenti i vjetër, Buchanan, shkoi në hotelin Willard dhe mori Presidentin e ri, Lincoln-in, dhe të dy - të hipur në një karrocë të hapët - u nisën për në Kapitol, qendrën e Kongresit të Shteteve të Bashkuara. Rrugët qysh nga Shtëpia e Bardhë e gjer në Kongres, nga do të shkonte Presidenti Lincoln, ishin të mbushura me njerëz, të cilët duartrokitnin e brohoritnin.

Në ballin e karrocës shkonin veteranët e luftës së vitit 1812, të cilët mbanin në duar Flamurin që udhëhoqi fuqinë e George Washington-it në betejat për pavarësi. Pas asaj karroce shkonin karrocet e tjera me ish presidentët e Shteteve të Bashkuara, me anëtarët e Gjykatores së Lartë, me pjesëtarët e trupit diplomatik, me anëtarët e Kongresit, me anëtarët e kabinetit, me guvernatorë të shteteve të ndryshme, me oficerë të lartë të ushtrisë e të marinës, të veshur me uniformë të madhe.

Pas këtyre shkonte edhe një karrocë alegorike,

## LINCOLN

e cila ishte përgatitur nga Shoqata Republikane. Kjo karrocë tërhiqej nga katër kuaj të bardhë dhe mbi të qëndronin dy vajza të rritura, të zëna dorë për dorë, të cilat ishin të veshura njëra me fustan të bardhë dhe tjetra me fustan të kaltërt. Këto përfaqësonin njëra Veriun dhe tjetra Jugun. Rrotull tyre kishin qëndruar edhe 34 vajza të vogla, çdo njëra nga të cilat mbante në dorë flamurin e shtetit të saj.

Pasi arritën në Kapitol, të dy presidentët zunë vend të tribunën e nderit të ngrehur posaçërisht në shkallët përpara hyrjes kryesore të Kongresit. Në tribunë zunë vend edhe bashkëshortja e Lincoln-it, Mary Todd-i, nënpresidenti i ri Hannibal Hamlin-i dhe personalitete të tjera. Senatori Edward D. Baker i a paraqiti popullit Lincoln-in me këto fjalë: “Më lejoni t’ju paraqit Abraham Lincoln-in, Presidentin e ri të Shteteve të Bashkuara”. Populli, numëri i të cilit arrinte nja 10.000 veta u përgjegj përgjithësisht me brohori dhe duartrokitje të nxehta.

Pastaj, si u vendos qetësia, Lincoln-i u përgatit të mbajë fjalimin e rastit. Por kishte në dorë kapelën cilindër dhe bastunin, për të cilët kërkonte ndonjë vend ku t’i vinte. Bastunin e vuri mbi një banko të vogël, ndërsa kapelën e mbante akoma në dorë dhe përgatitesh ta lëshonte përdhe. Por pikërisht në atë çast iu afrua

## XHEVAT KALLAJXHI

Senatori Douglas dhe ia mori. Dhe ishte në atë rast që Senatori Douglas tha këto fjalë: “Edhe në mos kam mundësi të zgjidhem president, të paktën kam rast të mbaj kapelën e presidentit”.

Presidenti Lincoln u drejtua nga ana e popullit, nxori nga xhepi fjalimin e shtypur dhe filloi ta lexojë me zë të qartë. Pasi theksoi edhe njëherë mendimet e tija mbi skllavërinë, si edhe dëshirën e vet që ai problem të zgjidhej me mënyra legale dhe duke respektuar kurdoherë vullnetin e popullit, tha, ndër të tjera, këto:

“...Unë nuk mund as të vërtetoj, as të përgënjeshtroj në se ekzistojnë njerëz, nga njëra ose nga tjetra anë, që përpiqen ta shkatërrojnë Bashkimin e Kombit me çdo kusht, dhe që do të ishin të lumtur po të gjenin rast t’ia arrinin këtij qëllimi... Në qoftë se ekzistojnë, unë nuk kam asgjë për t’u thënë atyre. Unë u drejtohem njerëzve që e duan me të vërtetë këtë Bashkim... Asnjë shtet nuk ka të drejtë, me iniciativën e tij, të tërhiqet legalisht nga ky Bashkim... të gjitha vendimet dhe urdhrat që jepen dhe merren për këtë qëllim nuk kanë asnjë vlerë nga pikëpamja ligjore. Çdo veprim i dhunshëm, që kryhet nga një ose më tepër shtete, kundër autoriteteve të Shteteve të Bashkuara, përbën, në bazë të ligjit, një rebelizëm ose kryengritje... Ajo që kërkoj unë është mbrojtja e Kushtetutës. Unë do të bëj

## LINCOLN

atë që më urdhëron Kushtetuta, në mënyrë që ligjat e Bashkimit Federal të respektohen në të gjitha shtetet... Unë nuk kam aspak ndërmend që të përzihem, drejt për së drejti ose tërthorazi, në sistemet e skllavërisë, në shtetet ku ekzistojnë ato sisteme. Unë besoj se nuk e kam atë të drejtë, dhe nuk mendoj të përdor një të drejtë që s'më takon ... Çdo njeri nga ju duhet të gjykojë me gjakftohtësi ... Atyre që janë të pakënaqur u them këto: në duart tuaja, dhe jo të miat, qëndron vendimi i rrezikshëm i një lufte civile. Qeveria nuk do t'ju sulmojë, në qoftë se nuk do ta sulmoni. Ju nuk jeni betuar përpara Perëndisë që ta shkatërroni Qeverinë e këtij vendi, ndërsa unë do të betohem solemnisht që ta mbaj, ta ruaj dhe ta mbroj.... Ne nuk jemi armiq, por miq, dhe duhet të qëndrojmë miq ... Dhe me gjithë që pasioni e ka ftohur shumë dashurinë tonë dhe i ka liruar tepër lidhjet e miqësisë sonë të vjetër, ne nuk duhet të lemë që këto lidhje të këputen, dhe nuk duhet të harrojmë se jemi vëllezër...”

Pas mbarimit të këtij fjalimi, populli brohoriti dhe duartrokiti vazhdimisht. Pastaj, si u kthye përsëri heshtja, Lincoln-i ngriti përpjete dorën e djathtë dhe, duke vënë mbi Ungjill dorën e mëngjër, tha këto fjalë: “Betohem solemnisht se do të kryej me besnikëri detyrën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara dhe do të përpiqem,

## XHEVAT KALLAJXHI

me të gjithë fuqinë time, të mbaj, të ruaj dhe të mbroj Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara". Këtë betim e bëri përpara Kryetarit të Gjykatores së Lartë, Roger Taney, një plak i respektuar 82-vjeçar, i cili kishte dhënë vendimin, që bëri aq bujë, kundër zezakut Dred Scott.

Si morën fund ceremonitë, Lincoln-i i hipur përsëri në karrocë së bashku me të shoqen, shkoi në hotelin Willard, ku u shtrua një drekë për nder të tij. Dhe si mbaroi dreka, ai, Mary dhe të tre djemtë u nisën për në Shtëpinë e Bardhë, në të cilën u vendosën po atë ditë, më 4 mars, kur u largua presidenti i mëparshëm, Buchanan-i. Por Lincoln-i, edhe pse zuri pozitën më të lartë shtetërore, përsëri nuk e ndryshoi zakonet e tij: u soll pothuajse me të njëjtën thjeshtësi që sillesh edhe kur ishte avokat në Shtetin Illinois. Format protokolare nuk i kishte qejf. Në mëngjes i lustronte vetë këpucët e tija dhe shpesh herë zbriste tek porta e Shtëpisë së Bardhë për të pritur arritjen e gazetave.

Posa filloi nga detyra, Lincoln-i iu përvesh menjëherë punës për riorganizimin e administratës. Mbajti një mbledhje me anëtarët e kabinetit të tij, të cilët i kishte emëruar më parë, duke zgjedhur një të zotë e të nevojshëm për atë kohë. William Seward-in e kishte emëruar Ministër të Jashtëm, Salmon Chase-in, Ministër

## LINCOLN

të Thesarit; Simon Cameron-in, Ministër të Luftës e të tjerë me radhë. Këta në fillim, duke pasur besim në zotësinë e tyre, kujtuan se mund ta përdornin Lincoln-in si të donin. Mirëpo ai u dha të kuptojnë se ishte i vetëdijshëm për rëndësinë e misionit të tij dhe dinte mirë se çfarë duhesh të bëhesh e si duhesh të bëhesh.

Lincoln-it i pëlqente të bënte shakara dhe të kallëzonte anekdota dhe “historira të shkurtra”. Bile edhe në kohërat më tragjike, ai ruante frymën e humorit. Por, nga ana tjetër - siç thotë një biograf i tij - ai dinte të shprehte mendime të thella, më mirë se çdo njeri tjetër. Frymëzohej kurdoherë nga ndjenja të vërteta të drejtësisë dhe përsëriste shpesh herë këto fjalë: “Në qoftë se do të veprojmë në një mënyrë të drejtë, atëherë Perëndia do të jetë me ne, dhe në qoftë se Perëndia do të jetë me ne, atëherë ne nuk mund të dështojmë”.


Intrasigjencën e quante një gjë të kotë e të dëmshme dhe rrallë herë thoshte “jo”. Thoshte *jo* vetëm kur ishin gjëra me rëndësi, kur prekeshin parimet e tija, dhe kur indinjohesh me të vërtetë. Për këtë arsye disa veta e quanin oportunist. Dhe një herë kur një nga bashkëpunëtorët e tij i bëri këtë pyetje: “Si, Zoti President, e ndryshuat mendimin?” - ai u përgjegj kështu:

## XHEVAT KALLAJXHI

“Po, e ndryshova. Unë nuk do të kisha asnjë respekt për një njeri që nuk do të ishte pak më i zgjuar sot nga ç’ishte dje”. Me fjalë të tjera, Lincoln-i nuk kishte asnjë konsideratë për ata njerëz që, edhe duke e parë gabimin, nuk hiqnin dorë prej këtij. Lincoln-i ishte gjithashtu një njeri i duruar, gjakftohtë dhe i sinqertë. Nuk lëndonte zemra dhe nuk zemërohesh për gjëra të vogla e pa rëndësi. Por për gjëra që kishin një karakter jetik dhe lidheshin me interesat e kombit e të popullit, ai nuk mbante rezervë; i shfaqte mendimet haptazi dhe i bënte kritikën pa asnjë ndrojtje. Nuk dinte të bënte manovra dhe i urrente dallaveret politike. Dhe në një rast Lincoln-i tha këto: “Politika ime është ajo që të mos kem politikë”.



# LINCOLN



Shtetet e Bashkuara në kohën e luftës civile

SHKËPUTJA E SHTETEVE  
NGA BASHKIMI I KOMBIT

Kur po bëheshin zgjedhjet për president, Legjislatura<sup>1</sup> e Shtetit South Carolina ishte në sesion. Ishte mbledhur më parë dhe vazhdonte të qëndronte e hapët për të vendosur menjëherë shkëputjen e shtetit South Carolina nga gjiri i Shteteve të Bashkuara, në rast se zgjidhesh Lincoln-i president. Prandaj, posa arriti lajmi i zgjedhjes së këtij, Legjislatura kërkoi të thërritej një asamble kushtetuese, e cila të aprovonte vendimin e shkëputjes.

Zgjedhja e Lincoln-it prodhoi një dëshpërim të thellë në shtetet e Jugut. Ata kishin frikë se një president republikan, veçanërisht një president si Lincoln-i, do të dëmtonte interesat e tyre dhe do t'i jepte fund sistemit të skllavërisë. Prandaj njaft veta, sidomos ekstremistët, u gëzuan që arriti më në fund ora për të ndarë llogaritë me Bashkimin Federal. Por kishte edhe shumë të tjerë që u shqetësuan nga një veprim i tillë.

*1 Përveç Kongresit të Shteteve të Bashkuara, në të cilin përfaqësohet krejt kombi, çdo shtet në Amerikë ka edhe një parlament të tij. Ky parlament, i përbërë nga dy dhoma - siç përbëhet edhe Kongresi i Shteteve të Bashkuara - quhet "Legjislatura e Shtetit".*

## LINCOLN

Asambleja Kushtetuese u mbledh më 20 Dhjetor 1860 në Charleston. Të 169 anëtarët e saj abroguan me unanimitet ligjin e aprovuar më 1788 për hyrjen e Shtetit South Carolina në kushtetutën Federale. Ndërkohë ajo Asamble aprovoi edhe këtë vendim: “Bashkimi që ekziston midis South Carolina-s dhe shteteve të tjerë, nën emrin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me këtë vendim, quhet i prishur”.

South Carolina ftoi njëkohësisht edhe shtete të tjera, që kishin skllëvër, të solidarizoheshin me vendimin e saj dhe të shkëputeshin nga Bashkimi Federal. Pothua brenda në një muaj, nga 9 janari e gjer më 1 Shkurt të vitit 1861, u bashkuan me South Carolina-n edhe këta shtete: Mississippi, Florida, Alabama, Georgia, Lusiana dhe Texas. Dhe më 4 shkurt të atij viti, delegatët e këtyre shtatë shteteve u mbledhën në Montgomery, Alabama.

Ata themeluan një konfederatë të re, në krye të së cilës vunë si president Jefferson Davis. Kjo u quajt “Konfederata e Shteteve të Amerikës”. Në Montgomery u aprovua edhe kushtetuta e konfederatës së re, e cila, me disa ndryshime, ishte pothuajse e njëjlojtë me atë të Shteteve të Bashkuara. Një nga ndryshimet kryesore ishte ky: njihej zyrtarisht dhe plotësisht sistemi i skllavërisë dhe e drejta e të zotërve të skllëvërve

## XHEVAT KALLAJXHI

të shkonin ku të donin së bashku me zezakët e tyre, pa asnjë ndrojtje dhe pengim.

Forma legjislative e konfederatës u nda në dy degë: në senat dhe në dhomë deputetësh. Periudha e zgjedhjes së presidentit u caktua për çdo gjashtë vjet. Asambleja caktoi gjithashtu edhe një flamur të veçantë për konfederatën.

Presidenti Davis, posa filloi nga detyra, emëroi pjesëtarët e kabinetit të tij dhe bëri thirrje për rekrutimin e 100.000 ushtarëve. Dërgoi njëkohësisht edhe një komision prej tre vetësh në Evropë, për të fituar simpatinë e shteteve evropiane, e ndofta edhe përkrahjen e tyre.

Të gjitha këto ndodhën gjatë kohës kur ishte akoma president i Shteteve të Bashkuara Buchanan-i. Ky ishte një njeri i ndershëm, por nuk ishte në gjendje të përballonte ngjarjet me guxim. Dhe ndofta kjo dobësi e tij e lehtësoi më shumë shpejtimin e ngjarjeve dhe shkëputjen e disa shteteve.

Për shembull, në mesazhin mbi gjendjen e kombit, që i drejtoi Kongresit në Dhjetor të vitit 1860, në kohën kur South Carolina ishte shkëputur nga Bashkimi Federal Buchanan-i deklaroi se asnjë shtet nuk kishte të drejtë të braktiste Bashkimin Federal, por shtoi njëkohësisht se Bashkimi, nga ana e tij, nuk mund të përdorte asnjë mjet për ta detyruar një

## LINCOLN

shtet të qëndronte brenda në gjirin e Shteteve të Bashkuara!

Ndofta nuk mund të kishte asnjë tjetër inkurajim më të mirë se ky për ata që predikonin dhe përkrahnin idenë e shkëputjes së shteteve nga Bashkimi Federal. Nuk përjashtohet që kjo deklaratë u bë pa qëllim, por efekti i saj ishte i keq...

Lincoln-i, në fjalimin që mbajti ditën që u betua si president, tha se “nuk kishte aspak ndërmend të përzihesh, drejt për së drejti ose tërthorazi, në sistemin e skllavërisë në ata shtete ku ekzistonte ky sistem”. Tha gjithashtu se “nuk e kishte një të drejtë të tillë”. Prandaj, mund të thuhet, se dyshimi dhe frika që u treguan për zgjedhjen e Lincoln-it si president ishin vetëm pretekste.

Fakti është se disa nga udhëheqësit politikë të Jugut thoshin shpesh herë se “ne do të kemi më shumë përfitime duke qenë jashtë Bashkimit Federal, se sa duke qenë brenda tij”. Dhe disa të tjerë thoshin se “ne i kemi duruar për një kohë të gjatë ofendimet e Veriut”. Që të gjitha këto tregojnë se shkëputja e shteteve nuk ishte një gjë e çastit, por një çështje që ziente prej shumë kohësh.

Përveç kësaj, me gjithë se skllavëria ishte pika kryesore që provokoi krizën, përsëri nuk ishte

## XHEVAT KALLAJXHI

ajo pika e vetme. Kishte edhe pika të tjera që e shkaktuan shkëputjen e shteteve. Mbi të gjitha, Jugu nuk pranonte që Veriu të monopolizonte fuqinë e qeverisë federale. Qysh prej shumë vjetësh Jugu po shqetësoheshin kurdoherë më tepër nga fuqia që fitonte vazhdimisht Veriu, qoftë duke u shtuar numri i popullsisë së tij, qoftë duke u shtuar numri i anëtarëve të Bashkimit Federal me shtete që nuk kishin skllëvër.

Jugu, përveç traditës, kishte edhe një sistem ekonomik të tij të veçantë. Prandaj, për të mbrojtur këtë sistem, si edhe interesa të ndryshme, shtetet e tij, kur gjetën rastin, u shkëputën nga Bashkimi Federal. Qysh prej shumë kohësh ato shtete ankoheshin se ishin vënë nën një ligj që i detyronte të blenin nga fabrikantët e Veriut mallra të cilat mund t'i siguronin, me çmime më të lira, nga fabrikat e Evropës. Për veç kësaj, qysh në vitin 1832 South Carolina bëri një orvajtje që të shkëputesh nga Bashkimi Federal, duke gjetur si pretekst tarifat e mëdha doganore të Qeverisë Federale.


Kjo ishte gjendja kur Lincoln-i mori në dorëzim kryesinë e Republikës. Dhe ishte e qartë se lufta më e madhe bëhesh kundër atij vetë, të cilin njerëzit e Jugut e thërrisnin "presidenti i zi". Me gjithë këtë, ai frymëzohej nga një shpirt bujar dhe nga një mirëkuptim i

## LINCOLN

qartë. Në kundërshtim me shumë të tjerë, ai nuk ushqente asnjë urrejtje kundër njerëzve të Jugut. E kuptonte gjendjen e vështirë të tyre dhe i vinte keq për 'ta. Thoshte shpesh herë se "ata janë miqtë tanë të vjetër dhe kundërshtarët tanë të sotëm".

Politika e Lincoln-it ndaj Jugut ishte e vendosur, por njëkohësisht e matur. Ai ishte kundër përhapjes së skllavërisë në shtete ku nuk ekzistonte. Ai kërkonte gjithashtu që sistemi i skllavërisë të zhdukej me ngadalë dhe të zotërit e skllavëve të shpërbleheshin. Për qëllimi i tij kryesor ishte shpëtimi i Bashkimit të Kombit. Në këtë pikë qëndronte krejt i patundur. Dhe në një rast Lincoln-i deklaroi këto: "Qëllimi im kryesor është të shpëtoj Bashkimin e Kombit. Sikur të mundja ta shpëtoja këtë Bashkim, pa liruuar asnjë skllav, do ta bëja; dhe sikur të mundja ta shpëtoja vetëm duke liruuar një pjesë të skllavëve, dhe duke lënë të tjerët, siç janë, përsëri do ta bëja".

XHEVAT KALLAJXHI



Gjenerali Robert E. Lee



Gjenerali Ulysses S. Grant



## LINCOLN

### LUFTA CIVILE

Lincoln-i, në fjalimin që mbajti përpara Kongresit ditën që u betua si president, theksoi ndër të tjera, këto: "...Atyre që janë të pakënaqur u them: në duart tuaja, dhe jo në të miat, qëndron vendimi i rrezikshëm i një lufte civile. Qeveria nuk do t'ju sulmojë, në qoftë se nuk do ta sulmoni". Dhe ata e sulmuan. Trupat e Jugut bombarduan, më 22 prill 1861, kështjellën e një njisije ushtarake të Qeverisë Federale, "Fort Sumter", afër qytetit Charleston të Shtetit South Carolina. Pas dy ditësh, më 14 prill, kur kështjella u bë gërmadhë, komandanti i saj, majori Robert Anderson, vendosi ta braktisë. Atëherë në "Fort Sumter" u ul nga shtiza flamuri i Shteteve të Bashkuara dhe në vend të tij u ngrit flamuri i Konfederatës. Kjo ngjarje ndezi shkëndijën e një lufte civile nga më të tmerrshmet që njeh historia e botës.

Më 15 prill Lincoln-i kërkoi mbajtjen e një mbledhjeje të jashtëzakonshme të Kongresit në muajin korrik dhe bëri thirrje për 75.000 vullnetarë. Në këtë mënyrë, barra e Lincoln-it po bëhesh gjithnjë e më e rëndë. Në Washington

## XHEVAT KALLAJXHI

shumë nëpunës të administratës shtetërore ishin të lidhur me Jugun ose kishin simpati për Jugun, gjë e cila i vështirësonte veprimet e Qeverisë Federale. Por bombardimi i kështjellës “Fort Sumter”, domethënë sulmi kundër flamurit të Shteteve të Bashkuara, e bashkoi të gjithë Veriun rreth presidentit. Ai sulm dhe rast gjithashtu që të viheshin dakord edhe partitë politike. Dy ish presidentë demokratë, Pierce dhe Buchanan, u shprehën në favor të Lincoln-it. Senatori Douglas shfaqti besnikërinë ndaj Presidentit dhe deklaroi këto: “Në këtë luftë nuk mund të ketë njerës të pa-anshëm: ka ose patriotë, ose tradhëtorë”.

Pas kësaj ngjarje u bashkuan me Konfederatën edhe këta katër shtete të tjerë: Virginia, North Carolina, Tennessee dhe Arkansas<sup>1</sup>. Dhe kryeqyteti i Konfederatës u transferua menjëherë nga Montgomery i Alabamas në Richmond të Virginias. Shkëputja e Virginia-s nga gjiri i Bashkimit Federal e vështirësoi shumë gjendjen e Qeverisë federale. Jo vetëm se kufiri midis Bashkimit Federal dhe Konfederatës u soll në lumin Potomac, që ndan kryeqytetin Washington me Shtetin Virginia, por edhe sepse Gjenerali Lee, të cilin Lincoln-i mendonte ta emëronte si kryekomandant të trupave federale, shkoi në anën

---

<sup>1</sup> Atëherë ndodheshin edhe shtete të tjera që kishin sklllevër, por nuk u ndanë nga gjiri i Bashkimit Federal.

## LINCOLN

tjetër. Lincoln-i vetë, në bazë të Kushtetutës, ishte komandanti suprem i të gjitha fuqive ushtarake të Bashkimit Federal.

Gjenerali Lee ishte një njeri me ndjenja fisnike dhe nuk e përkrahte sistemin e skllavërisë. Ai kishte liruuar edhe skllavërit e tij. Ai nuk e pëlqente gjithashtu as shkëputjen e shteteve nga gjiri i Bashkimit të Kombit, por kishte lindur në Virginia dhe nuk mund t'i kthente armët kundër vendit të vet. Në lidhje me këtë pikë, ai shkroi këto: “Unë nuk mund të shkoja kundër vendit tim të lindjes, kundër bijve të mi, kundër vatrës sime”.

Në fillim Gjenerali Lee kujtoi se nuk do ta thërrisnin që të luftonte kundër Bashkimit Federal, por kur i ofruan komandën e ushtrisë së Virginia-s, ai nuk mund ta refuzonte dot. Më vonë Gjenerali Lee - i cili ishte një figurë ushtarake e radhës së parë në kohën e tij - u emërua kryekomandanti plak i fuqive federale. Gjenerali Winfield Scott, tha këto fjalë: “Humbja e Gjeneralit Robert Lee është për ne më e rëndë se humbja e 200.000 ushtarëve”.

Bashkë me Gjeneralin Lee shkuan nga ana e Konfederatës edhe një numër i madh oficerësh nga më të zgjedhurit. Asikohe oficerat më të mirë ishin përgjithësisht prej viseve të Jugut. Djem të familjes aristokrate, që kishin një traditë fisnikërie dhe kalorësie, ndiqnin zakonisht

## XHEVAT KALLAJXHI

karrierën ushtarake. Për këtë arsye Jugu, me gjithë se numri i popullsisë së tij ishte shumë më i vogël se numri i popullsisë së veriut, kishte atëherë ushtarët dhe oficerët më të mirë.

Me hyrjen e Virginia-s nën flamurin e Konfederatës, gjendja në Washington u trondit. Shumë nga banorët filluan të largohen dhe të shkojnë në vise të tjera më të sigurta. Edhe qeveria u shqetësua: priste nga njeri çast tek tjetri që fuqitë e Jugut të kapërcenin lumin Potomac dhe të sulmonin Kryeqytetin e Shteteve të Bashkuara. Por në radhët e vullnetarëve, që vinin vazhdimisht nga vendet e ndryshme të veriut, entuziazmi ishte i madh. Duke marshuar në rrugët e Washingtonit ata thërrisnin “në Richmond” dhe këndonin një këngë lavdie në kujtim të John Brown-it.

Por njeriu që vepronte me gjakftohtësi ishte Lincoln-i, i cili - si president - drejtonte anijen e Shteteve të Bashkuara nëpërmes dallgëve dhe furtunave të mëdha e të tmerrshme. Dhe kur u mblodh kongresi, Lincoln-i u vesh me fuqira të jashtëzakonshme, ashtu siç e kërkonte gjendja e luftës në të cilën ndodhesh kombi. Dhe me gjithë se problemet, që përballonte Lincoln-i, ishin të rënda e të koklavitura, ai diti të veprojë me zotësi në të gjitha fushat.

Lincoln-i mori vendime për jetë e për vdekje;

## LINCOLN

përballoi kritika të shumta e të ndryshme; spastroi zyrat e administratës nga nëpunës të dyshimtë; u përpoq të vejë disiplinë dhe të sjellë harmoni ndërmjet gjeneralëve ambiciozë; bëri shpesh herë ndryshime në radhët e komandantëve dhe zyrtarëve të lartë civilë; hartoi vetë në disa raste plane strategjike për luftën; vizitoi qendrat ushtarake në ballin e luftimeve; nxiti dhe u dha zemër ushtarëve për sulme, etj. Veproi sipas rasteve: herë me guxim dhe herë me maturi; herë me grusht dhe herë me të butë. Mbrojti me vetëmohim interesat e kombit, duke mos cenuar parimet demokratike.

Lufta bëhej e rreptë dhe shkonte herë në favor të Jugut, herë në favor të Veriut. Një nga luftërat e mëdha, në të cilën u shkatërruan ushtritë federale, ishte ajo që njihet me emrin “Lufta e Bull Run’-it. Kjo disfatë shkaktoi një dëshpërim të madh në Kongres dhe në të gjitha vendet e Veriut. Kjo luftë u bë kur ushtritë federale shkuan të sulmojnë Richmond-in, kryeqytetin e Konfederatës, në Virginia. Mirëpo sulmi u kthye në disfatë dhe shumë ushtarë të Qeverisë Federale mbushën rrugët e Washingtonit, të dërmuar e të rraskapitur. Dhe sikur ushtritë e Jugut t’i kishin ndjekur trupat e prishura të veriut, mund ta kishin zaptuar Washingtonin me lehtësi. Por nuk i ndoqën. Duket se u hutuan nga

## XHEVAT KALLAJXHI

fitorja. Si përfundim i kësaj disfate, Lincoln-i u shtrëngua të zëvendësojë komandantin.

Me gjithë këtë, edhe në çastet më të vështira, Lincoln-i nuk e humbi kurrë as gjakftohtësinë, as ndjenjën e shakasë. Pas disfatës që pësoi ushtria federale në Bull Run, një grua nga të veriut, që kishte frikë se mos e fitonte luftën Jugu, i bëri Lincoln-it këtë pyetje: “Zoti President, a është vallë Perëndia nga ana jonë në këtë luftë?” Lincoln-i iu përgjegy me këto fjalë: “Zonjë, ajo që më shqetëson mua është a jemi ne nga ana e Perëndisë, dhe jo a është perëndia nga ana jonë, se unë e di që Perëndia është kurdoherë nga ana e drejtë”.

Një tjetër cilësi e rrallë e Lincoln-it ishte kjo: sa më të rënda të ishin problemet dhe sa më të vështira të ishin çastet, aq më i patundur ishte në mendimet dhe vendimet e tija. Ai ishte ndërgjegjës i detyrës që kishte marrë përsipër dhe nuk kursehesh aspak që ta plotësonte atë sa më mirë, duke mos harruar përgjegjësinë ndaj atyre që e kishin zgjedhur. Lincoln-i thoshte se “asnjë njeri nuk ka të drejtë të qeverisë një njeri tjetër pa pëlqimin e tij”. Thoshte gjithashtu se “fuqia e një udhëheqësi duhet të mbështetet në dashurinë e popullit”.

Pas disfatës së Bull Run-it, ushtritë e Jugut muarën guxim dhe u përgatitën të zaptojnë

## LINCOLN

Maryland-in. Mirëpo trupat federale, të komanduara nga Gjenerali George Meclellan, i ndalën në Antietam dhe u shkaktuan dëme të mëdha. Me këtë fitore, që u korr më 17 shtator 1862, Gjenerali McClellan bëri të harrohet disfata që kishte pësuar më parë në Chickahominy. Gjenerali Meclellan ishte i ri dhe ambicioz dhe, për këtë arsye, i kishin ngjitur mbiemrin “Napoleoni i Vogël”.

Në mbrëmje të asaj dite, Lincoln-i i dërgoi Gjeneralit McClellan këtë mesazh: “Perëndia ju bekoftë ju dhe të gjithë ata që janë me ju. Në keni mundësi, ndiqeni dhe shkatërrojeni ushtrinë rebele”. Por ai nuk e ndoqi. Me gjithë këtë, beteja e fituar në Antietam - ku u ndal sulmi i ushtrive të Jugut - e përmirësoi deridiku gjendjen ushtarake të Veriut. Njëkohësisht ajo fitore forcoi edhe pozitën e Lincoln-it.

Më 22 shtator 1862 Lincoln-i mbledhi anëtarët e kabinetit dhe u lexoi “Deklaratën e Emancipimit” të shkëputur në shtetet që ishin shkëputur nga gjiri i Bashkimit Federal. Këtë deklaratë ai e përgatiti vetë, pa pyetur Kongresin. Si komandant suprem i fuqive ushtarake, Lincoln-i kishte të drejtë ta bënte një gjë të tillë-për ato vende që kishin ngritur krye kundër Qeverisë Federale dhe konsideroheshin

## XHEVAT KALLAJXHI

si armike. Por për arsye të ndryshme, shpallja zyrtarisht e kësaj mase u shty për më tutje. Me një shpallje paraprake u njoftua se më 1 Janar 1863 të gjithë skllevërit në vendet e shkëputura do të liroheshin përgjithmonë dhe se Qeveria Federale do të njihte lirinë e tyre.

Më 1 Janar Lincoln-i nënshkroi deklaratën definitive. Me atë rast, ai tha këto: “Nuk kam qenë kurrë kaq i sigurt, se kam vepruar siç duhet, sa jam tani që po nënshkruaj këtë dokument”. Kjo deklaratë bëri një përshtypje të keqe në jugë, ku - pas disa ditësh - presidenti Jefferson Davis, me një mesazh që i drejtoi Kongresit të konfederatës, shprehu urrejtjen më të madhe ndaj Lincoln-it. Por në viset e Veriut dhe në shumë vende të botës së jashtme bëri shumë përshtypje të mirë. Dhe emri i Lincoln-it kaloi në histori si “Emancipatori i Math”.

Me kohë, ushtria e Veriut u stërvit dhe u organizua mirë. Njëkohësisht u shquan edhe disa gjeneralë, si Ulysses Grant, William Sherman, Philip Sheridan etj. Veçanërisht Grant-i u tregua në një nivel me Gjeneralin Robert Lee. Granti kishte një taktikë të tij të veçantë dhe delte pothuaj kurdoherë i fituar në luftime. Këtë sekret të suksesit të Grant-it nuk mund ta shpjegonin dot as edhe oficerët e shtatmadhorisë së tij.

Përveç kësaj, Grant-i ishte i matur në qëndri-



## LINCOLN

min e tij dhe kishte ndjenja njerëzore. Në shkurt të vitit 1862, kur zaptoi Fort Dearborn, në një shpallje që i drejtoi popullit tha këto: “Unë vij tek ju jo si armik, por si bashkatdhetar dhe mik. Mendimet e juaja nuk më interesojnë. Unë do të jem i rreptë vetëm me rebelët e armatosur dhe me ata që do t’i përkrahin”. Kjo deklaratë ishte krejt e kundërta e atyre që kishin bërë disa gjeneralë të tjerë të ushtrisë federale, të cilët vepronin arbitrarisht dhe i përdornin keq popullsitë e viseve që zaptounin. Dhe shpesh herë Lincoln-i detyrohej të ndërhynte për të ndrequr gabimet e tyre.

Për shkak të këtyre sukseseve të Grant-it, disa gjeneralë ishin bërë ziliqarë dhe, sa herë gjenin ndonjë rast, përpiqeshin ta diskreditonin. Kur Grant-i fitoi betejën në vendin Shiloh, duke pësuar humbje të rënda, armiqtë e tij i kërkuan Lincoln-it që ta hiqte nga komanda. Mirëpo ai u përgjegj kështu: “Unë kam nevojë të madhe për të; është një njeri që lufton”. Dhe kur i thanë se Grant-i ishte gjithnjë i dehur, Lincoln-i u përgjegj me këto fjalë: “Në qoftë se Grant-i pi, atëherë desha të dija se çfarë pi, sepse do t’u dërgoja me gjithë dëshirë disa fuçi me raki të njëllajtë gjeneralëve të tjerë”. Dhe më 1863 Lincoln-i ngarkoi Granti komandën e armatës së Mississippi-t.

## XHEVAT KALLAJXHI

Më 1863 ranë në duart e ushtrive të Veriut Memphis dhe New Orleans. Këto ishin dy prej tri qendrave me rëndësi që siguronin kalimin e furnizimeve midis juglindjes dhe jugperëndimit. Pas humbjes së këtyre, e vetmja qendër që i mbetesh Jugut për furnizime ishte Vicksburg-u. Po të humbiste edhe këtë qendër, atëherë Jugu do të shkëputesh krejt nga krahinat e tija të pjesës perëndimore. Ushtritë e komanduara nga Gjenerali Grant dhe Gjenerali Sherman e rrethuan edhe qytetin Viksburg, i cili qëndroi dhe kundërshtoi me guxim disa muaj me radhë, por më në fund, më 3 korrik 1863, ngriti flamurin e bardhë. Gjenerali Grant zuri 31.000 robër, 172 topa, 50.000 pushkë dhe pajisje ushtarake të ndryshme. Ndërkohë Granti u dha urdhër trupave të tij që të silleshin me fisnikëri ndaj ushtarëve të mundur. Dhe që të gjithë ushtarët robër, që ishin prej krahinave të jugperëndimit, i la të lirë të shkojnë në shtëpitë e tyre, pasi dhanë fjalën se nuk do të merrnin më armët. Zaptimi i qytetit Vicksburg ishte një fitore e madhe dhe i siguroi Veriut kontrollin e plotë mbi Mississippi-n. me këtë rast Lincoln-i i dërgoi një letër Gjeneralit Grant, në të cilën i tha, ndër të tjera, këto:

“I dashuri Gjeneral: Nuk kam pasur akoma rastin që t’ju takoj dhe ju shkruaj këto dy

## LINCOLN

radhë për t'ju thënë se jam shumë mirënjohës për shërbimet që i keni sjellë vendit tonë. Kam shpresuar gjithnjë, qysh prej kohës që filluat t'i afroheni qytetit Vicksburg, se sukse si përfundimtar do të kurorëzonte ndërmarrjen tuaj...”

Kur Vicksburg-u ishte i rrethuar nga ushtritë e veriut, trupat e Gjeneralit Lee sulmuan Shtetin Pennsylvania. Gjenerali Lee kishte nja 75.000 ushtarë. Kundër tij Lincoln-i dërgoi Gjeneralin George Meade në krye të 90.000 ushtarëve. Këto dy ushtri u ndeshën në Gettysburg. Gjenerali Lee, me gjithë se kishte mundësi t'u shmangej luftimeve, qëndroi dhe tha këto: “Këtë radhë do t'u tregojmë ushtarëve të Veriut se si dimë të luftojmë ne”.

Në brigjet e Gettysburg-ut u zhvillua një nga betejat më të përgjakshme të luftës civile. Mbetën afro 50.000 ushtarë të vrarë e të plagosur nga të dy anët. Luftoi vëllai kundër vëllait me një ashpërsi të madhe. Luftimet filluan më 1 dhe mbaruan më 3 korrik 1863. Për shkak të humbjeve të mëdha ditën e katërt Gjenerali Lee urdhëroi tërheqjen e ushtrive të tij në një kohë kur binte një shi i madh. Kështu, më 4 korrik, ditën e pavarësisë së Shteteve të Bashkuara, Gjenerali Meade i dërgoi Presidentit Lincoln

## XHEVAT KALLAJXHI

këtë mesazh: “Beteja e Gettysburg-ut u fitua”.

Gjenerali Meade, emri i të cilit është bërë i pavdekshëm në historinë e betejës së Gettysburg-ut, kishte mundësi t’i ndiqte dhe t’i shkatërronte ushtritë e Jugut, por nuk i ndoqi. U tregua i rezervuar. Sikur t’i kishte ndjekur, ndofta lufta mund të kishte marrë fund qysh atëherë. Vetë Lincoln-i tha në atë rast këto fjalë: “Ushtria jonë e kishte në dorë të saj që t’i jepte fund kësaj lufte, por nuk diti të përfitojë nga ky rast i mirë”. Me gjithë këtë, shumë historianë thanë se beteja e Gettysburg-ut shënoi një kthesë me rëndësi për fatin e luftës, në favor të Veriut.



**Presidenti Lincoln duke mbajtur fjalimin historik në  
Gettysburg**

## LINCOLN

### FJALIMI I FAMSHËM I GETTYSBURG-UT

Në fushat e Gettysburg-ut u varrosën shumë nga ushtarët e vrarë të Jugut e të veriut. Këta bij të një Mëme, të ndarë e të armiqësuar në jetë, u bashkuan dhe u vëllazëruan përsëri në vdekje. Disa muaj më vonë, Qeveria Federale e caktoi një pjesë të atyre fushave si “Vorreza Kombëtare”. Dhe më 19 Nëntor 1863, Lincoln-i, së bashku me shumë zyrtarë të lartë civilë dhe ushtarakë, mori pjesë në ceremoninë e kushtimit të kësaj Vorreze si edhe në nderimin e kujtimit të atyre që ranë heroikisht në betejën e Gettysburg-ut.

Folësi zyrtar i ditës ishte Edward Everett-i, një orator i famshëm i Amerikës, i lindur në Boston. Ai foli nja dy orë me radhë dhe preku shumë pika të ndryshme. Fjalimi i tij ishte ashtu siç pritesh dhe u duartrokit me nxehtësi nga njerëzit e shumtë që kishin marrë pjesë në atë ceremoni përkujtimi. Si mbaroi Everett-i, u ngrit Presidenti Lincoln dhe u afrua në buzën e tribunës që ishte ngrehur posaçërisht për personalitetet e ndryshme.

Lincoln-i ishte më i gjatë nga të gjithë dhe fytyra e tij dukej atë ditë më e pikëlluar se

kurdoherë tjetër. Pasi hodhi një vështrim plot melankoli rreth-e-rrotull, nxori nga xhepi një copë kartë dhe me zë të ulët, por të qartë, filloi të lexojë:

“Tetëdhjetë e shtatë vjet më parë, prindët tanë krijuan në këtë kontinent një komb të ri, të mbështetur në liri dhe të kushtuar në parimin që të gjithë njerëzit lindin të barabartë. Tani ne i kemi hyrë një lufte civile të madhe për të provuar në se ky komb, ose çdo komb tjetër i krijuar me të njëjtat parime, mund të ketë një jetë të gjatë. Ne po takohemi në një fushë beteje të madhe të kësaj lufte. Jemi mbledhur për të kushtuar një pjesë të kësaj fushe, si vend çlodhjeje të përjetshme, për ata që dhanë jetën e tyre këtu, që ky komb të mund të jetojë. Kjo që bëjmë ne është një gjë me vend dhe e përshtatshme. Por, në një kuptim më të gjerë, ne nuk mund ta kushtojmë, nuk mund ta bekojmë, nuk mund ta shenjtërojmë këtë truall. Të gjithë heronjtë, të gjallë e të vdekur, që luftuan këtu, e kanë shenjtëruar aq shumë sa fuqia jonë e varfër nuk mund të shtojë ose të pakësojë asgjë. Bota do ta verë re fare pak dhe nuk do ta mbajë mend për shumë kohë atë që bëjmë ne këtu, por nuk do ta harrojë kurrë atë që bënë ata trima në këtë vend. Na takon neve të gjallëve që t'i

## LINCOLN

kushtohemi veprës së pambaruar të cilën ata, që luftuan këtu, e përparuan aq fisnikërisht gjer në këtë shkallë. Na takon neve që t'i kushtohemi detyrës së madhe që na qëndron përpara - që nga këta të vdekur të nderuar të frymëzohemi për një kushtim më të madh ndaj kauzës për të cilën ata dhanë provën e plotë të besnikërisë e të therorisë - që të vendosim këtu lartësisht se këta të vdekur nuk kanë vdekur më të kotë - që ky komb, ndënë Perëndinë, do të lindë përsëri në liri - dhe që qeveria e popullit, prej popullit, për popullin nuk do të zhduket nga faqja e dheut”.

Kur Lincoln-i e mbaroi këtë fjalim historik, një heshtje e madhe e mbuloi krejt gjindjen: nuk u dëgjua asnjë zë dhe asnjë duartrokitje. Lincoln-i u ul përsëri në fron, duke menduar se fjalimi i tij nuk bëri përshtypje të mirë. Përkundrazi fjalimi kishte hyrë thellë në zemrat e të gjithëve. Ishte një fjalim njerëzor, prekës, plot dhemshuri. Shkrimtarja e dëgjuar amerikane, Mary Andrews, thotë se fjalimi i Lincoln-it në Gettysburg nuk u duartrokit sepse “do të ishte sikur njeriu të brohoriste një lutje drejtuar Perëndisë: do të ishte një sakrilegj”.

Fjalimi i Lincoln-it, kur u botua të nesërmen në gazetata, bëri bujë të madhe në të gjitha anët e Shteteve të Bashkuara. Të gjithë Amerikanët

## XHEVAT KALLAJXHI

e morën vesh rëndësinë dhe kuptimin e thellë të këtij fjalimi, i cili përmendet si një familjet më të famshme në histori. Por ky fjalim bëri bujë të madhe edhe në vendet e ndryshme të botës dhe u përkthye në shumë gjuhë të huaja.

Me këtë fjalim vihet në dukje madhështia shpirtërore e Lincoln-it dhe me fjalët “qeveria e popullit, prej popullit, për popullin” shprehet kuptimi i vërtetë i demokracisë Amerikane.



## LINCOLN

### GUXIMI I LINCOLN-IT

Pas George Washingtonit, asnjë president tjetër i Amerikës nuk përballoi aq përgjegjësi dhe probleme të mëdha sa Lincoln-i. I pari hodhi themelet e kombit të ri amerikan. I dyti siguroi bashkimin e përjetshëm të këtij kombi. Lincoln-i ishte president në një kohë shumë kritike dhe përgjegjësia më e madhe rëndonte mbi të. Prandaj ai interesohej për çdo gjë: për çështje ushtarake, politike, ekonomike, shoqërore, etj.

Lincoln-i vinte nga radhët e popullit dhe ishte krenar për këtë gjë. Ai e konsideronte popullin si shtyllën më të fortë për ekzistencën e kombit. Prandaj përpiqej me gjithë fuqi për lartësimin e popullit, për mirëqenien e popullit, për mbrojtjen e të drejtave të popullit. Ai donte veçanërisht njerëzit e thjeshtë, dhe thoshte shpesh herë se “edhe Perëndia i ka dashur fort njerëzit e thjeshtë, prandaj ka bërë kaq shumë asillojesh”.

Shtëpia e Bardhë ishte gjithnjë e hapët për çdo njeri. Dhe të shumtë ishin ata që shkonin në zyrën e Presidentit. Ishin njerëz që kërkonin

## XHEVAT KALLAJXHI

punë; ishin klerikë që interesoheshin për çështje fetare; ishin udhëheqës të punëtorisë që parashtronin problemet e tyre; ishin nëna që kishin djemtë në luftë dhe kërkonin lajme mbi fatin e tyre; ishin veteranë të luftërave të mëparshme që kërkonin shpërblime. Lincoln-i i priste në çdo orë dhe i dëgjonte me kujdes. “Këta njerëz”, thoshte ai, “nuk kërkojnë shumë gjëra; kënaqen me pak dhe unë bëj ç’është e mundur që t’u a plotësoj kërkesat e tyre”.

Përveç kësaj, Lincoln-i vizitonte shpesh herë të plagosurit në spitale, si ata të ushtrisë së Bashkimit Federal, si ata të Konfederatës, që ishin zënë robër. Qëndronte pranë tyre dhe u thoshte nga një fjalë të mirë. Bile në disa raste ai ishte kujdesur t’i dërgonte vetë letrat e disa ushtarëve të plagosur të Konfederatës në te afërmit e tyre.

Lincoln-i ishte gjithnjë i trishtuar. I qante zemra për mynxyrën e madhe që kishte mbuluar kombin. Në atë fatkeqësi të përgjithshme, shpirti i tij ishte plagosur edhe nga një hidhërim familjar: më 20 shkurt 1862 i vdiq në Washington, në moshën 11 vjeçare, i biri William Wallace. Kjo vdekje tronditi nervat e nënës së mjerë, Mary.

Prandaj Lincoln-i, me gjithë se ishte shumë i zënë me punë të ndryshme duke ndjerë hidhërimin e thellë të shpirtrave të prindërve, grave dhe fëmijëve që kishin humbur të dashurit

## LINCOLN

e tyre në fushat e betejës, dërgoi gjatë luftës shumë letra ngushëllimi. Bile disa nga këto letra ishin tepër mallëngjyese. Një nga këto letra, qe përmendet në histori, është kjo:

“E dashura Zonja Bixby: Në dosjet e Ministrisë së Luftës unë pashë një deklaratë të Adjutantit të Përgjithshëm të Massachusetts, me të cilën njoftohet se ju jeni nëna e pesë djemve që ranë plot lavdi në fushën e betejës. Unë e kuptoj se çdo fjalë e ime, për të pakësuar hidhërimin tuaj për këtë humbje kaq të madhe, është e dobët dhe e padobishme. Por unë nuk mund të rri pa ju shprehur ngushëllimin që buron nga mirënjohja e Republikës, për shpëtimin e së cilës ata falën jetën. Unë lutem që Ati ynë në qiell të mundë të pakësojë pikëllimin e shpirtit tuaj të zhuritur, dhe të lërë tek ju vetëm kujtimin e ëmbël të dashurisë për ata që humbën jetën, dhe ju duhet të ndjeheni tepër krenare që bërë një sakrificë kaq të madhe në altarin e lirisë”.

Lincoln-i e përdori shumë penën në jetën e tij. Nuk shkroi ndonjë libër, por la pas tij - në formë fjalimesh, letrash dhe anekdotash etj. - më tepër se një milion fjalë, pothuajse më shumë se fjalët që përmbajnë të gjitha dramat dhe sonetet e Shekspirit. Disa nga fjalimet e Lincoln-it përmenden edhe sot për vlerën e tyre letrare dhe historike. Veçanërisht fjalimi

## XHEVAT KALLAJXHI

i Gettysburg-ut cilësohet si një kryevepër në gjuhën anglishte.

Lincoln-i nëpërmjet studimeve të bëra vetë, kishte fituar një njohuri të thellë në shumë fusha. Për këtë arsye, ai foli me kompetencë për shumë probleme: politike, ushtarake, ekonomike, shkencore, filozofike, letrare, fetare etj. Ai bëri fjalë edhe për shpikje shkencore. Bile edhe Lincoln-i vetë mori më 1849 një patentë për një shpikje të bërë prej tij, e cila kishte lidhje me një përmirësim në strukturën e anijeve që lundrojnë me fuqinë e avullit.

Lincoln-i thoshte shpesh herë se “historia ime është historia e një të vobekti”. Dhe me gjithë se u ngjit në majën më të lartë të pozitës shtetërore, ai jo vetëm nuk e harroi kurrë të kaluarën e tij, por, përkundrazi, e përmendte me mburrje. Përveç kësaj, ai e tregonte veten e tij si një shembull inkurajimi edhe për shumë njerëz të tjerë të vobektë. Në një fjalim që mbajti njëherë përpara një regjimenti ushtarësh, ai tha:

“...Unë jam një provë e gjallë se çdo njeri, duke përfituar nga sistemi i lirë i qeverimit tonë, dhe duke treguar një zotësi, mund të arrijë të bëhet president i Shteteve të Bashkuara ashtu siç u bëra edhe unë...”

Asnjë president tjetër nuk punoi aq fort me duart e tija, në kohën e miturisë e të rinisë, për

## LINCOLN

të jetuar, siç punoi Lincoln-i. Prandaj ai e dinte vlerën e punës dhe kishte respekt për punëtorët. Dhe në një mesazh që i drejtoi Kongresit më 2 dhjetor 1861, ndër të tjera, ai tha:

“Puna është e para dhe qëndron mbi kapitalin. Kapitali është vetëm fryti i punës. Kapitali nuk do të mund të ekzistonte kurrë po të mos ekzistonte më parë puna. Puna qëndron mbi kapitalin dhe meriton një konsideratë të madhe...”

Dhe në një rast tjetër, Lincoln-i tha këto: “Çdo gjë që i shërben punëtorit, i shërben kombit. Çdo gjë që dëmton punëtorin, dëmton kombin... Çdo qeveri duhet t’i sigurojë çdo punëtori një pjesë të përshtatshme nga sendet që prodhon ai...”

Ishte pikërisht në atë kohë që Horace Greeley, kryeredaktori i gazetës “The New York Tribune”, shkroi për Lincoln-in këto: “Lincoln-i është një njeri i popullit, një kampion i punëtorëve të lirë dhe një mbrojtës i sindikatave të punëtorisë ...”

Me gjithë këtë, kundërshtarët e quanin Lincoln-in “demagog” dhe “nxitës të turbuar të turmave”. Por Lincoln-it nuk i bënin përshtypje këto akuza. Ai e kishte ndërgjegjen të qetë dhe ishte i vendosur në parimet dhe pikëpamjet e tij. Bile ndërsa mbronte punëtorët, në të njëjtën kohë ai mbronte edhe kapitalin. Lincoln-i dëshi-

ronte që midis këtyre dy fuqive të ekzistonte bashkëpunim dhe harmoni. Në lidhje me këtë pikë, ai deklaroi këto:

“Kapitali ka të drejtat e tija, të cilat duhet të mbrohen si të gjitha të drejtat e tjera... Pasuria është e dëshiruar. Është një gjë e mirë në këtë botë... Duhet të jenë disa të pasur që të tregojnë se mund të bëhen të pasur edhe njerëz të tjerë, dhe të nxitin zhvillimin e industrive dhe ndërmarrjeve private... Duhet të mos lejohet që një njeri pa shtëpi të rrëzojë shtëpinë e një tjetri, por lypset të punojë që të ndërtojë edhe ai një shtëpi për vete...”

Këto mendime të qarta e të urta të Lincoln-it janë bërë sot një realitet në shoqërinë amerikane, në të cilën punëtorët dhe kapitalistët bashkëpunojnë në harmoni me njëri-tjetrin dhe pjesëtojnë frutat e djersës e të kapitalit me një kriter të drejtë.

Një tjetër cilësi e Lincoln-it ishte guximi i tij i madh. Gjatë kohës së luftës civile Washingtoni ishte një qytet i mbushur me njerëz të dyshimtë; me njerëz që ushqenin simpati për Konfederatën dhe urrenin Qeverinë Federale, sidomos Lincoln-in. Me gjithë këtë, Lincoln-i nuk druhej. Delte shpesh herë vetëm, ose i shoqëruar nga ndonjë mik, për të bërë shëtitje ditën ose për të shkuar në teatër natën.

## LINCOLN

Bile Lincoln-i e dinte mirë se ekzistonte edhe një shoqëri e fshehtë, që përpiqej për vrasjen e tij. Por ai nuk frikësohej aspak dhe njerëzit e rrethit të tij çuditëshin për këtë guxim të madh të Lincoln-it. Atyre që e këshillonin që të ruhet e të merrte masa mbrojtëse, ai i u përgjigjesh me këto fjalë: “Më tepër se një herë nuk mund të vdes! Dhe në qoftë se do të vritem, atëherë nuk do të vdes kurrë”.

Në lidhje me këtë pikë, Noah Brooks, i cili ishte asokohe në Washington një nga korrespondentët e shquar të luftës, dhe një nga miqtë e ngushtë të Presidentit, në një libër që ka botuar më 1896 me titullin “Washingtoni në kohën e Lincoln-it”, tregon këtë episod:

“...Një natë, kur Lincoln-i dhe unë po ktheheshim nga teatri në shtëpinë e Bardhë, mua m’u duk sikur pashë një njeri që përgjonte prapa një peme. Për pak më ngriu gjaku. Me gjithë këtë, kaluam pa mësuar gjë. Por nuk m’u durua pa i thënë Presidentit se, sipas mendimit tim, hyrja dhe dalja e tij vetëm, pa asnjë mbrojtje, ishte një gjë e rrezikshme”. Lincoln-i qeshi dhe më tha këto fjalë: “Mua më është mbushur mendja qysh prej shumë kohësh se në qoftë se ndokush dëshiron të më vrasë, ai do të më vrasë. Ka mijëra mënyra për ta vrarë një njeri...”.

## LINCOLN-I PËRSËRI PRESIDENT

Viti 1864 ishte viti i zgjedhjeve për president në Shtetet e Bashkuara, pasi periudha e parë e Lincoln-it po merrte fund. Ishte hera e parë që bëheshin zgjedhje të tilla në një kohë kur kombi ndodhej në luftë. Mirëpo Lincoln-i e kishte theksuar shpesh herë se vullneti i popullit duhet të shprehet në çdo rast.

Kuvendi i Partisë republikane u mbledh në qytetin Baltimore në Qershor të vitit 1864 për të caktuar kandidatët për president dhe nën-president. Qysh në votimin e parë kandidat për president u zgjodh Lincoln-i dhe kandidat për nën-president u zgjodh Andrews Johnson. Ky i fundit nuk ishte republikan, por një demokrat që favorizonte vazhdimin e luftës.

Kuvendi i partisë Demokrate u mbledh në Chicago dhe zgjodhi kandidat për president Gjeneralin MacClellan. Në kuvendin e Partisë Demokrate zotëroi ideja që t'i jepesh fund luftës. Por Gjenerali MacClellan njoftoi komitetin drejtues të Partisë se nuk do ta përkrahte aspak këtë ide.

Brenda në katër vjet personaliteti i Lincoln-it



## LINCOLN

ishite forcuar shumë dhe masat popullore ushqenin një simpati të thellë për të. Ato e dinin se Lincoln-i, në çaste të vështira, kishte vepruar me guxim, me drejtësi dhe me ndershmëri në detyrën e tij. Prandaj kishin besim se ai do të vepronte me të njëjtën mënyrë edhe në të ardhmen.

Por jo vetëm masat popullore, por edhe shumë intelektualë kishin shprehur haptazi mendimin e tyre se për atë kohë nuk kishte asnjë njeri tjetër më të përshtatshëm se Lincoln-i për të drejtuar timonin e Qeverisë Federale. Dhe ishte pikërisht në atë rast që Sekretari i Lincoln-it vuri në dukje këto cilësi të tija:

“Lincoln-i është një njeri i rregullt, gjakftohët dhe shumë aktiv. Kujdeset për luftën, për rekrutimin e ushtarëve, për politikën e jashtme dhe për shumë probleme të tjera. Njëkohësisht ai po përgatit edhe planet për rindërtimin e kombit. Ka personalitet dhe e drejton kabinetin e tij me një zotësi të rrallë. Prandaj më është mbudhur mendja, më tepër se kurdoherë tjetër, se interesi i vendit e kërkon që ky të qëndrojë atje ku është, gjer në fund. Nuk ka në krejt kombin një njeri kaq të zotin, kaq fisnik dhe kaq të guximshëm sa Lincoln-i...”

Më 8 nëndor 1864, u bënë zgjedhjet për president në të cilat fitoi përsëri Lincoln-i. Këtë radhë ai mori më shumë vota nga sa mori kur u

## XHEVAT KALLAJXHI

zgjodh për herën e parë. Kombi çmoi jo vetëm cilësitë, por edhe nevojën e qenies së Lincoln-it në krye të Republikës.

Në fillim të vitit 1865 u shënua një tjetër akt me rëndësi në historinë e Shteteve të Bashkuara. Kongresi Amerikan aprovoi shtojcën që iu bë Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara për zhdukjen e skllavërisë në të gjitha anët e Republikës Amerikane. Në librin e Noah Brooks "Washingtoni në kohën e Lincoln-it" përmendet edhe kjo ngjarje, të cilën ai e quan "akti më i madh në dramën e luftës". Autori i këtij libri e përshkruan në këtë mënyrë aprovimin e shtojcës 13 nga ana e Kongresit të Shteteve të Bashkuara:

"Para se të aprovohej shtojca e 13-të, skllavëria mund të ekzistonte, me disa kufizime, në çdo shtet, në bazë të vullnetit të shumicës së banorëve, të shprehur me anën e votës. Shtojca për zhdukjen e skllavërisë u aprovua së pari nga Senati në prill të vitit 1864, me 38 vota në favor dhe 6 kundër. Mirëpo në muajt e mëparshëm kjo shtojcë nuk mundi të aprovohet nga Dhoma e Deputetëve të Kongresit Amerikan me dy të tretat e votave, që ishin të nevojshme. Në janar të vitit 1865 Dhoma e Deputetëve e mori përsëri në shqyrtim këtë shtojcë. Debati vazhdoi shumë ditë. Më në fund, më 31 Janar, shtojca u vu

## LINCOLN

në votë. Në favor të saj votuan 119 deputetë, kundër saj votuan 56 deputetë. Në këtë mënyrë u siguruan më tepër se dy të tretat e votave. Për një çast mbretëroi një heshtje e madhe. Pastaj salla e Dhomës së Deputetëve - galeritë e së cilës ishin të mbushura plot me njerëz - gjëmoi nga brohoritjet dhe duartrokitjet me entuziazëm. Këto duartrokitje zgjatën 10 minuta. Dhe pak më vonë ajri oshtiu nga krisma e topave që u zbrazën jashtë Kapitolit, për të njoftuar se skllavëria kishte marrë fund...”

Të nesërmen më 1 Shkurt, Presidenti Lincoln nënshkroi shtojcën e 13-të, e cila hyri në fuqi më 18 Dhjetor 1865, kur u aprovua nga Legjislaturat e shteteve të ndryshme, ashtu siç parashikohet nga Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara. Me aprovimin definitiv të kësaj shtojce, u kurorëzua me sukses një përpjekje e madhe, dhe për Kombin Amerikan u çel një periudhë e re.

Ceremonia e betimit të Lincoln-it, si president për periudhën e dytë, u bë më 4 Mars 1865. Edhe këtë herë ishin mbledhur shumë njerëz përpara Kongresit. Këtë radhë Lincoln-i u betua përpara kryetarit të ri të gjykatores së lartë së Shteteve të Bashkuara, Salmon Chase, të cilin e kishte emëruar vetë në këtë detyrë. Me këtë rast, Lincoln-i mbajti një fjalim të shkurtër, por prekës, të cilin e përfundoi kështu:

## XHEVAT KALLAJXHI

“Pa urrejtje kundër askujt, me mirëdashje ndaj të gjithëve; duke qëndruar të patundur në të drejtën, ashtu siç na jep mundësi Perëndia ta kuptojmë këtë të drejtë, le të përpiqemi të plotësojmë detyrën tonë, për të shëruar plagët e kombit, për t’u kujdesur për ushtarët, për gratë e veja dhe për fëmijët e tyre jetimë, si edhe për të siguruar një paqe të drejtë e të vazhdueshme midis ne dhe midis gjithë kombeve të botës”.

Me këto fjalë, të cilat hynë thellë në zemrat e të gjithëve, Lincoln-i vuri edhe një herë tjetër në dukje shpirtmadhësinë e tij. Foli me ndjenjat e vërteta të dhëmshurisë së tij për të gjithë, duke qenë krejt i zhveshur nga pasionet dhe zemërimet. Bile në një rast tjetër Lincoln-i tha këto:

“Duhet të heqim dorë nga dëshpërimet dhe zemërimet tona, në qoftë se dëshirojmë harmoninë dhe bashkimin. Ka shumë njerëz, edhe midis miqve të mi të ngushtë, që dëshirojnë të dominojnë shtetet e Jugut dhe të ndërhyjnë për t’u diktuar ligje; që kërkojnë t’i trajtojnë banorët e tyre jo si bashkatdhetarët tanë; që kanë pak respekt për të drejtat e tyre. Këto nuk janë ndjenjat e mia”.

Lufta vëllavrasëse e kishte tronditur shpirtin e Lincoln-it, i cili bënte ç’ishte e mundur që të zbuste zemrat e Amerikanëve, sepse këta - me gjithë se ishin përleshur në një luftë të tmerrshme me njëri-tjetrin - ishin vëllezër dhe

## LINCOLN

pjesëtarë të një vatre. Ai mundohesh të shtronte rrugën për të nesërmen, për t'i vëllazëruar përsëri bijtë e përçarë të kombit. Prandaj, kur një nga bashkëpunëtorët e tij tha se Jefferson Davis, presidenti i Konfederatës, meritonte të vihej në litar, Lincoln-i i kujtoi atij thënien e Ungjillit: “Mos gjykoni të tjerët, në qoftë se dëshironi që të mos ju gjykojnë”.

Gjatë kohës së luftës civile, kryeqytetin Washington e vizituan shumë njerës me rëndësi, amerikanë dhe të huaj. Një nga këta ishte edhe poeti dhe shkrimtari i dëgjuar bostonian, Ralph Waldo Emerson. Ky e kishte përshkruar disa kohë më parë Lincoln-in si njeri të pagdhendur dhe vulgar. Mirëpo kur e pa dhe bisedoi me të, tha se gjeti tek Lincoln-i “një njeri të qartë, të singertë dhe të përgatitur mirë”. Tha gjithashtu se zgjedhja e Lincoln-it si president “ishte një triumf i mençurisë dhe i ndërgjegjes së njerëzve... Rrallë herë ka pasur njerëz që t'i përshtaten gjendjes aq mirë sa i përshtatej Lincoln-i... Vetëm, Washingtoni mund të krahasohet me të”.

Një tjetër poet amerikan, i famshmi Walt Whitman, kur e pa Lincoln-in, tha këto: “Ja një njeri që ka pamjen e një burri të vërtetë”. Dhe në librin e tij të shënimeve shkroi këto fjalë: “Asnjë artist ose piktor nuk ka mundur të verë në dukje siç duhet madhësinë dhe shprehjen e gjallë të fytyrës së këtij njeriu. Për ta bërë një

## XHEVAT KALLAJXHI

gjë të tillë, nevojitet një piktor nga ata të dy ose tre shekujve të kaluar”.

Dhe Marquis Adolphe de Chambrun, diplomati francez në Shtetet e Bashkuara gjatë luftës civile, mbeti i habitur nga personaliteti i Lincoln-it. Ai shkroi se u prek thellësisht nga mençuria, guximi, ndjenjat njerëzore, sjelljet modeste dhe jeta e thjeshtë e këtij pionieri amerikan. “Lincoln-i - shkroi Chambrun-i bën nga ndonjëherë edhe gabime, por gabimet i shërbejnë për të shkuar drejt asaj që ai beson se është e drejtë...”

Lincoln-i, i mësuar me turbullira, vazhdoi të lundrojë në një det plot furtuna. Nuk i bënë përshtypje as lëvdatat, as shpifjet. Ai veproi si e gjykoi për më mirë dhe vazhdoi kështu gjer në fund. “Unë nuk mund të merrem me të gjitha ato që thuhet kundër meje, sepse atëherë nuk do të kisha kohë të merresha me punëra të tjera me rëndësi, që kanë lidhje drejtpërdrejtë me interesat e larta të kombit e të popullit”. Kështu i deklaroi një herë sekretarit të tij, të cilit i tha edhe këto fjalë: “Në qoftë se në mbarim të këtij rrebeshi të tmerrshëm, që ka rënë mbi krye të kombit, do të dal faqebardhë, atëherë çdo gjë që është thënë e do të thuhet kundër meje nuk do të ketë rëndësi dhe do të harrohet”.

## LINCOLN

### MBARIMI I LUFTËS

Me gjithë se në të dy betejat e mëdha, që u bënë në Gettysburg dhe Vicksburg më 1863, trupat e Konfederatës pësuan humbje të rënda, në njerëz dhe në pajisje ushtarake, përsëri lufta gjatë atij viti vazhdoi e rreptë në ballë të ndryshëm. Më pas u bënë të tjera beteja të përgjakshme dhe me humbje të mëdha si për fuqitë e Jugut ashtu edhe për ato të veriut.

Gjatë luftës Lincoln-i e dërgoi Simon Cameron-in si ministër në Rusi dhe në vend të tij, si ministër të luftës, emëroi Edwin Stanton-in. këtë ndryshim dhe ndryshime të tjera në ofiqe të larta civile e ushtarake Lincoln-i i bëri për arsye të pakënaqësive që u shfaqën herë pas here. Për shkak të zgjatjes së luftës - e cila në fillim shpresohej se do të merrte fund brenda pak muajve - ishte e pamundur të evitoheshin pakënaqësitë.

Bile pakënaqësitë nisën të ndjehen edhe në shpirtrat e të rinjve, të cilët nuk shkonin më vullnetarë me dëshirë të madhe, siç shkonin në fillim. Për këtë arsye, Qeveria Federale, me aprovimin e Kongresit, bëri një ligj për

## XHEVAT KALLAJXHI

rekrutimin e ushtarëve me detyrim. Në fakt, bëri të njëjtën gjë që kishte bërë më parë Konfederata. Njëkohësisht Kongresi e autorizoi Qeverinë Federale që të pranonte në radhët e ushtrisë e të marinës edhe zezakë.

Por pakënaqësia u shfaq në një rast edhe në një mënyrë të dhunshme. Në vitin 1863 ndodhën disa turbullira në New York. Turma njerëzish, duke thirrur “vafshin në djall lufta dhe rekrutimi”, sulmuan disa zyra ushtarake dhe u vunë zjarrin! Por me dërgimin e disa garnizoneve të reja, gjendja u qetësua. Me atë rast Jugu filloi të shpresojë se punët mund të keqësoheshin dhe aktet e dhunshme mund të përhapeshin edhe në vise të tjera të veriut. Mirëpo kjo shpresë perëndoi shpejt.

Më vonë, në Mars të vitit 1864, Lincoln-i i dha një gradë të re Gjeneralit Grant dhe e emëroi kryekomandant të ushtrive. Kjo gradë iu dha me aprovimin e Kongresit. Ishte në atë rast që Gjenerali Grant erdhi në Washington për herën e parë në jetën e tij.

Gjatë vitit 1864 gjendja për Jugun u keqësua shumë. Disa qendra strategjike me rëndësi ranë në duart e trupave federale. Kontakti i Konfederatës me Evropën u pre pothuajse krejt, për shkak të bllokimit që kishte vënë flota e Qeverisë Federale. Pambuku, që përbënte bazën



## LINCOLN

ekonomike për Jugun, kishte mbetur në depot i pashitur. Ushqimet dhe materialet luftarake ishin pakësuar. Shkatërrimet ishin të mëdha.

Me gjithë këtë, në verën e atij viti popullsitë e Jugut shkruan faqe të një heroizmi të rrallë. Ndonëse e shihnin që punët e tyre nuk venin mirë, përsëri nuk u hutuan dhe nuk u tronditën. Shpresonin gjithnjë se do ta mposhtnin një ditë armikun. Që të gjithë banorët e Jugut, burra e gra, ndihmuan me çdo mënyrë për të mbajtur më këmbë ushtrinë e tyre gjer në fund. Nuk u shkante ndërmend mundësia e një dorëzimi.

Më 1865 lindi një farë shprese për t'i dhënë fund luftës, kur Jugu kërkoi një takim midis një delegacioni të tij dhe një delegacioni të veriut. Ky takim u bë më 3 shkurt. Delegacioni i Konfederatës përbëhej nga Stephens, Hunter dhe Campbell. Delegacioni i Qeverisë Federale përbëhej nga Lincoln-i, Sewardi dhe Granti. Stephens ishte nënpresidenti i Konfederatës dhe dikur kishte qenë mik i Lincoln-it.

Jugukërkonte që të gjendej ndonjë kompromis për t'i dhënë fund luftës. Por pikëpamjet e tij, në çështjet themelore, ishin pothuajse të pandryshuara nga ato që kishte para se të pëlciste lufta. Lincoln-i e vuri si kusht që në krye se në çdo marrëveshje, që mund të bëhej, duhesh të merreshin parasysh këto dy pika: Respektimi i

## XHEVAT KALLAJXHI

bashkimit të Kombit dhe zhdukja e skllavërisë. Sipas pikëpamjes së delegacionit të Veriut, do të ishte një çmenduri politike dhe një tradhti ndaj kombit sikur të bëhej një kompromis pa respektuar këto dy pika. Përndryshe pse u derdh aq gjak?

Kur Stephens-i e pyeti Lincoln-in se “në ç’mënyrë mund t’i jepej fund luftës”, ky u përgjigj kështu:

- Mjafton që Jugu të heqë dorë nga qëndresa e tij.

Dhe kur Stephensi bëri disa propozime që ishin në kundërshtim me pikëpamjen e Qeverisë Federale, Lincoln-i tha, në mënyrë fisnike, këto fjalë:

- Unë nuk mund të bisedoj me rebelë të armatosur.

- Por edhe Charles I i Anglisë bisedoi me rebelët, - tha një nga anëtarët e delegacionit të Konfederatës.

- Unë nuk kam dijeni nga historia, u përgjegj Lincoln-i. - Për këtë gjë mund të bisedoni me Sewardin. Por, shtoi njëkohësisht Lincoln-i, mua më kujtohet se Mbreti Charles humbi më në fund kryet.

Me pak fjalë, nga ky takim nuk doli asgjë, Trupat e Veriut po përparonin në shumë anë. Më 22 Mars 1865 Lincoln-i vizitoi qendrën

## LINCOLN

e përgjithshme ushtarake të Gjeneralit Grant në City Point, në Virginia, ku qëndroi disa ditë. Gjatë asaj kohe mbajti një mbledhje me gjeneralët Grant, Sherman, Meade dhe Sheridan, në të cilën u vendos që të bëhesh një sulm i madh për të zaptuar Richmondin, kryeqytetin e Konfederatës.

Më 3 Prill trupat federale hynë në Richmond. Presidenti Jefferson Davis, kabineti i tij dhe të gjitha organet civile e ushtarake të Konfederatës ishin larguar disa orë më parë. Para se të largoheshin, trupat e Konfederatës shkatërruan mjaft depo dhe u vunë zjarrin shumë godinave. Prishën njëkohësisht edhe disa ura.

Në krye të ushtrive federale hyri komandanti Weitzel, i cili u prit nga kryetari i bashkisë dhe disa veta nga parijsia e qytetit Richmond. Ata duallën përpara me një karrocë dhe me një flamur të bardhë. Me të hyrë ushtria federale, në Kapitolin e Richmondit u ngrit përsëri flamuri i Shteteve të Bashkuara. Pastaj kjo ushtri filloi menjëherë të shpërndajë në popull ushqim e ilaçe, të shuajë zjarret që vazhdonin akoma, të sigurojë rendin dhe të marrë në dorëzim zyrtar qeveritare.

Të nesërmen, më 4 Prill, e vizitoi Richmondin e shkatërruar edhe Presidenti Lincoln, i cili u prit me brohori të mëdha nga banorët e Richmondit,

sidomos nga zezakët. Këta e pritën si një “profet shpëtimtar”. Një plak zezak u ul në gjithë dhe i tha këto fjalë: “Ne besojmë vetëm tek Perëndia dhe tek Ju”.

Rreth Lincoln-it u grumbulluan me mijëra njerëz, sidomos zezakë, të cilët ishin shkukur pothuaj që të gjithë. Lincoln-i u tha ko fjalë: “Miq të mi, ju jeni tani krejt të lirë. Nuk jeni më skllëvër, por njerëz të lirë. Këtë liri jua ka dhënë Perëndia siç u a ka dhënë edhe gjithë të tjerëve. Lemëni tani të shkoj, se kam shumë punë për të kryer”.

Turma e ndoqi Lincoln-in kudo që shkoi. Dhe kur një grup i madh zezakësh deshë të shkatërrojë burgun e famshëm të Richmondit, ai e ndaloi dhe i tha: “Jo, mos e shkatërroni; lëreni të qëndrojnë si një monument”.

Të nesërmen Lincoln-i u kthye përsëri në Washington, ku i u përvesh menjëherë punës për rindërtimin e kombit. Kur u kthye në Washington, ai e gjeti qytetin që po festonte fitoren. Këto festime vazhduan katër ditë.

Gjenerali Lee, kur u largua nga Richmond-i, kishte ndërmend të shkonte në North Carolina dhe t’i bashkonte ushtritë e tija me ato të Gjeneralit Johnston, për të vazhduar luftën. Por i ndjekur nga ushtria e Gjeneralit Grant dhe nga kaloria e Gjeneralit Sheridan, ai nuk mundi dot

## LINCOLN

ta vinte në veprim planin e tij. Iu pre rruga dhe u rrethua në afërsitë e Buskerville. Ushtritë e Gjeneralit Lee kishin pothuajse pesë dit që nuk merrnin racione ushqimesh të rregullta.

Më 7 Prill, Gjenerali Grant i dërgoi Gjeneralit Lee një mesazh, me të cilin i thoshte, ndër të tjera, këto: “Kujtoj se është e kotë të vazhdohej akoma lufta dhe të derdhet tjetër gjak...” Gjenerali Lee, duke parë realitetin - duke parë se trupat e tij, të lodhura e të uritura, nuk mund t’i bënin ballë një ushtrie të organizuar e shumë të madhe - vendosi të dorëzohet.

Kështu, më 9 prill, Gjenerali Lee dhe Gjenerali Grant u takuan në një godinë në fshatin Appomattox. Atje u nënshkrua akti i dorëzimit, me të cilin oficerët u lejuan të mbajnë shpatat; ushtarët u lejuan të kthehen në vatrat e tyre, duke marrë me vete kuajt, që u nevojiteshin për të punuar tokat. U dha amnisti e plotë për të gjithë, me premtim që askush nuk do të merrte më armët kundër Qeverisë Federale.

Gjatë bisedimeve për dorëzim, si gjenerali Lee ashtu dhe Gjenerali Grant fituan admirimin e të gjithë atyre që ndodheshin në vend, për urtësinë, ndjenjat njerëzore dhe fisnikërinë e tyre. Që të dy ishin ushtarë të mëdhenj dhe burra të shquar. Që të dy kishin luftuar me trimëri dhe vuanin shpirtërisht për fatkeqësinë e madhe që

## XHEVAT KALLAJXHI

kishte rënë mbi kryet e kombit.

Gjenerali Lee u përcoll me nderime nga Gjenerali Grant dhe nga oficerët e tjerë federalë, kur u nis për t'u kthyer në qendrën e ushtarëve të tij, numri i të cilëve arrinte në 27.000 veta. Atje Gjenerali Lee u tha ushtarëve të vet, para se të ndahesh prej tyre, këto fjalë:

“Me admirim të pakufishëm për qëndresën tuaj dhe për dashurinë tuaj ndaj atdheut, dhe me mirënjohje të thellë për besimin dhe fisnikërinë e treguar përkundrejt meje, unë iu përshëndes me gjithë zemër dhe ju them: lamtumirë!”

Kur Gjenerali Grant u kthye në qendrën e përgjithshme ushtarake të tij, ai i gjeti ushtarët federalë që po festonin dhe zbraznin pushkë për të kremtuar fitoren. Dha menjëherë urdhër që të ndalohesh zbrazja e pushkëve, duke thënë këto fjalë:

“Lufta mori fund, dhe ata që kishin ngritur krye janë përsëri bashkatdhetarët tanë”.

Dhe pak ditë më vonë, më 14 prill, me një ceremoni solemne ushtarake, në Charleston u përkujtua katër-vjetori i sulmit kundër “Fort Sumter”. Majori Anderson - i cili gjatë kësaj kohe kishte arritur gradën e gjeneralit - ngriti përsëri në majën e kësaj kështjelle flamurin e Shteteve të Bashkuara, të njëjtin flamur që ishte shtrënguar të ulte katër vjet më parë.

## LINCOLN

Kështu mori fund një luftë civile nga më të përgjakshmet që njeh historia e botës; një luftë që ngriti në këmbë më tepër se 2.000.000 ushtarë dhe i kushtoi Kombit Amerikan afro 650.000 të vrarë dhe shkatërrime të panumërta. Por, nga ana tjetër, në përfundim të kësaj lufte u realizuan këto dy vepra të mëdha: *U zhduk sistemi i skllavërisë dhe u siguria bashkimi i përjetshëm i kombit.*

VRASJA E LINCOLN-IT

Më 14 prill 1865 në mëngjes - që ishte e Prëmtë e Zezë - Lincoln-i i kallëzoi së shoqes këtë ëndërr: “Mbrëmë ëndërrova sikur po shëtitja në çdo kënd të Shtëpisë së Bardhë. Të gjitha dhomat ishin pa njeri brenda, me gjithë se shkëlqenin nga një dritë e madhe. Ndërkohë dëgjova edhe një vajtim. Dhe kur hyra në: “East Room”, pashë trupin e një të vdekuri në tabut, i cili ruhej nga ushtarët. Dhe kur pyeta një ushtar: “Kush ka vdekur në Shtëpinë e Bardhë?”, ai m’u përgjegj me hidhërim: “Presidenti”. Çështja e ëndrrave, vazhdoi Lincoln-i, është një gjë e çuditshme. Për to bëhet fjalë edhe në Testamentin e Vjetër e të Ri. Nuk di njeriu se si t’i shpjegojë”. E shoqja i tha se “njeriu sheh shpesh herë ëndrra të çuditshme, prandaj nuk duhet t’u japë rëndësi”. Me këtë fjalë, u mbyll ky bisedim.

Atë pasdreke Lincoln-i mbajti një mbledhje me kabinetin e tij për të biseduar rreth planeve për fillimin sa më parë të punimeve për rindërtimin e kombit. Dhe pas asaj mbledhje, Lincoln-i, së bashku me të shoqen, bëri një shëtitje me



## LINCOLN

karrocë në qytet. “Tani që mori fund lufta”, i tha Lincoln-i Mary-t, “besoj se do të kemi ditë të qeta për të gëzuar pak jetën familjare”. Sepse, gjatë katër vjetëve, Lincoln-i nuk pati kurrë rast të çlodhej në qetësi. Ishte gjithnjë i zënë me punë të rënda e të vështira.

Mbrëmanet Lincoln-i, së bashku me të shoqen, shkoi në teatrin “Ford” për të parë një komedi, e cila kishte bërë shumë bujë. Titulli i saj ishte “Kushëri ynë amerikan”. Shkuan me karrocë dhe morën me vete edhe dy miq: Zonjushen Clara Harris dhe të fejuarin e saj. Majorin Rathbone. Kur Lincoln-i u duk në lozhën presidenciale, krejt gjindja u ngrit në këmbë dhe brohoriti me entuziazëm. Ai, pasi i u përgjigj me plot ëmbëlsi brohoritjeve të publikut, u ul mbi një poltronë në këndin e lozhës. Pastaj vazhdoi shfaqja e komedisë. Gjindja ishte e qetë dhe një frymë gëzimi e vëllazërie bashkonte zëmrat e të gjithëve. Edhe Lincoln-i qëndronte i qetë në poltronin e tij.

Po kur u ngrit perdja e aktit të tretë, një krismë kobureje gjëmoi në sallën e teatrit. Pastaj një njeri kërceu nga lozha e Presidentit në dysHEME me një thikë në dorë e, duke thirrur “Sic semper tyrannis”<sup>1</sup>, u zhduk me të shpejtë mbrapa skenës së teatrit. Në fillim askush nuk mori vesh se

*1 Përkthimi shqip i këtyre fjalëve latine është: “Kështu (përfundojnë) gjithmonë tiranët”.*

## XHEVAT KALLAJXHI

ç'kishte ndodhur. Bile disa nga spektatorët kujtuan se mos zbrazja e kobures bënte pjesë në shfaqjen e komedisë. Po kur Mary lëshoi një ulërimë ngjethëse, atëherë mësuan që të gjithë se ishte bërë atentat kundër Presidentit, i cili, i plagosur rëndë me një plumb pas kokës, ishte shtrirë përdhe pa ndjenja. Këtë atentat e bëri një artist fanatik i quajtur John Wilkes Booth, i cili kujtoi se me këtë mënyrë i a mori hakën Jugut!

Lincoln-in e shpunë menjëherë në shtëpinë e familjes Petersen, që ndodhet përkundrejt teatrit "Ford", në Rrugën 10. Tani si theatri ashtu dhe shtëpia janë bërë muze kombëtare. Rreth shtratit të Presidentit u mbledhën, brenda pak kohe, të gjithë anëtarët e kabinetit<sup>1</sup> dhe disa zyrtarë të lartë civilë e ushtarakë. U mbledhën gjithashtu edhe shumë mjekë, të cilët bënë ç'ishte e mundur për shpëtimin e jetës së Lincoln-it. Mary qëndronte e pikëlluar në krye të shtratit.

Jashtë shtëpisë ishin mbledhur me mijëra njerëz, të bardhë e zezakë, të cilët prisnin me ankth ndonjë lajm shpresëdhënës për shpëtimin e Presidentit. Mjerisht, në mëngjesin e ditës 15 Prill, çdo shpresë u pre: Lincoln-i dha frymën e fundit. Dhe ishte në atë çast që ministri i

*1 Mungoi vetëm ministri i jashtëm, William Seward, i cili, po atë mbrëmje, u plagos rëndë në shtëpinë e vet nga një tjetër atentator, shok i atij që qëlloi Lincoln-in.*

## LINCOLN

luftës, Edwin Stanton, tha këto fjalë që kanë kaluar në histori: “Tani Lincoln-i u përket të gjithë brezave”. Pastaj ministri Stanton përhap një komunikatë zyrtare, në të cilën tha, ndër të tjera, këto:

“Mbrëmë në ora 10.30 Presidenti Lincoln u vra, në lozhën e tij në teatrin Ford. Ai hyri në teatër në ora 8 së bashku me të shoqen. Një Zotëri dhe një Zonjë ndodheshin me ta në njëjtën lozhë, hyrja e së cilës nuk ruhej. Vrasësi hapi derën, i u afrua me të shpejtë Presidentit dhe e qëllloi, nga mbrapa, me një të shtënë të kobures në kokë. Plumbi i hyri thellë në kokë dhe i mbeti brenda. Presidenti ra përdhe pa ndjenja dhe, duke qëndruar në këtë gjendje, dha frymën e fundit në ora 7.30 sot në mëngjes, më 15 Prill...”

Nga shtëpia e familjes Petersen trupi i Lincoln-it u çua në Shtëpinë e Bardhë, ku mjekët i nxorën plumbin dhe e balsamosën. Atje trupi i tij u vizitua disa ditë me radhë nga mijëra njerëz, të cilët nderuan, për herën e fundit, avokatin e ndershem të Springfieldit, Shpëtimtarin e Bashkimit të Kombit dhe çliruesin e skllevërve.

Më 19 Prill, në Shtëpinë e Bardhë u kryen ceremoni fetare solemne për kujtim të Lincoln-it. Pastaj trupi i tij u shpu në Kapitol, nga ku, më 21 Prill, u dërgua - me një tren të posaçëm - në

## XHEVAT KALLAJXHI

Springfield, për t'u varrosur. Treni bëri të njëjtën rrugë që pat bërë edhe kur e solli Lincoln-in si president në Washington, katër vjet më parë. U ndal në qytete të ndryshme, ku u zhvilluan lutje fetare të posaçme, u mbajtën fjalime të mallëngjyera dhe banorët e tyre, me lot në sy, paraqitën nderimet e fundit.

Trupi i Lincoln-it arriti në Springfield më 3 Maj dhe të nesërmen u varros në "Oak Ridge Cemetery" të atij qyteti, në të cilin ai kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës së tij dhe kishte zhvilluar veprimtari të shumta e të shquara.

Vrasja e Lincoln-it ndodhi në një kohë kur ai përgatitej të vepronte me tërë fuqinë e tij për të rindërtuar kombin dhe për të vëllazëruar përsëri të gjithë Amerikanët. Prandaj humbjen e Lincoln-it e vajtoi krejt Amerika.

Gjenerali Grant, kur mori vesh lajmin e vrasjes së Lincoln-it, deklaroi: "Nuk mund ta përshkruaj dot hidhërimin që ndiej nga marrja e këtij lajmi. Unë e njihja mirë bujarinë e zemrës së tij, si edhe dëshirën që kishte që ta shihte krejt popullin e Shteteve të Bashkuara të rifitonte të drejtat e tij të plota e të barabarta. Unë mendoj se hovi për rindërtimin e kombit pësoi papritur një ndalje të madhe, aq të madhe sa nuk mund

## LINCOLN

të merret dot me mend”.

Dhe poeti Wait Whitman, i cili kishte përkrahur me gjithë shpirt kauzën e Veriut dhe ishte një adhuronjës i madh i Lincoln-it. E vajtoi atë me një vjershë tepër mallëngjenjëse. Nga kjo vjershë po riprodhojmë këtu, të përkthyer në gjuhën shqipe disa vargje:

*O Kapiten, o Kapiten i im  
Udhëtimi i tmerrshëm u mbarua!  
Anija jonë e kapërceu furtunën,  
Dhe qëllimi ynë u plotësua...*

.....

*Por zëmra, oh! zëmra, zëmra,  
Pika gjaku çurk po pikon  
Atje te skela ku kapiteni im  
Shtrirë përdhe vdekur qëndron...*

Por Lincoln-in nuk e vajtoi vetëm Amerika. Atë e vajtoi pothuajse edhe gjithë bota. Emri i tij ishte dëgjuar edhe në viset më të thella të kombeve të ndryshme. Lajmin e vdekjes së tij e njoftuan me pikëllim shumë gazeta të vendeve të huaja, sidomos të vendeve evropiane. Që të gjitha ato fletore përshkruajnë me lëvdata të rralla jetën dhe veprat e këtij Biri të Madh të Amerikës, i cili nga pyjet arriti në pozitën më të lartë shtetërore.

Leon Tolstoi shkroi se “Lincoln-i është një

## XHEVAT KALLAJXHI

shenjt i njerëzimit, emri i të cilit do të qëndrojë i gjallë mijëra vjet në legjendat e brezave të ardhme”. Ai shkroi gjithashtu edhe këto fjalë: “Për të marrë vesh njeriu madhështinë e Lincoln-it, duhet të dëgjojë historitë që thuhën rreth tij në vende të ndryshme të botës ... Unë kam dëgjuar burra të fiseve të ndryshme në Kaukas që bisedonin dendur rreth Botës së Re, por bisedimet e tyre lidheshin gjithnjë me emrin e Lincoln-it, e këtij heroji të madh të Amerikës...”.

Besojmë se këto pak citime janë të mjafta për të treguar se Lincoln-i - që pasqyron madhështinë e Kombit Amerikan - është një figurë universale, emri i të cilit njihet e nderohet kudo në botë si *kampion i lirisë, drejtësisë dhe demokracisë për të gjithë njerëzit*.

## LINCOLN

### MONUMENTI I LINCOLN-IT NË WASHINGTON

Në Amerikë nuk ka pothuajse asnjë vend që të mos ketë diçka që sjell emrin e Lincoln-it. Përveç kësaj, në Amerikë janë ngritur me qindra monumente, statuja dhe buste të Lincoln-it. Një nga monumentet më madhështore të Lincoln-it është ai që është ngritur në kryeqytetin e Shteteve të Bashkuara.

Nisma për ngritjen e këtij monumenti u mor, në mënyrë përfundimtare, në shkurt të vitit 1911, kur Kongresi i Shteteve të Bashkuara aprovoi një ligj të posaçëm për këtë qëllim. Por caktimi i vendit, hartimi i planeve dhe ndërtimi i tij morën shumë vjet. Momenti u inaugurua zyrtarisht më 30 Maj 1922. Në atë rast, Kryetari i Gjykatores së Lartë, William Taft-i, përshkroi rëndësinë e këtij monumenti me këto fjalë:

“Një tempull në të cilin mund të falen të gjithë; një altar mbi të cilin u bë sakrificat supreme për liri; një strehim i shenjtë fetar në të cilin mund të gjejnë frymëzim e çlodhje të gjithë ata që dashurojnë Kombin dhe Perëndinë”.

Monumenti ndodhet afër lumit Potomac dhe



Statuja e Lincoln-it në monumentin e tij në Washington



## LINCOLN

ka formën e një tempulli katërkëndësh. Është ndërtuar në formën e Parthenonit, tempullit të Perëndeshës Athena, që ndodhet në Akropolin e kryeqytetit grek. Jashtë është i rrethuar nga 36 kolona mermeri të stilit dorik. Brenda ka 10 kolona të stilit ionik. Kolonat brenda mbajnë çatinë e ndërtuar me copa xhami në formë katrore. Kollonate jashtme përfaqësojnë të 36 shtetet që ishin në kohën kur vdiq Lincoln-i. Në parmakun e ndërtuar mbi këto kolona janë gdhendur emrat e 48 shteteve të Amerikës që ishin futur në gjirin e Bashkimit Federal në kohën kur u inaugurua monumenti i Lincoln-it.

Ky monument ndodhet përkundrejt monumentit të George Washingtonit, që është një tjetër monument madhështor; dhe Kapitolit, që është qendra e Kongresit të Shteteve të Bashkuara. Monumenti i Lincoln-it është nja 70 metra i gjerë dhe nja 90 metra i lartë. Në këtë monument hyhet nëpërmjet shkallësh të gjata e të gjera, dhe monumenti vetë pasqyrohet në ujërat e kulluara të një liqeni artificial përkundrejt tij.

Monumenti i Lincoln-it është bërë një vend pelegrinazhi jo vetëm për Amerikanët, por edhe për të huajt që vizitojnë Washingtonin. Qysh prej kohës që u inaugurua e gjer sot, ky monument është vizituar nga më tepër se 45.000.000 njerëz pa ndryshim besimi, race

## XHEVAT KALLAJXHI

e ngjyre. Është tërheqës dhe prekës. Ai që e viziton një herë, dëshiron ta vizitojë përsëri. Në të shpirti i njeriut gjen ngushëllim e shpresë.

Brenda në këtë monument, në të dy faqet e mureve përkundrejt janë pikturuar dy episode: në njërin faqe është pikturuar lirimi i skllevërve: në tjetrën është pikturuar bashkimi i shteteve të Veriut me ata të Jugut. Përveç këtyre, në të dy anët e mureve, nën pikturat, janë vënë dy pllaka të mëdha prej mermeri, në të cilat janë gdhendur në njërin fjalimi që Lincoln-i mbajti në Gyttsburg dhe në tjetrën fjalimi që ai mbajti kur u betua për herën e dytë si president.

Por akoma më prekëse në këtë monument është statuja gjigande prej mermeri të bardhë e Lincoln-it, i cili qëndron i ulur në fronin që është vendosur sipër një piedestali masiv. Dhe në krye të faqes së murit prapa kësaj statue janë gdhendur këto fjalë:

*Në këtë tempull  
sikundër në zemrat e popullit  
të cilit i siguroi bashkimin  
kujtimi i Abraham Lincoln-it  
është i shenjtëruar për gjithmonë.*